

“AVOKATURA” VITI :IV, nr. 6 / 2008

Buletin i Odes se Avokateve te Kosovës

AVOKATURA

Buletin i Odes se Avokateve te Kosovës

Bilten Advokatske Komore Kosova

VITI: IV - nr. 6 / 2008

Botohet çdo gjashte muaj/Published every six months/Izdaje se svakih sest meseci

Redaksia/Radakcija/Editorial Staff

Bajram Maraj, Musa Dragusha, Rexhep Kacaniku, Arianit Koci,
Refki Tac, Arianit Nikci, Shemsedin Pirraj, Mustafe Maloku, Naser Peci

Sekretar i redaksisë/Sekretar/Secretary

Yll Zekaj

Oda e Avokateve te Kosovës /Chamber Of Attorneys of Kosova/Advokatska Komora Kosova
Prishtinë/a,rr.Qamil Hoxha,10/3,Tel.+381- 38-244-586 E-mail: buletini_avokatura@oak-ks.org

PËRMBAJTJA/SADRZAJ/CONTENT:

Artikuj/Radovi/Articles

<i>Bajram Maraj, avokat</i> FTESE PER BASHKPUNIM	5
<i>Osman Tmava, gjyqtar</i> PADIA NE KONFLIKTIN ADMINISTRATIV	7
<i>Ekrem Agushi, gjyqtar</i> MBROJTJA GJYQESORE E POSEDIMIT	12
<i>Sevdali Zejnullahu, jur.dipl.</i> VIKTIMAT E AKSIDENTEVE TE TRAFIKUT RRUGOR	18
<i>Osman Havolli, gjyqtar</i> STRUKTURA E SHKRIMIT DHE E TE HARTUARIT JURIDIK	24
<i>Musa Xh.Dragusha, avokat</i> SHKATHTESITË E PREZENTIMIT GOJOR -MËSIMET E DALE CARNEGIE- (një kontribut për avancimin e shkathtësive prezantuese për avokatë)..	28
<i>Zenel Hajdari, gjyqtar</i> SHKELJET PROCEDURALE GJATË FILLIMIT DHE ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS KUNDËRVAJTËSE NDAJ TË MITURËVE	38

Kontribute/Doprinosi/Contributs

<i>Ibrahim Dobruna dhe Musa Xh.Dragusha, avokatë</i> ORGANIZIMI DHE ROLI I SHOQATAVE TË AVOKATËVE NË SHBA (nga një vizitë studimore).....	43
--	----

Shtojce

PARIMET	59
----------------------	----

Artikuj
Radovi
Articles

Ftesë për bashkëpunim

Lexues të nderuar,

Buletini i Odës së Avokatëve të Kosovës, që e keni në duar, megjithëse me vonesë, paraqet vazhdimësi të përpjekjeve që në mënyrë sa më të mirë dhe të mundshme për kushtet në të cilat veprojmë, ta bëjmë transparent aktivitetin e Odës, organeve dhe anëtarëve të saj në përgjithësi. Fushat kryesore në të cilat Oda e Avokatëve të Kosovës dhe organet e saj do të duhej që edhe në të ardhmen të zhvillojnë aktivitet me përkushtim edhe më të madh, janë:

- organizimi sa më funksional i Odës mbi bazat e Ligjit të ri mbi avokatin;
- zhvillimi i bashkëpunimit dhe kontakteve me simotrat e saj në rajon dhe më gjerë;
- përsosja e mëtejme e mekanizmave që sigurojnë zbatimin e sistemit të ngritjes së arsimimit dhe edukimit cilësor ligjor të avokatisë dhe
- ngritja e nivelit të përgjegjësisë së anëtarëve të saj për kryerjen sa më cilësore të shërbimeve, që në bazë të dispozitave pozitive i ofron avokatia.

Nëpërmjet buletinit Avokatia, ne synojmë të pasqyrojmë aktivitetin dhe rolin e Odës së Avokatëve të Kosovës, organeve dhe anëtarëve të saj. Parakusht themelor për realizimin e rolit të avokatisë së dinjitetshme dhe profesionale si komponentë imediate e shtetit juridik që po krijohet në Kosovë, është pajisja e vazhdueshme e avokatëve me njohuri të reja juridike, veçmas me ato aspekte të reja të së drejtës në transicion. Pa dyshim, juristi i mirë duhet në vazhdimësi të pajiset me njohuri të reja të sistemit juridik, ndërsa avokati cilësor, është ai që, përveç se është njohës i mirë i sistemit juridik, është po aq njohës i mirë edhe i praktikës juridike.

Jo rastësisht, aftësimi i mëtejme profesional është ngritur në nivel të detyrimit ligjor për të gjithë avokatët, anëtarë të Odës. Ata kanë detyrim ligjor t'i vijnë programet e këtij karakteri. Oda e Avokatëve, nëpërmjet Komitetit për Arsimim të Vazhdueshëm, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në ngritjen profesionale të avokatëve. Në sajë të donatorëve për përkrahjen materiale, e në veçanti USAID-it, janë realizuar kontakte dhe vizita të dobishme edhe jashtë vendit. Është hapur horizonti i njohurive mbi infrastrukturën ligjore, punën, organizimin dhe praktikën juridike. Në trajta të ndryshme të arsimimit ligjor, është përfshirë një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të Odës.

Megjithatë, ngritja dhe përsosja e mëtejme profesionale e avokatisë në Kosovë, mbetet edhe më tej me prioritet si detyrë e vazhdueshme.

Krahas arsimimit profesional, është e nevojshme që edhe në të ardhmen të ndërmerren masa të mëtejme për ngritjen e nivelit të përgjegjësisë. Është mirë që janë miratuar Ligji mbi avokatinë dhe Kodi i etikës profesionale të avokatëve, i cili ka hyrë në fuqi. Kodi përcakton qartë kriteret dhe standardet minimale profesionale në punën e avokatisë. Presim se do të nënshkruhet dhe të hyjë në fuqi edhe ligji i ri mbi avokatin, i cili për shkaqe të pajustificueshme, ka ngelur i panëshkruar nga përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, edhe pse është aprovuar në Kuvendin e Kosovës më 8 shtator 2004.

Megjithatë, është e njohur se nuk duhet të kënaqemi me infrastrukturë ligjore dhe standarde profesionale të mira. Është e nevojshme që ato të zbatohen në praktikë.

Ju, lexues të nderuar, me nisjativat, idetë tuaja mbi punën e organeve të Odës dhe avokatisë në përgjithësi, me angazhimet tuaja profesionale mbi praktikën e zbatimit të ligjit në gjyqësi, prokurori, administratë publike dhe organe e organizata që ushtrojnë autorizime publike, si segmente të rëndësishme të shtetit ligjor, mund të jepni kontributin tuaj të çmueshëm në përsosjen e mëtejme të infrastrukturës ligjore. Do të jenë të mirëpritura vështrimet dhe

kontributet tuaja, që spikasin dobësitë në ndërtimin dhe funksionimin praktik të sistemit juridik në Kosovë (i cili më të drejtë shquhet si një sistem i llojit të veçantë - sui generis).

Keni mundur të vëreni se vazhdojmë t'i botojmë informacionet mbi aktivitetin e organeve të Odës, por nuk ka punime të mjaftueshme autoriale të karakterit profesional. Për këtë shkak ndodh që të botohen edhe punime apo vështrime të autorëve të njëjtë. Disa nga punimet e botuara nuk janë gjithherë aktuale dhe të nivelit të mjaftueshëm të vlerave të kërkuara profesionale. Por, kjo nuk është zgjedhja jonë. Mendojmë se me kontribute autoriale të karakterit profesional, duhet të paraqitet numër më i madh i avokatëve, gjyqtarëve, prokurorëve dhe juristëve, por edhe i studiuesve dhe punonjësve të provinencës tjetër - secili që merret me krijimin e së drejtës apo zbatimin e saj në gjyqësi, prokurori, administratën publike etj.

Nuk jemi të kënaqur me numrin e atyre që bashkëpunojnë me revistën. Në këtë fazë të rrugëtimit tonë, jemi të vetëdijshëm edhe për mangësitë, nivelin jo gjithherë të kënaqshëm të punimeve, por me zgjerimin e bashkëpunimit, këto mangësi do të zvogëlohen me synim që të eliminohen plotësisht.

Avokatia kosovare me mbi 500 avokatë, ndër të cilët ekspertë me grada shkencore, profile dhe specializime të ndryshme, paraqet bazë premtuese kadrovike për mbrojtjen efikase të të drejtave dhe lirive të qytetarëve dhe për dhënien e ndihmës së nevojshme cilësore juridike në fushën e gjyqësisë dhe administratës publike. Ky potencial kadrovik, të cilin nuk e ka asnjë organ ose organizatë tjetër në Kosovë, disponon njohuri dhe përvoja të mira juridike në fushat e krijimit të së drejtës, zbatimit të së drejtës dhe përsosjes së mëtejme të së drejtës në transicion. Me një rol më aktiv, avokatia mund të ndikojë ndjeshëm në ndërtimin dhe përsosjen e mëtejme të legjislacionit si komponentë bazë e shtetit ligjor.

Tanimë është koha që të vëhen kontaktet dhe të nisë bashkëpunimi edhe me odat simotra në rajon dhe më gjerë, në mënyrë që të përfitohet nga përvoja e të tjerëve.

Ne do të bëjmë përpjekje të vazhdueshme në mënyrë që të përmirësojmë fizionominë dhe përmbajtjen e revistës sonë.

Ritheksoj se kemi potencial të admirueshëm i cili mund të përballet me sukses me sfidat e kohës. Andaj, mos hezitoni. Bashkohuni përpjekjeve tona për një revistë me cilësore. Kjo është në inetersin tonë, të së drejtës në transicion dhe të shtetit ligjor të cilin po e ndërtojmë.

BAJRAM MARAJ

Padia në konfliktin administrativ

Nocioni

Padia është mjet juridik me të cilin fillohet procedura e konfliktit administrativ. Konflikti administrativ vihet në veprim me padi e jo edhe sipas detyrës zyrtare.

Padia në kuptimin formal është parashtrësë e hartuar në mënyrë të rregullt nga presoni i legjitimuar, të cilën ai ia paraqet me kohë gjykatës, me qëllim të realizimit të mbrojtjes gjyqësore.

Në aspektin material, padia përmban kërkesën e subjektit juridik për shqyrtimin e situatës kontestuese si dhe propozimin e kërkesës së padisë për anulimin e aktit konkret individual administrativ.

Objekti i padisë

Konflikti administrativ mund të zhvillohet vetëm kundër aktit përfundimtar administrativ, anulimi i të cilit kërkohet. Kështu konflikti administrativ mund të fillohet kundër aktit administrativ të nxjerrë në shkallë të dytë, por mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të nxjerrë nga ana e organit të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankesa nuk është e lejuar. Konflikti administrativ mund të hapet edhe për heshtjen përfundimtare të organit administrativ.

Palët në konfliktin administrativ

Palët në konfliktin administrativ janë: 1. paditësi 2. ana (pala e paditur) dhe 3. presoni i interesuar.

Pala paditëse në konfliktin administrativ

Personi i cili me qëllim të mbrojtjes së të drejtave subjektive apo interesit të drejtpërdrejtë personal të bazuar në ligj, paraqet padi për fillim të konfliktit administrativ quhet paditës, i cili ka cilësinë e palës në konfliktin administrativ. Rezulton se konfliktin administrativ mund të e fillojë vetëm presoni i autorizuar me ligj. Kështu del se paditës është presoni i legjitimuar me ligj i cili paraqet padi në gjykatë dhe me të cilën kërkon të anulohet akti individual administrativ me të cilin ai nuk është i kënaqur. Kështu në cilësi të paditësit mund të paraqitet:

- Personi fizik (individ) dhe personi juridik, me kusht që të konsiderojnë se me aktin e kontestuar i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik,

- Organi shtetëror, organizata, njësia afariste e organizatës, qendra e banuar, grupi i qytetarëve, në qoftë se mund të jenë titullarë të të drejtave dhe detyrimeve për të cilat është vendosur me aktin e kontestuar,

- Kur organi i bashkësisë shoqërore-politike apo organizata, ka vendosur në shkallë të parë ndërsa sipas ankesës ka vendosur organi i bashkësisë, respektivisht organizatës tjetër shoqërore-politike p.sh. pushteti qendror, konfliktin administrativ kundër aktit administrativ të

marrë në shkallë të dytë, mund ta fillojë bashkësia shoqëro-politike, organizata, organi i së cilës ka vendosur në shkallë të parë, me kusht nëse me aktin e kontestuar të shkallës së dytë konsideron se iu është shkelur ndonjë e drejtë,

- Në favor të personit të veçantë-individit, konfliktin administrativ mund ta fillojë edhe prokurori publik kompetent, apo organi tjetër i autorizuar me ligj. Për këtë arsye të gjitha organet shtetërore, personat juridikë, bashkësitë shoqëro-politike, kanë për detyrë që për aktet me të cilat është shkelur ndonjë e drejtë apo interes juridik, nga momenti kur kanë mësuar për to, ta njoftojnë prokurorin publik kompetent ose organin tjetër të autorizuar me ligj,

- Në qoftë se me aktin e kontestuar është shkelur ligji në dëm të bashkësisë shoqëro-politike, konfliktin administrativ mund ta fillojë kundër atij akti edhe avokati kompetent publik,

- Në qoftë se konsideron se me aktin administrativ është shkelur ndonjë e drejtë apo interes drejtpërdrejt i bazuar me ligj, i personit juridik apo ndonjë pjese të tij, konfliktin administrativ mund ta fillojë edhe organizata sindikale,

- Nëse individit i cili është anëtar i ndonjë organizate shoqërore, e cila sipas rregullave ka detyrë të mbrojë të drejtat dhe interesat e caktuara të anëtarëve të vet, nëse konsideron se me aktin administrativ i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes i anëtarit të saj, konfliktin administrativ organizata mund ta fillojë me pëlqimin e anëtarit të vet, pra të paraqesë padi në emër të tij. Kjo organizatë njëherësh në çdo fazë të procedurës me të drejta të ndërhyrësit aksesor mund të hyjë në procedurën e filluar, në anën e individit (anëtarit të saj) dhe në favor të tij të ndërmarrë veprime, nëse këto nuk do të ishin në kundërshtim me deklaratat dhe veprimet e vetë palës.

Ana (pala) e paditur në konfliktin administrativ

Ana e paditur në konfliktin administrativ është organi shtetëror, përkatësisht organizata e cila kryen autorizime publike, akti administrativ i së cilës kontestohet me padi.

Personi i tretë (i interesuar) në konfliktin administrativ

Person i tretë - i interesuar është personi të cilit anulimi i aktit të kontestuar administrativ do t'i sillte dëm të drejtpërdrejtë. Ky person në konfliktin administrativ e ka cilësinë e palës.

Afati për paraqitjen e padisë

Padia në konfliktin administrativ paraqitet brenda 30 ditësh nga dita e dërgimit të aktit administrativ palës e cila paraqet padi. Ky afat vlen edhe për organin e autorizuar p.sh. prokurorin publik etj. nëse atij i është dërguar akti i kontestuar administrativ. Mirëpo, në rastin kur atij nuk iu është dërguar akti administrativ, afati për paraqitjen e padisë është 60 ditë, duke filluar prej ditës së dërgimit të aktit administrativ palës në favor të së cilës është nxjerrë akti administrativ.

Dorëzimi i padisë

Padia i dorëzohet gjykatës drejtpërdrejt apo i dërgohet me postë. Padia mund të bëhet edhe në procesverbal pranë gjykatës kompetente ose pranë gjykatës tjetër ordinere. Si ditë e dorëzimit konsiderohet dita e dorëzimit të padisë në postë rekomande, respektivisht e deklarimit në procesverbal pranë gjykatës. Nëse padia i është dorëzuar organit tjetër e jo gjykatës, kurse në gjykatë arrin pas kalimit të afatit të paraparë me ligj, padia do të konsiderohet e afatshme, me kusht nëse vërtetohet se ai veprim ishte si pasojë e mosdijes apo gabimit të qartë të paraqitësit të padisë. Për personat që ndodhen në armatë apo në shërbim të obligueshëm ushtarak, dita e dorëzimit të padisë në njësinë ushtarake konsiderohet si ditë e dorëzimit në gjykatë. Kjo situatë vlen edhe kur kemi të bëjmë me personat në shërbim në armatë apo në shërbim të obligueshëm ushtarak, në vendet ku nuk ekziston posta.

Përmbajtja e padisë

Padia është parashtrësë rreptësishtë formale dhe detyrimisht duhet të përmbajë elementet e parapara me ligj. Kështu, elementet qenësore të padisë janë paraparë në nenin 27 të LKA ku theksohet se padia duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin, profesionin, vendbanimin (adresën e paditësit), respektivisht emërtimin dhe selinë e paditësit, identifikimin e aktit administrativ kundër të cilit është drejtuar padia, shtjellimin e shkurtër të situatës ku shprehet arsyeja e paraqitjes së padisë dhe propozimin se në cilin drejtim dhe vëllim dëshirohet të anulohet akti administrativ. Bashkë me padinë dorëzohet edhe akti administrativ i kontestuar në origjinal ose në kopje. Në qoftë se me padi kërkohet kthimi i sendit apo kompensimi i dëmit, duhet të shtrohet edhe kërkesa e caktuar në pikëpamje të sendit apo të shumës për dëmin e pësuar. Me padi bashkëngjitet edhe nga një kopje e padisë për organin e paditur apo edhe për persona të interesuar nëse ka të tillë.

Të metat (mungesat) e padisë

Në qoftë se padia është jo e plotë ose e pakuptueshme, kjo nuk mund të jetë arsye që gjykata të mos veprojë sipas padisë. Në këtë situatë kryetari i kolegjit do ta ftojë paditësin që në afatin e caktuar t'i evitojë të metat e padisë, por edhe do ta udhëzojë si duhet t'i evitojë ato të meta, por edhe ta njoftojë për pasojat juridike në rast të mosveprimit të tij. Në rast se paditësi nuk i eviton të metat, kurse ato janë të natyrës së atillë që e pengojnë gjykatën në punën e mëtejme, gjykata-kolegji me aktvendim do ta hedhë poshtë padinë. Kjo situatë ndodh nëse gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me aktin e pavlefshëm administrativ.

Heqja dorë nga padia

Paditësi mund të heq dorë nga padia gjithnjë derisa të merret vendimi. Lidhur me heqjen dorë nga padia gjykata nxjerrë aktvendim për pezullimin e procedurës.

Efekti i padisë në ekzekutimin e aktit administrativ të kontestuar

Padia si rregull nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur. Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, respektivisht organi kompetent për ekzekutim, do ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor në qoftë se ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit i cili vështirë do të kompensohej, kurse shtyrja e

ekzekutimit nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh të pakompensueshëm palës kundërshtare. Bashkë me kërkesën për shtyrje duhet të paraqitet prova që tregon se është paraqitur padia. Për çdo kërkesë organi kompetent duhet të nxjerrë aktvendim, por jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e kërkesës. Përveç shtyrjes së ekzekutimit të natyrës obligative kemi edhe shtyrjen fakultative ku për shtyrje organi kompetent mund të vendosë edhe për shkaqet e tjera nëse e lejon atë interesi publik.

Ndryshimi dhe anulimi i aktit administrativ nga ana e organit të paditur pas paraqitjes së padisë

Në qoftë se organi gjatë procedurës gjyqësore nxjerr aktin tjetër administrativ me të cilin ndryshohet ose vihet jashtë fuqie akti i kontestuar administrativ, ose në rastin e heshtjes së organit administrativ, nxjerr më vonë aktin administrativ, organi i cili ka nxjerrë aktin administrativ të mëvonshëm ka për detyrë që për aktin ta njoftojë paditësin dhe gjykatën e cila zhvillon procedurën. Pas njoftimit, gjykata do ta ftojë paditësin që në afat prej 15 ditësh të deklarojë se a është i kënaqur me aktin e nxjerrë më vonë apo nuk heq dorë nga padia dhe duhet të përcaktojë se në cilin vëllim e konteston aktin e nxjerrë më vonë dhe a e zgjeron padinë kundër atij akti. Nëse paditësi nuk vepron si u cek më lart, atëherë gjykata do të nxjerrë aktvendim për pezullimin e procedurës. Paditësi nëse deklaron se nuk është i kënaqur me aktin e mëvonshëm, atëherë gjykata do ta vazhdojë procedurën.

Hapja e konfliktit administrativ në rastin e heshtjes së administratës

Në konfliktin administrativ bëhet kontrolli i ligjshmërisë të punës së administratës publike. Që të mund të kryhet ky funksion si prezumim i konfliktit administrativ, na paraqitet ekzistenca e aktit administrativ, ligjshmëria e të cilit kontestohet. Ndodh që organet administrative të mos i përmbushin në afatet ligjore detyrat e tyre, kështu që nga kjo zvarritje pala pëson dëm. Instituti i heshtjes së administratës, si u cek edhe më lart, në fakt është konstituuar në favor të mbrojtjes së palës. Pala për shkak të heshtjes së administratës mund ta fillojë konfliktin administrativ në këto raste:

a). Në qoftë se organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin lidhur me ankesën e palës së paraqitur kundër vendimit të organit të shkallës së parë në afatin prej 60 ditësh, apo në afatin tjetër më të shkurtër të paraparë me ligj. Në këtë situatë pala ka detyrim që atij organi t'ia paraqesë kërkesën e përsëritur në të cilën kërkon që për ankesën të vendoset edhe brenda afatit prej 7 ditësh, sepse në të kundërtën pala ka mundësi të paraqesë padi për të filluar konfliktin administrativ.

b). Pala mund të fillojë konfliktin administrativ në mënyrë të njëjtë edhe kur organi administrativ i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit nuk lejohet ankesa, nuk nxjerrë asnjë vendim në bazë të kërkesës së palës brenda afatit prej 60 ditësh, ose në afatin tjetër më të shkurtër të paraparë me ligj, dhe as në afatin prej 7 ditësh sipas kërkesës së përsëritur të palës.

c). Në qoftë se organi administrativ i shkallës së parë kundër aktit të cilit mund të bëhet ankesë, nuk ka nxjerrë aktvendim sipas kërkesës së palës brenda afatit prej 60 ditësh, ose afatit tjetër më të shkurtër të paraparë me ligj, pala ka të drejtë me kërkesën e vet t'i drejtohet organit administrativ të shkallës së dytë. Kundër aktvendimit të organit të shkallës së dytë pala mund të fillojë konfliktin administrativ. Konfliktin administrativ pala mund ta fillojë edhe në qoftë se organi i shkallës së dytë nuk ka nxjerrë aktvendim.

Puna e gjykatës sipas padisë

Në procedurën e konfliktit administrativ dallohen dy faza themelore të procedurës:

1. Procedura paraprake ku gjykata vetëm shqyrton dhe vërteton nëse janë përmbushur kushtet për fillimin e procedurës, dhe
2. Procedura e rregullt në të cilin gjykata definitivisht vendos për kërkesën e padisë.

Zbatimi subsidiar i dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore në konfliktin administrativ

Neni 60 i LKA, parasheh se nëse ai ligj nuk përmban dispozita konkrete lidhur me procedurën në konfliktin administrativ, atëherë në atë procedurë do të vihen në zbatim përshtatshëmrisht dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore.

MBROJTJA GJYQËSORE E POSEDIMIT

I. HYRJJE

Në jetën e përditshme, pronësia dhe posedimi ngatërrohen dhe këto dy institucione juridike marrin kuptim të njëjtë, duke mos u dalluar nga përmbajtja e tyre juridiko-civile. Ngatërime të tilla përmbajtësore hasen edhe në praktikën gjyqësore. Kështu, kur zhvillohet kontesti lidhur me një çështje konkrete kontestimore, që ka të bëjë me detyrimin e palës së paditur që t'ia dorëzojë në posedim një send palës paditëse, në dispozitiv të aktgjykimeve shpeshherë hasim formulime të tilla: “I padituri detyrohet që t'ia dorëzojë në posedim pronësinë paditësit”. Ky formulim nuk është i drejtë sepse pronësia, siç dihet, është një marrëdhënie juridike ndërmjet personave lidhur me një send. Pronësia është pushtet juridik mbi një send. Nga kjo përfundojmë se pronësia nuk mund të dorëzohet sepse ajo nuk përfaqëson send trupor, por ajo përmban autorizime pronësore të një personi i cili ka të drejtë që sendin e vet ta posedojë, përdor-shfrytëzojë dhe të disponojë brenda kufijve të caktuar me ligj (neni 3 al.1 i Ligjit për marrëdhëniet pronëso-ro-juridike bazë (në vijim LMPJB). Ndërkaq, posedimi është pushtet faktik i një personi mbi një send trupore i cili këtë send e mban dhe e shfrytëzon vetë (posedimi i drejtpërdrejtë) ose kur ky pushtet faktik mbi sendin ushtrohet përmes personit tjetër (posedimi indirekt) dhe kur personi i cili e gëzon të drejtën e servitutit sendor e posedon paluajtshmërinë e personit tjetër duke i ushtruar të gjitha autorizimet që e përmbajnë servitutin (neni 70 al.1,2 dhe 3 i LMPJB).

Posedimi, si element përbërës i pronësisë shpeshherë nuk bashkëjeton me autorizimet e tjera pronësore . Kur personit, i cili e gëzon të drejtën e pronësisë mbi një send, i merret sendi nga posedimi prej një personi tjetër, atëherë posedimi, si njëri nga autorizimet e pronësisë, nuk ekziston më te pronari dhe në këtë mënyrë themi se pronari është zhveshur nga posedimi (pronar joposuedes). Në qoftë se zhveshja e posedimit është bërë në mënyrë joligjore, pronari joposuedes ka të drejtë të kërkojë rikthimin-dorëzimin e sendit nga personi i cili e posedon sendin (poseduesi jopronar) pa bazë juridike, (neni 37 al.2 i LMPJB), kurse kur pengohet në posedimin e sendit, ka të drejtë të vetëmbrohet (neni 76 i LMPJB) ose duke kërkuar mbrojtje gjyqësore me padi për pengim në posedim (neni 75 i LMPJB). Ndërkaq, kur poseduesi i sendit, i cili në posedim të sendit ka hyrë pa bazë ligjore, me forcë, mashtrim apo keqpërdorim dhe në mënyra të tjera joligjore pengohet nga personi i tretë, atëherë poseduesi në këtë rast ka të drejtë të mbrohet nga akti i pengimit në posedim duke kërkuar mbrojtje gjyqësore me padi posedimore, (neni 75 i LMPJB).

Nga kjo rrjedh përfundimi se posedimi mund të jetë ligjor dhe joligjor, me mirëbesim dhe keqbesim. Posuedes ligjor është ai person kur posedimi është fituar mbi bazën e vlefshme juridike që nevojitet për fitimin e së drejtës së pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, mashtrim dhe keqpërdorimin e besimit (neni 70 al.1.LMPJB). Posuedes me mirëbesim është ai person i cili e nuk e di ose nuk mund të dijë se sendi të cilin e posedon nuk është i tij (neni 70 al.2 LMPJB). Mirëbesimi i posedimit, supozohet sipas dispozitave të nenit 72 al.3 të LMPJB. Për posedimin joligjor dhe me keqbesim, ligji nuk jep përkufizime, por duke e bërë interpretimin me argumentin e së kundërtës rrjedh se: posedimi është joligjor në qoftë se nuk rrjedh nga baza e vlefshme juridike e cila nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe në qoftë se është fituar me forcë, mashtrim, apo keqpërdorimin e besimit dhe posedimi është me keqbesim kur poseduesi e di, apo ka mundur të dijë që sendi të cilin e posedon nuk është në pronësi të tij.

Sipas ligjit të zbatueshëm, i cili u citua më lart, disa persona mund të jenë bashkëposedues të sendeve dhe të drejtave (neni 70 al.4) si bashkëshortët kanë bashkëposedimin e banesës dhe të sendeve të tjera që i shfrytëzojnë në bashkësi familjare. Me të njëjtin ligj është paraparë se trashëgimtari bëhet posedues i trashëgimisë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, përkatësisht hapjes së trashëgimisë pa marrë parasysh se kur e ka marrë apo ka hyrë në posedim të trashëgimisë (neni 73 i LMPJB). Në këtë situatë juridike, trashëgimtari i gjallë bëhet posedues ligjor në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit. Këtë status të ngjashëm juridik e ka edhe trashëgimtari i cili do të lindë gjallë pas vdekjes së trashëgimlënësit.

Në këtë rrjedhë të shqyrtimit e shoh të nevojshme të theksohet se objekt i posedimit mund të jetë çdo send në qarkullim juridik. Pra shprehur më saktë, objekt posedimi mund të jetë vetëm sendi mbi të cilën mund të fitohen të drejta sendore: pronësia, servituti sendor, hipoteka etj. Objekt posedimi nuk mund të jenë sendet të cilat nuk mund të marrin pjesë në qarkullimin juridik, si p.sh. rrugët publike dhe të gjitha të mirat e tjera me interes publik në pronësi publike, sepse këto janë në realizimin juridik administrativ të posedimit.

Përsa i përket sendeve të cilat mund të jenë në posedim faktik, edhe praktika gjyqësore e paraluftës së Kosovës ka pasur qëndrim të njëjtë me mendimin teorik lidhur me posedimin e të mirave publike. Kështu, në qoftë se rruga e caktuar paraqet të mirë publike, në këtë situatë është përjashtuar fitimi i posedimit dhe posedimi i kësaj rruge të caktuar, (dega civile e Gjykatës Supreme të Kroacisë (3/8 të dt.06.06.1980) dhe sipas të njëjtës gjykatë “Nuk mundë t’i jepet mbrojtje e posedimit personit i cili atë mbrojtje e kërkon lidhur me pjesën e tokës e cila paraqet rrugë publike (GZZ. 14/79 i dt.12.05.1979). Ndërsa sipas Gjykatës së Qarkut në Varazhdin, toka e cila gjendet në shtratin e lumit (rrjedhat natyrale) nuk mund të jenë në posedim të personave fizikë, sepse këto janë të mira publike.

Mënyrat e fitimit të posedimit janë të ngjashme me mënyrat e fitimit të së drejtës së pronësisë. Posedimi humbet kur poseduesi pushon ta ushtrojë posedimin ose zotërimin faktik të sendit (neni 74 al.1 i LMPJB), por sipas ligjit, posedimi nuk humbet po qe se poseduesi është përkohësisht i penguar të ushtrojë zotërimin faktik pavarësisht nga vullneti i tij.

II. SI REALIZOHET MBROJTJA GJYQËSORE E PENGIMIT NË POSEDIM

Me dispozitat e nenit 75 të LMPJB është paraparë se çdo posedues i sendeve dhe i të drejtave (neni 70 i LMPJB) ka të drejtë për të kërkuar mbrojtje nga pengimi në posedim. Pengimi në posedim mund të bëhet në dy mënyra: me shqetësimin e poseduesit të sendit, dhe me marrjen e apo zhveshjen e poseduesit nga posedimi i sendit. Shqetësimi apo trazimi i poseduesit bëhet kur një person ia vështirëson realizimin e pushtetit faktik mbi një send poseduesit me veprime gojore – psikologjike, p.sh. kërcenim serioz për jetën dhe trupin e poseduesit dhe veprime konkrete joligjore pa e bërë marrjen e sendit në posedim, p.sh. thurjen e rrethojës në servitut sendor për kalim apo marrje të ujit, vendosjen e pengesave të ndryshme në paluajtshmëri etj. Marrja e sendit nga poseduesi bëhet atëherë kur poseduesi i sendit zhveshet plotësisht nga posedimi i sendit. Zhveshja apo deposedimi mund të bëhet me vjedhje, mbyllje me çelës të objektit banesor apo lokalit afarist dhe vendosja e personave dhe sendeve në objekt dhe lokal afarist. Trajtim të marrjes së sendit të paluajtmshëm ka edhe atëherë kur nga poseduesi merret vetëm një pjesë e paluajtmshërisë në posedim, apo kur nga tërë objekti banesor merret vetëm një dhomë.

Në hyrje të këtij shqyrtimi u përmend se ligji i parasheh dy mënyra për mbrojtjen e posedimit: mbrojtjen jashtëgjyqësore ose vetëmbrojtjen, dhe mbrojtjen gjyqësore.

1. Mbrojtja jashtëgjyqësore-vetëmbrojtja

Poseduesi ka të drejtë për vetëmbrojtje kundër atij personi që në mënyrë të paautorizuar e shqetëson-trazon poseduesin ose kur ia merr sendin nga posedimi, me kusht që akti i shqetësimit dhe i veprimit për marrje të sendit të jetë i atyçasshëm dhe i drejtpërdrejtë si dhe vetëmbrojtja të jetë e domosdoshme dhe kjo t'i përgjigjet rrethanave ekzistuese të cilat kanë shkaktuar rrezikun (neni 76 i LMPJB). Nga kjo rrjedh se poseduesi ka të drejtë të vetëmbrohet vetëm kur plotësohen këto kushte në mënyrë kumulative. Në qoftë se, nuk plotësohen këto kushte, vetëmbrojtja në posedim nuk mund të realizohet, e nëse është bërë kjo, atëherë kemi të bëjmë me tejkalimin e vetëmbrojtjes dhe kjo paraqet veprim joligjor i cili përmban elemente të veprës penale të vetëgjyqësisë.

2. Mbrojtja gjyqësore

Poseduesi, mbrojtjen gjyqësore nga shqetësimi-trazimi i posedimit, përkatësisht zhveshja nga posedimi e realizon në gjykatë. Kjo mbrojtje mund të kërkohet brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e njoftimit (kuptimit apo marrjes vesh) për aktin e pengimit në posedim dhe personin i cili e ka kryer aktin e pengimit në posedim (afati subjektiv) e më së largu brenda afatit prej një viti nga dita e kryerjes së aktit të pengimit në posedim (afati objektiv), neni 77 i LMPJB. Afati objektiv është afat i fundit brenda të cilit duhet të kërkohet mbrojtja gjyqësore dhe afati subjektiv duhet të llogaritet vetëm brenda afatit objektiv. Pas kalimit të afatit objektiv, nga dita e kryerjes së aktit të pengimit në posedim, poseduesi nuk mund ta realizojë mbrojtjen për pengim në posedim. Në qoftë se poseduesi, kundër të cilit është kryer akti i pengimit në posedim, nuk kërkon mbrojtje gjyqësore me padi për pengimin në posedim brenda afateve të caktuara, atëherë padia e paraqitur do të hidhet si e paafatshme. Afati subjektiv dhe objektiv janë afate prekluzive për të cilat gjykata është e detyruar që të kujdeset kryesisht gjatë tërë zhvillimit të procedurës kontestimore për pengimin në posedim dhe kur gjykata konstaton se mbrojtja gjyqësore nuk është kërkuar brenda afatit ligjor, ajo në këtë situatë do të gjykojë në pajtim me dispozitat e nenit 282 al.1 të LPK.

Në praktikën gjyqësore janë paraqitur raste kur veprimi i pengimit në posedim përsëritet, pra kur ka diskontinuitet ndërmjet veprimeve të posedimit (kur kohë pas kohe shkaktohet zhurmë e padurueshme dhe me këtë pengohet poseduesi i shtëpisë apo i banesës, ose kur kalohet nëpër pjesën e servitutit për kalim dhe kur pronari i akacieve nuk e bën prerjen e degëve të cilat e pengojnë poseduesin e servitutit për kalim, afati objektiv llogaritet prej ditës kur është kryer akti i fundit i pengimit në posedim e jo nga dita kur është kryer akti i parë i pengimit.

Është me interes të theksohet për praktikën gjyqësore se kur gjatë procedurës kontestimore bëhet ndryshimi i padisë në kuptimin subjektiv, ashtu që në vend të të paditurit të mëparshëm paditet personi tjetër, Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë këtë qëndrim “Kur në kontestin për shkak të pengimit në posedim, paditësi gjatë procedurës ndryshon padinë, ashtu që në vend të të paditurit të mëparshëm e emërton si të paditur një person tjetër dhe kur ky e pranon ndryshimin e padisë dhe lëshohet në kontest, afatshmëria e padisë vlerësohet sipas ditës kur padia është paraqitur kundër të paditurit të mëparshëm e jo nga dita kur paditësi e ka ndryshuar padinë në kuptimin subjektiv”.

Rreth afateve të cekura më lart në doktrinë janë paraqitur mendime të ndryshme. Sipas mendimit të parë, afati për paraqitjen e padisë është cilësuar si afat procedural dhe për këtë, sikundër u tha më lart, gjykata është e detyruar që të kujdeset kryesisht. Në qoftë se kanë

kaluar këto afate, nuk mund të kërkohet kthimi në gjendje të mëparshme (neni 117 i LPK-së) ngase afati për paraqitjen e kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme është afat procedural e jo afat prekluziv material. Kur gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, që për bazë ka pengimin në posedim, gjykata konstaton se padia nuk është paraqitur brenda afatit ligjor në pajtim me dispozitat e nenit 282 al.1 të LPK-së, me aktvendim do ta hedh padinë si të paafatshme. Me aktvendim do të hidhet padia e paditësit edhe kur gjatë procedurës nga provat e shqyrtuara gjykata vërteton se padia nuk është paraqitur brenda afatit ligjor (neni 282 lidhur me nenin 438 dhe 288 al.2 të LPK-së). Me rastin e vendosjes lidhur me ankesën në gjykatën e shkallës së dytë ose vendosjes lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, e kur nga gjendja e konstatuar faktike rrjedh se padia është paraqitur në gjykatë pas afatit ligjor, padia hidhet poshtë.

Sipas mendimit të dytë, kur padia e paditësit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor, gjykata lidhur me këtë do ta bëjë shqyrtimin e provave dhe do të vendosë në mënyrë meritore dhe me aktvendim do ta refuzojë kërkesëpadinë si të pabazuar ngase lëshimi i afatit prekluziv ka për pasojë humbjen e së drejtës për paraqitjen e padisë.

Me ligj është paraparë se gjykata siguron mbrojtje gjyqësore sipas gjendjes së fundit të posedimit dhe aktit të pengimit të bërë, ku nuk ka ndikim e drejta për posedim, baza juridike e posedimit dhe mirëbesimi i poseduesit (neni 78 al.1 i LMPJB).

III. PROCEDURA KONTESTIMORE E PENGIMIT NË POSEDIM

Ligji i procedurës kontestimore (në vijim LPK), i cili është i zbatueshëm në Kosovë në bazë të Rregullores së UNMIK-ut, 1999/24, ka paraparë procedurë të posaçme lidhur me kontestet e pengimit në posedim. Dispozitat e tjera të këtij ligji zbatohen vetëm kur nuk ka dispozita të posaçme në pjesën e dispozitave ligjore që rregullojnë procedurën e kontesteve posedimore.

Procedura e pengimit në posedim fillon me padi, e cila duhet patjetër t'i përmbajë të gjitha elementet e parapara me dispozitat e nenit 186 al.1 lidhur me nenin 106 al.2 të LPK-së, dhe përfundon me aktvendim të cilin e merr gjykatësi i vetëm.

Shqyrtimi i kërkesëpadisë për shkak të pengimit në posedim, kufizohet vetëm në vërtetimin e gjendjes së fundit të posedimit (sendi në të cilin është kryer akti i pengimit a është në posedim të paditësit) dhe akti i pengimit (a është kryer akti i pengimit në posedim dhe në çfarë mënyre), ndërsa nuk është e nevojshme të vërtetohet baza juridike lidhur me posedimin ose ndërgjegjshmëria apo jondërgjegjshmëria e poseduesit si dhe dëmshpërblimi (neni 441 i LPK-së).

I padituri në kontestet e pengimit në posedim mund të mbrohet duke i paraqitur këto kundërshtime: se paditësi padinë e ka paraqitur pas afatit ligjor, se sendin e mban në posedim i padituri, se paditësi nuk e ka në posedim sendin kontestues, se sendin i padituri e mban në posedim në bazë të ligjit apo veprimtari juridik dhe kur sendin e ka fituar me vetëmbrojtje të ligjshme.

Edhe pse me ligj nuk është paraparë, praktika gjyqësore e ka pranuar qëndrimin se i padituri mund të mbrohet në kontestet e pengimit në posedim duke e paraqitur edhe kundërshtimin sipas rregullës “petitorium absorbet possessorium”, kur ndërmjet palëve të njëjta ndërgjyqësore për të njëjtin send gjatë kohës së njëjtë është në zhvillim kontesti për pengim në

posedim dhe kontesti pronësor për dorëzimin e sendit në posedim përfundon në favor të të paditurit para kontestit për shkak të pengimit në posedim, gjykata duhet ta vlerësojë këtë fakt dhe kur vërteton se çështja pronësore është në zgjidhje, do ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit për pengim në posedim.

Kur caktohen afatet dhe seancat në kontestet e pengimit në posedim, gjykata duhet të ketë kujdes të veçantë për zgjidhjen emergjente sipas natyrës të secilit rast konkret (neni 440 i LPK-së). Kontestet e pengimit në posedim kanë prioritet në zgjidhje. Pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata menjëherë, bashkë me thirrje gjyqësore, do t'ia dërgojë të paditurit kopjen e padisë, ta mbajë seancën e shqyrtimit, të vendoset dhe të bëhet përmbartimi. Kur gjykata vërteton se është kryer akti i pengimit në posedim, varësisht nga lloji i tij, (me pengim ose marrje të sendit), me aktvendim përveç se do të vërtetojë ekzistimin e pengimit në posedim, do të caktojë edhe ndalimin e shqetësimit të mëtejshëm në pengimin e posedimit, me paralajmërim për dënimin me gjobë, respektivisht kthimit të posedimit në gjendjen e mëparshme, si dhe masa të tjera të nevojshme për mbrojtje nga pengimi i mëtejshëm (neni 79 i LMPJB).

Afatet për përmbushjen e detyrimeve që u janë urdhëruar palëve, gjykata i cakton sipas rastit konkret (neni 443 al.1 i LPK-së) dhe për shkaqe të rëndësishme mund të vendosë që ankesa të mos e ndalë përmbartimin e aktvendimit (neni 443 al.2 të LPK-së) që do të thotë se në rastet veçanërisht emergjente p.sh. zënia e banesës nga personi i paautorizuar, pengimi në të drejtën e kalimit, i cili mund të shkaktojë dëm për shkak të mosmbjelljes me kohë të kulturave bujqësore, pengimi i marrjes së ujit për pije për nevojat e familjes, gjykata me aktvendim mund të parashohë që pala detyrimin ta përmbushë menjëherë.

Meqenëse, procedura e pengimit në posedim është emergjente, ligji ka paraparë edhe afate më të shkurtra për paraqitje të ankesës kundër aktvendimit për pengim në posedim. Me dispozitat e nenit 443 të LPK-së është paraparë afati për ankesë prej 8 ditësh. Ndërsa kundër aktvendimeve të marra në kontestet e pengimit në posedim nuk është i lejuar revizioni, kurse propozimi për përsëritjen e procedurës është i lejuar vetëm nga shkaqet e parapara me dispozitat e nenit 421 al.1 pika 2 dhe 3 e LPK-së. Propozimi për përsëritjen e procedurës mund të paraqitet në afat prej 30 ditësh nga forma e prerë e aktvendimit për pengimin në posedim. Vlen të theksohet se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e lejuar në kontestet e pengimit në posedim.

Përmbartimi i aktvendimit për pengimin në posedim, kur pala e paditur është detyruar që të kryejë veprime të caktuara, duhet të kërkohej brenda afatit prej 30 ditësh pas kalimit të afatit, i cili është caktuar në aktvendim për kryerjen e një veprimi të caktuar (neni 445 i LPK-së). Edhe në kontestet e pengimit në posedim, kur plotësohen kushtet e parapara me dispozitat e nenit 216 të LPK-së gjykata me aktvendim mund të konstatojë pushimin e procedurës.

Në kontestet e pengimit në posedim, gjatë procedurës gjykata mundet edhe kryesisht pa dëgjimin e palës së kundërt me aktvendim, të caktojë masën e përkohshme, e cila caktohet në procedurën përmbartimore për evitimin e rrezikut, dëmtimit të kundërligjshëm ose për pengimin e dhunës si dhe evitimin e dëmit të konsiderueshëm. Kundër aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme nuk është e lejuar ankesa e veçantë (neni 442 i LPK-së). Ky aktvendim mund të goditet me ankesë kundër aktvendimit për pengimin në posedim me të cilin përfundon meritorisht kontesti i pengimit në posedim (neni 378 al.2 i LPK-së). Praktika

gjyqësore e pranon caktimin e masës së përkohshme gjatë procedurës edhe kur paditësi propozon që të caktohet masa e përkohshme.

Në fund vlen të theksohet se edhe bashkëposeduesit e realizojnë mbrojtjen e bashkëposedimit nga dy aspekte dhe atë: kundër personave të tretë dhe kundër bashkëposeduesit tjetër. Bashkëposeduesit kanë të drejtë ta realizojnë mbrojtjen e plotë kundër personave të tretë (neni 75 dhe 76 të LMPJB) ndërsa kundër bashkëposeduesit tjetër vetëm kur bëhet i pamundur posedimi faktik i bashkëposedimit.

VIKTIMAT E AKSIDENTEVE TË TRAFIKUT RRUGOR

HYRJE

Në kohën e sotme, zhvillimi i teknikës dhe teknologjisë ka shënuar një përparim të madh sa që ka ndryshuar mënyrën e jetesës sonë. Produkt i këtij zhvillimi është edhe zhvillimi i mjeteve të trafikut apo të qarkullimit rrugor, ujqor dhe ajror. Komunikacioni rrugor në njëfarë mënyre mund të themi se është bërë për zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë njerëzore.

Komunikacionin, respektivisht trafikun rrugor e shohim si një segment vital pa të cilin në ditët e sotme nuk mund të paramendohet rrjedha jetësore,. Këtë e themi duke u bazuar në vlerat pozitive që sjell ai, si p.sh.:

- Udhëtimin (qarkullimin) komod prej një vendi në një vend tjetër;
- Qarkullimi pa ndonjë vështirësi fizike;
- Fitimin në kohë, etj.

Mirëpo, përkundër këtyre të mirave që përmendëm më lart, si dhe të tjerave që ka dhe mund të ketë, komunikacioni (trafikun) rrugor ka edhe anët negative, si p.sh:

- Ndotjen e mjedisit
- Shkaktimin e zhurmës
- Aksidentet e ndryshme që si pasojë kanë humbjen e jetës së njerëzve, lëndimet trupore dhe dëme të mëdha materiale, etj.

Në disa shënime thuhet se në tërë botën, SHBA-të e kanë komunikacionin rrugor më të zhvilluar. Një kohë amerikanët janë mburrur me reklama të ndryshme, duke identifikuar automjetin si mënyrë të jetesës amerikane. Mirëpo, një perceptim i tillë duket të ketë ndryshuar. Sa për ilustrim disa të dhëna tregojnë se në SHBA në aksidentet që shkaktohen në trafikun rrugor humbin jetën rreth 50.000 njerëz në vit.² Raste të tilla paraqiten edhe në vende tjera.

Aksidentet paraqesin pasqyrë të nivelit të sigurisë në trafik. Ato janë një problem serioz në të gjithë botën, qoftë nga pikëpamja sociale, shëndetësore dhe ekonomike. Madje, thuhet se aksidentet rrugore në përgjithësi, në shumicën e vendeve janë njëri nga shkaktarët kryesorë të vdekjeve për njerëzit që janë aktivë. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë³, çdo vit vdesin rreth 800.000 veta, si pasojë e aksidenteve rrugore dhe lëndohen më shumë se 24 milionë. Sot, vdekjet nga aksidentet rrugore renditen në vendin e 9-të, por parashikohet që në vitin 2020 të zënë vendin e tretë. Sipas të dhënave të organizmave ndërkombëtare që kanë vëzhguar këtë fenomen në Shqipëri rezultojnë të jetë kjo tablo: për çdo 10 mijë mjete motorike ndodhin 18-20 aksidente, përkundrajt 5 që ndodhin në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Në Shqipëri që nga viti 2000 e deri tani rezultojnë të ketë afërsisht 5000 aksidente me përafërsisht 7000 viktima. Nga këto 3224 të vdekur, ose 1 person për çdo kilometër rrugë nacionale, si dhe 3800 të lënduar apo të gjymtuar⁴.

Andaj, kjo çështje shtron para nesh detyra të shumta dhe kërkon që të bëhen hulumtime, analiza dhe studime të ndryshme, në mënyrë që së paku të kemi një zvogëlim të këtyre humbjeve. Posaçërisht, shtrohet nevoja që sa më shumë të merremi edhe me çështjen e viktimitave që pësojnë nga këto aksidente, do të thotë të kujdesemi për to, si p.sh.:

¹ Autori është kandidat për gradën master në fakultetin juridik, drejtimi juridik-penal

² Shih në http://en.wikipedia.org/wiki/Car_accident

³ Shiko në <http://www.who.int/publications/en/>

⁴ <http://www.aspra.info/aktivitete4.html>

- si trajtohen në shoqëri viktimat që pësojnë lëndime të rënda apo të lehta trupore;
- për rehabilitimin e viktimave të këtyre aksidenteve;
- për viktimat nga viktimizimi indirekt nga këto aksidente;
- pastaj realizimin e dëmshpërblimeve nga këto aksidente etj.

1. AKSIDENTI I TRAFIKUT RRUGOR

1.1 Kuptimi i aksidentit në trafikun rrugor

Me aksident në trafikun rrugor nënkuptojmë çdo aksident:

- në të cilin kanë marrë pjesë së paku një automjet në lëvizje;
- automjeti që gjatë lëvizjes godet ndonjë objekt apo subjekt dhe si pasojë e kësaj goditjeje shkaktohet vdekja ose lëndime të rënda apo të lehta trupore, si dhe dëme materiale.

1.2 Ndarja e aksidenteve të trafikut rrugor

Aksidentet e trafikut rrugor ndahen sipas kriterëve të ndryshme, varësisht nga çfarë këndi i qasemi.

- a) Nëse si kriter merret vendi se ku ka ndodhur, dallojmë aksidentet në vendbanim dhe aksidentet jashtë vendbanimit.
- b) Nëse si kriter merret koha e ndodhjes/shkaktimit të aksidentit, dallojmë aksidentet që shkaktohen natën dhe ditën.
- c) Nëse si kriter merret mënyra e të shkaktuarit të aksidentit, dallojmë ndeshjet e automjeteve ndërmjet vete, rrotullimi i automjetit dhe fluturimi nga rruga, vërsulja mbi këmbësor etj⁵.

Mirëpo të gjitha këto ndarje mund t'i përmbledhim në tri kategori:

- Aksidente fatale (me të vdekur);
- Aksidente të rënda; dhe
- Aksidente të lehta.

Duhet theksuar se të gjitha aksidentet, pa marrë parasysh se ku ndodhin, në çfarë kohe ndodhin, mënyrën e shkaktimit etj. në njërin apo formën tjetër, viktimit kryesorë është njeriu.

Aksidente fatale – janë ato aksidente të trafikut rrugor që pas goditjes apo kontaktit të automjetit në lëvizje me ndonjë objekt apo subjekt, si pasojë shkaktohet vdekja e njeriut.

Aksidente të rënda – janë ato aksidente të trafikut rrugor që pas goditjes apo kontaktit të automjetit në lëvizje në ndonjë objekt apo subjekt, shkaktohet:

- a) thyerja e gjymtyrëve;
- b) tronditja e brendshme e organizimit të njeriut;
- c) prerja e pjesëve të trupit të njeriut;
- d) dëmet me peshë të madhe materiale.

Aksidente të lehta – janë të gjitha ato aksidente të trafikut rrugor, të cilat si pasojë e goditjes, të automjetit në lëvizje në objekt apo subjekt kanë peshë më të lehtë. Ato janë dëme të vogla materiale, lëndime trupore të natyrës së lehtë, ku trajtimi mjekësor nuk është i nevojshëm, por vetëm ndihma e parë⁶. Këto aksidente të trafikut rrugor për shkak se nuk

⁵ Inxh.kom. Adem Hoti "Siguria në komunikacion", Prishtinë 2003

⁶ Din Hysenaj-Ragip Bytyqi, "Doracak për aksidentet e komunikacionit", Pejë 2002

shkaktojnë pasoja të rënda dhe nuk janë të rrezikshme, trajtohen si aksidente të lehta dhe si të tilla nuk kualifikohen si vepra penale por si kundërvajtje.⁷

Në këtë kontekst, duhet të kemi parasysh se aksidentet fatale dhe ato të rënda, për dallim nga aksidentet e lehta, në Kodin e përkohshëm penal⁸ të Kosovës janë të parapara si vepra penale në nenin 297.

1.3 Faktorët që ndikojnë në shkaktimin e fatkeqësive në trafikun rrugor

Si faktorë që ndikojnë në shkaktimin e aksidenteve të trafikut rrugor janë:

- a) faktori njeri-subjektiv;
- b) faktori objektiv.

Aksidentin të cilin e shkakton faktori subjektiv-njeri, është aksident të cilin e shkakton vetë njeriu për shkak se bën shkelje të ligjit të komunikacionit, duke mos i respektuar shenjat e komunikacionit, mënyrën e vozitjes në përputhje me kushtet dhe rrethanat e rrugës, vozitje nën ndikimin psikik apo fizik.

- Nën ndikimin psikik kuptojmë kur vozitësi drejton automjetin nën ndikimin e alkoolit, medikamenteve mjekësore apo në ndonjë ndikim tjetër që ka të bëjë me tronditjet vetjake, respektivisht familjare.

- Nën ndikimin fizik kemi të bëjmë me rastet kur vozitësi është i sëmurë, i lodhur etj.⁹

Në bazë të statistikave që e ka paraqitur prof.dr. Franko Rutin nga Zagrebi, del se: fatkeqësitë e trafikut rrugor shkaktohen nga faktori njeri 85%, ndërsa nga faktorët e tjerë 15%.

Në anën tjetër, si elemente për shkaktimin e aksidenteve të trafikut rrugor nga faktori objektiv janë:

- a) automjeti; dhe
- b) rruga.

Automjeti në shumicën e rasteve është faktori kryesor që ndikon në shkaktimin e aksidentit në trafik. Te këto aksidente pas inspektimit nga ekspertët është vërtetuar se shumica e automjeteve me të cilat shkaktohet aksidenti nuk i plotësojnë as kushtet minimale teknike për të marrë pjesë në komunikacion, duke përfshirë këtu: mekanizmin për frenim, mekanizmin e drejtimit etj., dhe pikërisht për shkak të mosfunksionimit të mirë të tyre ka ndodhur aksidenti. Rruga po ashtu është faktor kontribues në shkaktimin e aksidenteve të trafikut. Këtu duhet të kemi parasysh: gjendjen e rrugës, dukshmërinë e saj, dëmtimet në rrugë, formimet e gropave, shembjen e gurëve etj.

Për më tepër, ndikim të madh në shkaktimin e aksidenteve në trafik kanë edhe kushtet atmosferike si: bora e madhe, ngricat në rrugë, shirat e rrufeshëm, mjegulla etj.¹⁰

1.4 Pasojat nga aksidentet e trafikut

Siç kemi theksuar edhe më herët, aksidentet e trafikut kryesisht ndahen në:

1. aksidente fatale- me vdekje;
2. aksidente të rënda; dhe
3. aksidente të lehta.

⁷ Dr. Ismet Salihu , “E drejta penale - pjesa e përgjithshme”, 2003, fq. 208

⁸ http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2003regs/RA2003_25.pdf

⁹ Dr. Ragip Halili.”Kriminologjia”, 2002, fq. 212

¹⁰ Din Hysenaj - Ragip Bytyqi “Doracak për aksidentet e trafikut”,

Pa marrë parasysh se cilit grup apo kategori të aksidentit i qasemi për studim, ne do të shohim se të gjitha këto aksidente do të rezultojnë në shkaktimin e viktimave dhe të viktimizimit (pasoja që pësojnë anëtarët e tjerë të familjes). Kjo na jep të kuptojmë se nuk mund të paramendohet ndonjë aksident e të mungojë shkaktimi i pasojave të dëmshme dhe viktimave.

Me termin viktimë e aksidentit të trafikut rrugor kuptojmë personat të cilët:

- kanë humbur jetën në ato aksidente;
- kanë pësuar lëndime të rënda apo të lehta trupore;
- u janë shkaktuar dëme materiale.¹¹

1.4.1. Pasojat nga aksidentet fatale

Nuk do mend se aksidentet me pasoja më katastrofike dhe më të rënda paraqiten në grupin e parë, sepse kemi të bëjmë me humbjen e jetës së njeriut. Te këto aksidente besoj se kemi të bëjmë me viktimat direkte nga aksidenti i trafikut rrugor dhe viktimizimin indirekt.

Në viktimat direkte përfshihen të gjithë ata persona që humbin jetën si pasojë e kësaj ngjarjeje, qofshin ata drejtues të automjeteve, pasagjerë, këmbësorë apo ndonjë pjesëmarrës tjetër i involvuar në këtë fatkeqësi. Zakonisht, këto aksidente që rezultojnë me humbje të jetës së njeriut paraqiten nga raste të ndryshme të aksidenteve si te:

- aksidentet e forta që shkaktohen nga ndeshja e dy apo më tepër automjeteve (që vijnë si pasojë e mospërshtatjes së shpejtësisë, kushteve atmosferike, gjendjes së automjetit, pakujdesisë së vozitësve, etj., si pasojë e shkaqeve objektive dhe subjektive), ku mund të humbin jetën vozitësit apo pasagjerët që ndodhen në ato automjete;
- aksidentet që mund të shkaktohen nga rrotullimi dhe përplasja e një automjeti;
- aksidentet që shkaktohen nga ndeshja e automjetit me ndonjë pengesë të fiksuar;
- aksidentet nga ndeshja e automjetit me këmbësorin, çiklistin etj. në të gjitha rastet me viktimat të cekura si më lart.

Kur jemi te aksidentet e ndeshjes nga automjeti me këmbësorin, vlen të theksohet se numri i rasteve të vdekjes së këmbësorëve, të cilët pësojnë në ndeshje me automjetet arrin 20-35 %, nga numri i përgjithshëm i rasteve të vdekjeve të shkaktuara në komunikacionin rrugor.¹²

Në viktimizimin indirekt përfshihen sidomos të afërmit e atyre që kanë humbur jetën në këto aksidente, si p.sh. po të ndalemi dhe të analizojmë gjendjen emocionale dhe shpirtërore të atyre fëmijëve që i humbin prindërit e tyre në aksidentet e trafikut, do të shohim se nga pasojat e aksidentit sepse i kanë humbur të afërmit e tyre, janë të traumatizuar, të lënduar shpirtërisht. Kjo rrethanë lë pasojat shpirtërore edhe në të ardhmen ngase ata do të jenë në një gjendje të vështirë shpirtërore dhe morale.

Shikuar nga aspekti tjetër, mund të vijnë në një situatë shumë të vështirë ekonomiko-financiare. Gjithashtu, ndikim tjetër mund të jetë edhe ngecja në aspektin edukativ dhe kulturor, etj.

1.4.2 Pasojat nga aksidentet e rënda

Sa i përket grupit të dytë, këtu radhiten ata persona që pësojnë lëndime të rënda trupore. Varësisht nga ajo se në çfarë forme është shkaktuar aksidenti, kush janë të involvuar në ato

¹¹ E drejta, nr.4/2003, fq.21

¹² Inxh.kom. Adem Hoti "Siguria në komunikacion", Prishtinë 2003

aksidente, lëndimet dhe dëmtimet trupore të këtyre viktimave do të jenë të ndryshme, p.sh. te aksidentet që ndodhin nga ndeshja e dy apo më tepër automjeteve – në momentin e ndeshjes, trupi i shoferit dhe udhëtarëve të tjerë që gjenden në automjet, për shkak të inercionit, vazhdojnë të lëvizin në drejtim përpara, dhe atë me shpejtësi të cilën automjeti e ka pasur para ndeshjes. Në fazën e parë te shoferi ekziston **rezistenca** ndaj kësaj lëvizje të trupit në drejtim përpara, me veprimin e muskulaturës së tij, me dëshirën e tij dhe atë veçanërisht me mbështetjen e këmbëve në dysheme të automjetit. Për shkak të kësaj, këto viktimë mund të kenë thyerje të mbigjunjëve dhe nëngjunjëve, trupi vazhdon të lëvizë përpara dhe lart, me çka do ta godet me gjoks timonin, kurse me kokë xhamin e përparmë të veturës. Ngjashëm me shoferët mund të pësojnë lëndime edhe udhëtarët që gjenden në atë automjet. Si rrjedhojë e këtyre lëndimeve mund të shkaktohet invaliditeti i plotë apo i pjesshëm i këtyre viktimave.

Aksidentet te ndeshja e automjetit dhe këmbësorit shkaktojnë lëndime të ndryshme. Në këto fatkeqësi procesi i kësaj ngjarje ndahet në tri faza:

- faza e parë, është kontakti i trupit dhe automjetit. Në këtë fazë mund të kemi thyerje të eshtrave në pjesë të ndryshme të trupit të viktimës;
- faza e dytë, është rënia e trupit të këmbësorit në pjesët e përparme apo të sipërme të automjetit. Në këtë fazë kemi dëmtime të kokës, të boshtit kurrizor, murit të kraharorit etj.
- faza e tretë, është hedhja e trupit në rrugë. Këtu dëmtimet mund të jenë të intensitetit më të vogël dhe konsistojnë në dëmtime të lëkurës, e me rrallë me thyerje të eshtrave¹³.

1.4.3 Pasojat te aksidentet e lehta

Te këto aksidente zakonisht kemi të bëjmë me lëndime të lehta trupore apo me dëme të vogla materiale. Si lëndime të lehta numërohen gërvishtjet, dërmishjet, plagët e lehta etj.

2. Llojet e viktimave sipas fajit te aksidentet e trafikut rrugor

Dallojmë viktimë :

- të fajshme;
- të pa fajshme; dhe
- viktimë pjesëmarrëse.

Viktima të fajshme paraqiten te ato aksidente kur p.sh. vetë personi i cili ka qenë fajtor apo ka ndikuar që të shkaktohet aksidenti, ka pësuar, pa marrë parasysh se a është në cilësinë e drejtuesit të automjetit, pasagjerit apo këmbësorit.

Viktima të pafajshme janë ato viktimë të cilat nuk kanë kontribuar për të ndodhur aksidenti. Te ky grup në një numër më të madh hyjnë këmbësorët, por nuk përjashtohet mundësia që kësaj kategorie t'i përkasin edhe pjesëmarrësit e tjerë në trafik.

Viktima pjesëmarrëse ku shkaktarë të aksidentit rrugor paraqiten dy a më tepër persona (pra fajtorë janë dy a më tepër persona). Këto sidomos janë prezente te ndeshjet në mes të automjeteve, por nuk përjashtohet mundësia të jetë edhe në mes të automjetit dhe këmbësorit.

Aksidentet e trafikut rrugor në të cilat njeriu paraqitet si viktimë, edhe në vendin tonë janë mjaft prezente. Në bazë të të dhënave të marra nga njësitë regjionale të trafikut të Prishtinës

¹³ Prof.dr.Fadil Batalli “Mjekësia ligjore”, Prishtinë 1987

shohim një numër gjithnjë në rritje të aksidenteve në trafik, të cilat kanë rezultuar në shkaktimin e lëndimeve trupore, vdekjeve dhe dëmeve materiale.¹⁴

Përfundim

Në njëfarë mënyre të gjithë ne jemi shfrytëzues të rrugës si në rolin e ngasësit të automjetit, në rolin e këmbësorit, në rolin e ngasësit të biçikletës, ose në rolin e pasagjerit. Pra problemi i sigurisë rrugore është një problem që na takon dhe brengos të gjithëve.

Ne nuk duhet të presim që viktimat e shkaktuara nga aksidentet rrugore të shtohen dhe të shohim se si çdo ditë, çdo javë, disa nga miqtë tanë, anëtarë të familjeve tona ose të tjerë fillojnë udhëtimin e fundit. Kjo vjen si pasojë e mospasjes së shkallës më minimale të kulturës së trafikut si dhe mungesës thujtë të plotë të informimit të qytetarëve. Por nuk duhen anashkaluar dhe përgjegjësitë që kanë organet administrative që kujdesen për infrastrukturën rrugore të cilët në shumicën e rasteve kanë demonstruar paaftësinë e tyre në paraprirjen e këtyre fenomeneve.

Reduktimi i aksidenteve rrugore dhe rritja e sigurisë së trafikut është një gjë komplekse, dhe kërkon përpjekje të gjithanshme. Aktiviteti duhet të përqendrohet sidomos tek organizatat që kanë lidhje me trafikun, nga shumë ekspertë si: planifikues, ndërtues rrugësh, forca të policisë, etj., të cilët duhet të punojnë së bashku në realizimin e kësaj detyre. Me qëllim paraprirjen e aksidenteve rrugore duhet vënë theksi në disa elemente kryesore nga të cilat mund të përmendim sensibilizimin e qytetarëve nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit publik, duke parashikuar që kultura e trafikut të përfshihet në sistemin arsimor.

Bibliografia

1. Dr. Ismet Salihu, "E drejta penale - pjesa e përgjithshme", Prishtinë 2003
2. Prof.dr. Fadil Batalli "Mjekësia ligjore", Prishtinë 1987
3. Dr. Ragip Halili "Kriminologjia", Prishtinë 2002
4. Din Hysenaj-Ragip Bytyqi, "Doracak për aksidentet e trafikut", Pejë 2002
5. Inxh.kom. Adem Hoti "Siguria në komunikacion", Prishtinë 2003
6. E drejta nr.4/2003, Prishtinë
7. <http://www.who.int/publications/en/>
8. http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2003regs/RA2003_25.pdf
9. http://en.wikipedia.org/wiki/Car_accident
10. <http://www.aspra.info/aktivitete4.html>

¹⁴ Në vitin 2002 janë evidentuar 1329 aksidente, Viti 2003 - 1426 aksidente, Viti 2004 - 1637 aksidente, dhe në vitin 2005 - 1874 aksidente.

STRUKTURA E SHKRIMIT DHE E TË HARTUARIT JURIDIK

I.

Struktura e punimit me shkrim për nga ana metodologjike përbëhet nga këto pjesë të domosdoshme të shkrimit: hyrja, mbarështimi, përfundimi, fusnota dhe literatura e përdorur për konsultim.

Hyrja si pjesë e punimit me shkrim sajohet nga:

1. Përkufizimi i objektit - që nënkupton nevojën që kandidati ta përkufizojë objektin e shqyrtimit të vet me shkrim. Kandidati mund të orientohet në dy a më shumë objekte pune, varësisht nga fusha e interesimit të tij dhe kultura e punës. Përkufizimi i objektit e orienton lexuesin për interesimin e kandidatit për çështjet problemore që ai i shtjellon në shkrimin e tij.

Paralajmërimi i tezave themelore - Është e nevojshme dhe e domosdoshme që objekti i punës të zërthehet në teza themelore, përkatësisht në një grup çështjesh që mund të jenë teza më vete, ose që mund të përmbliidhen përbrenda një teze themelore. [P.sh.](#) krijimi i një ligji të veçantë, mund të zërthehet në teza themelore: rëndësia e ligjit në fjalë, elementet qenësore të përpilimit të tij, mundësia e aplikimit të atij ligji në praktikë, rëndësia, kufijtë e domosdoshëm të përfshirjes tematike etj. Këto dhe teza të tjera mund të zgjerohen dhe riformulohen sipas nevojës dhe hapësirës përfshirëse në shqyrtim.

Përcaktimi i metodave - Kandidati, varësisht nga interesimi dhe formimi teorik që ka, përcaktohet për metodat që mendon se më së miri do t'i hyjnë në punë. Secila metodë i ka përparësitë dhe të metat e veta, kandidati duhet të ketë kujdes që ta zgjedhë metodën tipike, ose së paku atë me të përafërt. [P.sh.](#) struktura e përpilimit të një ligji, mund të analizohet me metoda të ndryshme, por më tipike janë metoda **formale** dhe metoda **strukturale**, që i mundëson kandidatit ta zërthejë strukturën e një ligji si një bashkësi elementesh dhe relacionesh mes tyre.

Synimi i rezultatit - Që në hyrje kandidati paralajmëron synimin e rezultatit të cilin dëshiron ta arrijë ose ta verifikojë me anë të punimit të tij. [P.sh.](#) në strukturën problemore të një ligji, si objekt pune, mund të paralajmërojë ridefinimin e strukturës së ligjit, pasurimin e dijes teorike, mund të vërë në pikëpyetje kategori të caktuara të ligjit në fjalë. Prandaj duhet ta ketë të qartë synimin e rezultatit, i cili është pjesë e nevojshme e të hartuarit dhe të menduarit juridik.

2. Mbarështimi - konsiderohet pjesa qendrore e të hartuarit dhe kandidati bën shqyrtimin e tezave themelore, aplikon metodat e lartpërmendura, synon kërkimin dhe verifikimin e rezultatit.

Krejt këtë hark organizativ e përbëjnë edhe përfundimi, fusnota, literatura, që janë elemente përmblyëse të një shkrimi studimor.

II. SHKRIMI LIGJOR

Dilema e cila do të trajtohet në pjesën e mëposhtme të këtij punimi do të jetë:

Si të shkruajmë për gjykatës e jo si gjykatës?

A jeni duke shkruar një shkresë për gjykatën e apelit, shkresë për shqyrtim gjyqësor, një opinion ligjor për kolegjen e kompanisë, një shkresë për një laik shumë të lexueshëm apo një

klienti aspak të sofistikuar.

Nëse gjyqtari është ekspert në çështjen tuaj, atëherë ju duhet të përqendroheni të bëni prezantimin e mirë të fakteve të çështjes, por nëse i drejtoheni një gjyqtari, përkundër përvojës së tij, i cili ka praktikuar një lëmë krejt tjetër nga ai që tani po merret, atëherë shkresa juaj ligjore duhet të përmbajë një prezantim më të thellë të dispozitave ligjore.

Për të sforcuar shkrimin bindës, krahasimet janë shumë efektive për të arritur qëllimin e shkresave ligjore. Kohë më parë, para një gjykate ishte ngritur një debat shumë interesant dhe ai kishte të bënte me atë se, dërguesi apo shpërndarësi i picave, a është punëtor apo kontraktues i pavarur?

Për këtë dilemë, vinin argumente të ndryshme në drejtim të asaj se, njëra palë thoshte se, pasi që ai vetë po e mbushte makinën e tij me karburante, i cili e zgjedh edhe marshrutën e dërgesave, është i pavarur në punën e tij. Pala tjetër thoshte se, edhe kamerieri i cili është duke punuar në restorant nuk i urdhërohet se nëpërmes cilave tavolina ai duhet t'i shpërndajë porositë dhe se ai kishte të mbathura këpucët personale.

Ky vozitës apo shpërndarës i picave është "kamerier në rrota" dhe kjo frazë e gjeti mënyrën e vet në këtë mendim dhe u përshtat mirë në shkrimin ligjor.

III. RREGULLAT E SHKRIMIT LIGJOR

Gjatë procesit të të shkruarit dhe të menduarit ligjor duhet të kemi parasysh dy gjëra, njëra, e cila ka të bëjë me stilin, kurse tjetra me përmbajtjen, dhe praktika ka treguar se zakonisht në këto dy çështje më së shumti gabohet.

Në vijim do të prezantohen gjashtë rregullat primare rreth shkrimit ligjor.

1. Të ekzistojë thelbi apo esenca

Të arrish një shkrim të mirë ligjor është e domosdoshme që të kemi thelbin, përkatësisht qëllimin, dhe në lidhje me këtë ekzistojnë dy të meta që paraqiten shpeshherë në shkrimin ligjor. Njëra është se, nuk ekziston qëllimi apo kur shkrimi është përshkrues e jo analitik, tjetra është demonstrimi i njohurive të autorit për një çështje. E meta tjetër është se, një kategori e autorëve, të cilët janë tejet entuziastë, bëjnë përpjekje që të paraqesin një mori qëllimesh, por pa një strukturim dhe thellësi tematike.

2. Hyrja në esencë

E rëndësishme (sa edhe ekzistimi i thelbit), është edhe arritja apo depërtimi në thelbin e shkrimit me një shpejtësi të arsyeshme. Kjo do të thotë se ne duhet t'i tregojmë lexuesit se cila është esenca të cilën duhet ta prezantojmë qysh në fillim, d.m.th., duke e përkujtuar lexuesin për tezat në vazhdimësi përmes titujve, të kapitujve dhe fjalive kalimtare përgjatë tërë shkresës.

3. Integrimi i fakteve dhe analiza e rasteve

Në një strukturë të shkresës, e cila është e pasistemuar, lexuesit ka shumë të ngjarë që t'i ikën nga vëmendja koncentrimi, si pasojë e diskutimit të pafokusuar të historisë, koncepteve, fakteve apo të ngjashme. Lexuesi nuk është sikurse nëna, e cila me dëshirë do të lexonte atë

çka kemi shkruar me një vëmendje të fascinuar. Si shembull, nëse nuk keni përsëritur në kapitullin V atë çka keni thënë në kapitullin II, lexuesi i zellshëm ndoshta do të detyrohet të kthehet në kapitullin II dhe të lexojë përsëri tek i cili do të paraqiste një huti.

Përsëritja është e pranueshme, nëse e kemi organizuar mirë analizën, atëherë ka pak nevojë që ta përsërisim vetveten. [P.sh.](#) nëse konteksti historik i argumentit A është diskutuar në faqen 4 dhe 5; faktet në faqen 7; qëndrimet juridike të gjykatave në faqen 11 dhe 13: analiza juaj në të 16-tën dhe implikimet e politikave në faqen 22, fuqia bindëse e argumenteve do të jetë më e vogël nëse krejt kjo nuk është e integruar mirë.

Edhe lexuesi më i kujdesshëm do të ndihet se është i detyruar të bëjë punën për ju, por shumica e lexuesve do të thonë *“më vjen mirë që e përfundova këtë rrëmuje, por për çka ishte krejt kjo s’kuptova gjë!...”*

Qëllimi i vetë shkrimit ligjor është që të bindë lexuesin për tezat, të cilat janë paraqitur dhe nuk janë strukturuar mirë në punim, duke krijuar pengesa në aftësinë e autorit për ta bindur lexuesin.

4. Zbërthimi, ndarja e analizës në pjesë të organizuara

Një çështje mund të analizohet vetëm në mënyrë të organizuar. Analiza duhet të ndahet në pjesë përbërëse, dhe secili element duhet të zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe të integruar. Struktura e punimit duhet të reflektojë komponentet themelore të argumentit, i cili duhet të paraqitet për të mbrojtur tezën tuaj.

Këto komponente duhet të renditen në mënyrë të kujdesshme, për ta bërë sa më të qëndrueshëm rastin tuaj, dhe duhet pasur kujdes që lexuesi mos të bëhet i mërzitshëm, duke i riradhitur këto komponente, derisa të vendoset për versionin final.

5. Përdorimi i tonit

Para se të vendosni se çfarë toni do të ketë punimi juaj, mendoni se kë dëshironi ta bindni me thelbin që ju po prezentoni në shkresën tuaj. Dhe kur të dini se kujt i adresohet kjo shkresë, atëherë më lehtë do të vendosim se çfarë toni do të përdorim për të mundësuar, përkatësisht lehtësuar synimin tonë për ta bindur lexuesin. Nëse e kemi këtë parasysh përgjatë shkrimit, do të jemi në gjendje që ta mbajmë tonin konstant.

Në shkresat ligjore është mirë që në përgjithësi të përdoret një ton i arsyeshëm dhe i matur, sikur kur do të thoshim: “le të rezonojmë së bashku në këtë çështje”.

Ta zëmë se audienca është kryesisht inteligjente, apo një gjykatës i zellshëm, por i cili deri tani nuk ka pasur fare ekspozim në këtë çështje për të cilën po shkruani, por i cili është gati të marrë një vendim të rëndësishëm në lidhje me këtë çështje. Detyra jonë është që të parashohim dhe përmbushim rezervat dhe shqetësimet e tij apo saj.

Një ton i lartë apo shtrëngues, lexuesin do ta bëjë të zemëruar, më kokëfortë dhe nuk do të ketë prirje t’i perceptojë meritat e argumenteve të shkresës ligjore, apo edhe do të ndihet i ofenduar me tonin e përdorur në shkrim.

Përdorimi i frymës së brendshme të shkrimit, i cili e ka karakterin nënshtrues, dhe në një mënyrë është i varur apo nënçmues, mund të shkaktojë dyshimin te lexuesi se a do të ketë ndonjë përfitim, nëse vendos ta lexojë këtë punim.

Toni i shkrimit do t’i bëjë lexuesit që të vendosin se a t’i besojnë autorit apo jo, dhe nëse toni

është i gabueshëm, shumica e lexuesve do ta ndërpresin leximin e shkresës.

6. Konkretizimi dhe thjeshtësimi kur është e mundur

Konkretizimi është ngushtë i lidhur me tonin e paraqitjes, por duhet të kemi parasysh që atë ta paraqesim si çështje të shkëputur. Gjithsesi dhe kur është e mundur, të zgjidhet në mes të thënies së diçkaje në mënyrë abstrakte dhe asaj konkrete. Nëse përcaktohemi për mënyrën e të shprehurit, atëherë duhet t'i zgjedhim shprehjet konkrete.

Nëse ndieni se duhet të flisni në mënyrë abstrakte, së paku duhet të japim shembuj konkretë për ta ilustruar poentën abstrakte. Sa më i koklavitur të jetë argumenti, për lexuesin do të jetë më i vështirë procesi i të kuptuarit. Nëse ekziston mundësia që të zhvillojmë argumentin tuaj në një mënyrë të thjeshtë, atëherë duhet ta zgjedhim atë. Duhet pasur kujdes dhe të bëjmë përpjekje që lexuesin të mos e impresionojmë me fjalë dhe fjali të bukura, të gjata apo struktura komplekse.

IV. PËRKUFIZIMI

Në mesin e metodave më të njohura është e dhe metoda e të shkruarit juridik IRAC, që është përdorur dhe përdoret në të gjitha llojet e shkresave dhe komunikimet ligjore në SHBA ,e cila viteve të fundit përdoret edhe në Evropë. Kjo metodë që sugjerohet shpesh, është formula sipas së cilës kërkohet një organizim që përmban këto pjesë përkatëse,siç janë paraqitur në vijim:

- çështja,
- rregulli,
- zbatimi
- konkluzioni.

Ky model mund të shërbejë si udhërrëfyes i dobishëm për të shkruar analiza ligjore të lëmenjve të ndryshëm juridikë të karakterit hulumtues.

Hartuesi i shkrimit juridik sipas metodës IRAC duhet të identifikojë çështjen duke aplikuar rregullën dhe zbatimin e saj deri në sjelljen e konkluzionit. Sipas kësaj metode, përdorimi i këtyre elementeve shkrimit ligjor do ta bëjë të sistemuar dhe të kompletuar si tërësi.

SHKATHËSITË E PREZENTIMIT GOJOR -MËSIMET E DALE CARNEGIE-

(Kontribut për avancimin e shkathësive prezantuese për avokatë)

I. HYRJE

Që nga mesi i vitit 2003, me ndihmën e pakursyer të donatorëve, OAK është duke zbatuar programe të edukimit të përhershëm ligjor për avokatë.¹ Një komitet i veçantë me nëntë anëtarë, këto programe i ka ngritur mbi katër shtylla: a) Arsimimi intensiv ligjor (AIL) - është i ndërtuar nga programi i njohjes me legjislacionin e ri penal të Kosovës (KPPP dhe KPPK).² b) Arsimimi intensiv për avokatët e rinj (AIAR) - me dedikim për personat të cilët e ushtrojnë këtë profesion hyjnë për herë të parë, e të cilët kanë më tepër nevojë për thellimin e njohurive profesionale dhe zhvillimin e praktikave gjyqësore.³ c) Arsimimi i vazhdueshëm ligjor (AVL) - i dizajnuar ashtu që të jetë një zëvendësim për arsimimin e obligueshëm deri në krijimin e bazës ligjore për të. Ai është një program i trajnimeve, takimeve të punës, seminareve dhe kurseve për avokatë që aplikohen në shumë vende.⁴ d) Arsimimi ligjor për avokatët e çështjeve komerciale (ALAÇK) - është program që u dedikohet avokatëve të cilët merren me çështjet ekonomike dhe të tregut, transaksioneve dhe bizneseve.⁵

Për dallim nga fillimi, kur këto programe zbatoheshin nga ekspertë të jashtëm - ndërkombëtarë, Oda ka arritur që tani të sigurojë ekspertizë të mjaftueshme vendore. Kështu, tani këto programe në tërësi zbatohen nga ekspertët vendorë: avokatë, gjyqtarë, prokurorë publikë, profesorë, ekspertë të pavarur, juristë të dalluar.⁶ Është vlerësuar se ekspertët e angazhuar në programet AVL, përkundër dëshmisë së pakontestueshme për ekspertizën profesionale, nuk kanë poseduar shkathësi të mjaftueshme për transmetimin e njohurive të tyre profesionale te audienca, të cilës ia kanë dedikuar programin. Për të plotësuar këtë nevojë, me qëllim të avancimit të aftësive prezantuese të ekspertëve në programet AVL, OAK ka organizuar trajnimin intensiv për 24 avokatë, anëtarë të OAK-së në aftësitë prezantuese dhe metodat për një prezantim interaktiv.⁷ Në këtë trajnim, pjesëmarrësit kanë zgjeruar njohuritë e tyre për prezantim interaktiv dhe përdorimin e mjeteve dhe metodave konkretizuese si dhe bartjen e njohurive ligjore gjatë punës së tyre si ekspertë në programet e AVL.⁸

Megjithëse disa nga pjesëmarrësit e këtyre trajnimeve kanë filluar që të praktikojnë njohuritë e fituara, vlerësimet kanë vërtetuar se me këto programe nuk është përmbushur nevoja e prezantuesve për pajisjen me njohuritë mbi rregullat e prezantimit në programet AVL. Prandaj, kjo është një përpjekje, që jo vetëm ata, por të gjithë profesionistët ligjorë në përballjet e tyre me prezantimet, të përfitojnë nga mësimet e ekspertit të mirënjohur për prezantime publike -Dale Carnegie.⁹

1. Këshilli Ekzekutiv i OAK-së më 05.05.2003 (Vendimi nr.195/03) ka themeluar një komitet, në të cilin marrin pjesë 9 anëtarë, me detyrë që të dizajnojnë dhe zbatojnë një program të qëndrueshëm dhe të vetëmjaftueshëm edukimi të përhershëm ligjor për avokatë.

2. Përbëhet nga seminarët intensive në lidhje me institucionet e reja në sistemin penal-juridik të Kosovës. U zhvillua si program emergjent i përfundimit të njohurive profesionale dhe të zhvillimit të shkathtësive praktike në çështjet specifike penale. Ky program ka filluar në muajin dhjetor 2003, me nënshkrimin e LPPP dhe KPP të Kosovës dhe ka vazhduar edhe për dy vjet pas fillimit të aplikimit të tyre. Ai është duke u realizuar në formë të seminareve dhe tryezave javore, me gjithsej 108.55 orë program.

3. Një projekt i AILAR, njëvjeçar, dedikuar tani gjeneratës së tretë (gjenerata e parë me 50 avokatë është certifikuar prej 01.qershor 2004 deri më 15 qershor 2005, kurse e dyta me 56 avokatë prej vitit 2005 - 2006), ka filluar të implementohet me vendimin e KE e nën përkrahjen e tërësishme nga buxheti i OAK.

4. Qëllimi i këtij programi është zgjerimi i njohurive profesionale, zhvillimi i shkathësive praktike dhe diskutimi i zbatimit të rregullave të etikës.

5. Ka për qëllim ngritjen e resurseve profesionale të zyrave të avokatëve për çështjet nga ekonomia e tregut me qëllim të plotësimit të nevojave të komunitetit për shërbimet e nxitura nga hapja ekonomike e Kosovës me jashtë. Programe të veçanta të këtij edukimi janë zbatuar në bashkëpunim me partnerët, dhe atë gjithsej 22 orë program me 662 pjesëmarrës.

6. Deri më tani në programet e AVL, të zbatuara nga OAK, janë angazhuar 12 ekspertë ndërkombëtarë dhe 36 vendorë - „Raport i këshillit ekzekutiv të OAK, Arkivi i OAK, Prishtinë, rr.”Qamil Hoxha”, nr. 13/a.

7. Komiteti me përkrahjen e OSBE-së, ka realizuar dy nivele aftësimi për prezantuesit e programeve AVL. “Trajnimi për trajnerë – niveli i avancuar” është mbajtur më 22-24 shtator 2006, si vazhdimësi e projektit “Trajnimi për trajnerë”, mbajtur më 16-18 dhjetor 2005, raport nga CDRC për këshillin ekzekutiv të OAK-së, Arkivi i OAK, Prishtinë, rr.”Qamil Hoxha”, nr. 13/a.

8. Trajnimi me mbështetjen financiare nga OSBE - misioni në Kosovë, është mbajtur nga ekspertë të programit për ndërtimin regional të institucioneve (RIBA) që në atë kohë ishte një program i ABA/CEELI-it.

9. Dale Carnegie i filloi kurset e veta të oratorisë publike më 1912 në Nju-Jork. Atëherë oratoria publike shikohej si art, e jo si shkathësi, prandaj edhe qëllimet e mësimi ishin të drejtuara drejt krijimit të gojtarëve apo “folësve gojartë”. Njeriu afarist mesatar, që kishte dëshirë të zjartë për aftësinë e të shprehurit të vetëdijshëm dhe të lehtë në rrethin e tij, nuk dëshironte të shpenzonte të holla dhe të humb kohë kot për të mësuar mekanizmin e të folurit, formimin e tingujve, rregullat fonetike, fjalët e dekoruara dhe gjestikulimet oratorike. Dale nuk iu qas oratorisë publike si ndaj artit që kërkon një dhunti dhe anim të veçantë, por iu afrua asaj si një shkathësi, të cilën mund ta përballojë çdo njeri mesatarisht inteligjent, duke e zhvilluar më pastaj sipas dëshirës. Dorothy Carnegie, *How to Develop Self-Confidence and Influence People by Public Speaking*, Elta BS & Artini, Prishtinë, 2003, Parathënie, fq.3.

II. RREGULLAT STANDARDE MBI PREZENTIMIN GOJOR NË PROGRAMET AVL

Prezantimet në programet AVL duhet të jenë gojore dhe përfshijnë paraqitjen e çështjes sipas metodës interaktive e cila nënkupton përfshirjen aktive të pjesëmarrësve.¹ Programet AVL janë të dizajnuara për të edukuar e jo për të impresionuar, prandaj prezantuesit duhet të përdorin një gjuhë të thjeshtë dhe fjali të shkurtër.² Ata duhet të shpjegojnë temat të cilat vështirë mund të kuptohen edhe nga profesionistët.³ Gjatë prezantimit autorët duhet të kenë parasysh standardet e larta etike profesionale.⁴

III. THEMELET E PREZENTIMEVE TË SUKSESSHME⁵

Çdo veprimtari në jetën tonë është një lloj komunikimi, por pikërisht me të folurit njeriu dallohet nga krijesat e tjera. Ndërkaq, në kualitetin e të folurit ai më së miri shpreh individualitetin e vet, frymën e tij. Kur nuk është i zoti që, qoftë për shkak të nevrikosjes, frikës apo mendimeve konfuze, publikisht të shprehë atë që dëshiron të thotë, personaliteti i tij është i bllokuar, joshprehës dhe i keqkuptuar.⁶

Në cilindo art ekzistojnë vetëm disa rregulla dhe shumë punë praktike.⁷ Si njerëz të rritur dhe me përgjegjësi, jemi të interesuar për rrugën e shpejtë dhe të thjeshtë për fjalimet e suksesshme. E vetmja rrugë që mund të japë rezultate të shpejta është raporti i drejtë ndaj qëllimit që dëshirojmë ta arrijmë dhe vendosja e themeleve të forta mbi të cilat vlen të ndërtohet.⁸

A. Përvetësimi i shkathtësive themelore

Në takimin e parë, para fillimit të kursit, njerëzve u jepet rasti të thonë se pse dëshirojnë të regjistrohen dhe çka shpresojnë të arrijnë pas përfundimit të arsimimit.⁹

1) Mëshohuni nga përvoja e të tjerëve që të jeni të guximshëm - Nuk ekziston njeri për të cilin mund të thuhet se është orator i lindur. Në ato periudha të historisë, kur oratoria shikohej si art, që kërkonte përdorimin e ligjit të retorikës dhe bukurinë e ekzekutimit, edhe më vështirë ishte për t'u bërë orator i njohur. Sot për të folurit në publik mendojmë si për një bisedim të zgjeruar. S'ka më stil bombastik dhe as zë mallëngjyes. Atë që sot dëshirojmë ta dëgjojmë në mbrëmjet shoqërore, në TV dhe radio, është të folurit e rrafshët që është fryt i arsyes së shëndoshë, me të cilën folësi na drejtohet neve, dhe nuk e zhvillon një temë të paqartë.¹⁰

1. Kap.VIII, pika 1, Rregullat standarde mbi programet AVL, aprovuar nga komiteti AVL në Prishtinë, publikuara në "Avokatura", buletin i OAK, 5/2007.

2. Kap.VIII, pika 2, po aty.

3. Po aty.

4. Kap.VIII, pika 3, po aty.

5. Dale Carnegie i filloi kurset e veta të oratorisë publike më 1912 në Nju-Jork. Atëherë oratoria publike shikohej si art, e jo si shkathtësi, prandaj edhe qëllimet e mësimit ishin të drejtuara drejt krijimit të gojëtarëve apo "folësve gojartë". Njeriu afarist mesatar, që kishte dëshirë të zjarrtë për aftësinë e të shprehurit të vetëdijshëm dhe të lehtë në rrethin e tij, nuk dëshironte të shpenzojë të holla dhe të humb kohë kot për të mësuar mekanizmin e të folurit, formimin e tingujve, rregullat fonetike, fjalët e dekoruara dhe gjestikulimet oratorike. Dale iu qas oratorisë publike si ndaj artit që kërkon një dhunti dhe anim të veçantë, por iu afrua asaj si një shkathtësi, të cilën mund ta përballojë çdo njeri mesatarisht inteligjent, duke e zhvilluar më pastaj sipas dëshirës. Dorothy Carnegie, Psikologjia e Suksesit/3-Haw to Develop Self-Confidence and Influence People by Publik Speaking, Elta BS & Artini, Prishtinë, 2003, Parathënie, fq. 3.

6. Dale Carnegie, Psikologjia e Suksesit/3-Haw to Develop Self-Confidence and Influence People by Publik Speaking, Elta BS & Artini, Prishtinë, 2003, fq. 9

7.Po aty.

8.Po aty.

9.Po aty.

10. Po aty, fq.12 (Dale Carnegeoi shpjegon fillimet e tij: Klasat e mia të para i kam mësuar ashtu siç më kanë mësuar mua në kolegji, në Warrensburg, shteti Missouri. Ndërkaq, së shpejti, konstatova se ndodhem në rrugë të gabuar. Përpiqesha t'i mësoja njerëzit e rritur sikur të ishin brucoshë. Vërejtja se është e pakuptimtë për të marrë si mostër përgjasimin e gojëtarëve sikur Websteri, Brukea, Pitti dhe O Connelli. Së shpejti pas kësaj hodha të gjithë doracakët nga dritarja, u ngjita në podium dhe me disa ide të thjeshta i hyra punës me kursistët, gjersa i mësova sesi t'ua japin dëgjuesve, në mënyrë të bindshme deklaratën më të thjeshtë për një problem. Po aty, fq.12.)

2) *Mendoni në qëllimin që dëshironi ta arrini* - Përqendroni vëmendjen në atë se çfarë do të thotë për ju vetëbesimi dhe shkathtësia e prezantimit të suksesshëm. Paramendoni se çfarë domethënie ka kjo për ju në aspektin shoqëror, mendoni në miqtë që do të fitoni, në aftësinë e shtuar që të jeni të suksesshëm në shoqëri, në ndikimin që do ta keni në punë. Thënë shkurt, kjo do t'ju përgatisë për rolin e udhëheqësit.¹² Në artikullin *"Fjalimi dhe të udhëhequrit në botën afariste"* S.Alyn, president i shoqatave të prodhuesve të arkave regjistruese dhe udhëheqës i UNESCO-s, shkroi: *"Në historinë e punës sonë shumica kanë tërhequr vëmendjen me shkathtësitë oratorike. Para shumë vitesh një njeri, drejtues i filialit të vogël në Kansas, mbajti një fjalim bukur të pazakonshëm, ndërsa sot, ai nënkryetar i dikurshëm, është kryetar i kompanisë"*.¹³ Pikërisht ashtu siç e shkroi dr. David Allmani, kirurg nga Atlantic City dhe ish-president i Shoqatës amerikane të mjekëve: *"Përpiquni të bëni sa më shumë që mundeni që të mund të bëheni të aftë për t'u lejuar të tjerëve vështrimin në ndjenjat dhe mendimet tuaja. Mësoni që mendimet dhe idetë tuaja, qartë t'ua paraqitni të tjerëve, individualisht, në tubime, në pjesëmarrjen publike. Sa më shumë që të përparoni në këtë, aq më tepër do ta zbuloni se shkathtësia juaj - uni juaj i vërtetë - vepron te njerëzit në atë mënyrë dhe lë mbresa si kurrë më parë"*.¹⁵

3) *Përgatituni në shpirt për sukses* - Keni vendosur që ta rritni vetëbesimin dhe ta përmirësoni komunikimin. Prej tash mendoni pozitivisht e jo negativisht mbi mundësitë tuaja për të triumfuar në atë ndërmarrje.¹⁶ Duhet të kultivoni gjithnjë më shumë optimizëm, sa i përket nxitjes tuaj për të folur në tubime publike. Çdo fjalë, çdo veprimtari e përkushtuar zhvillimit të kësaj aftësie, duhet ta mbajë vulën e vendosmërisë suaj.¹⁷

4) *Shfrytëzoheni çdo rast për të ushtruar* - Askush nuk mund të mësohet të flasë bukur para publikut pa fjalim të mbajtur para tij, ashtu siç nuk mund të mësohet noti pa hyrë në ujë.²⁰ Rast për të folur ka në të gjitha anët. Bashkëngjituni në organizata në të cilat do të jeni të detyruar të flisni. Ngrihuni dhe dëshimohuni në tubimet publike. Mos qëndroni në takime të ulur në rreshtat e fundit. Flitni qetë dhe me zë. Anëtarësohuni në shoqata ku në mënyrë aktive do të keni rast të merrni pjesë në takime... Kurrë nuk do të mund ta kuptoni sesa do të mund të përparoni, përdërisa nuk merrni guxim të flitni, të flitni dhe të flitni.²²

12. Po aty, fq.17.

13. Po aty, fq.18 (Dale sqaron: Wiliam James, profesor eminent i biologjisë në Harvard, shkroi gjashtë fjali të cilat mund të bëheshin çelës për hapjen e shpellës së Ali Babës me tërë thesarin e fshehur të guximit: Në çdo gjë në jetë për suksesin vendimtare është pasioni ndaj tij. Nëse dëshironi të jeni i mirë, do të jeni i mirë. Nëse dëshironi të jeni i pasur, do të jeni i pasur. Nëse dëshironi të jeni i arsimuar, do të jeni i arsimuar. Por duhet të jeni i sigurt në atë që dëshironi, dhe ta dëshironi kryesisht atë, e jo të dëshironi me po aq pasion qindra gjëra të tjera që janë larg prej asaj që ju doni. Po aty, fq.19).

15. Po aty, fq.20.

16. Carnegie merr shembullin e Cezarit: Ç'bëri Jul Cezari për të siguruar suksesin e ushtrisë së tij, kur, në marshimin nga Gali lundroi kanalin, dhe me legjionet u zbkarkua në Anglinë e sotme? Bëri një gjë tejet të mençur: i ndali ushtarët në shkëmbinj të bardhë të Doverit, që nga lartësia prej dyqind shputash, nëpër valët, të shikojnë sesi gjuhët e flakës i kapërdijnë anijet me të cilat kishin arritur. Në vendin e armikut, kur ishte ndërprerë lidhja e fundit me kontinentin, kur u dogj mjeti i fundit për kthim, nuk mbeti rrugë tjetër, vetëm që të përparojnë për të pushtuar. Këtë edhe e bënte. Aq i guximshëm ishte Jul Cezari i famshëm. Pse edhe ju mos të jeni aq zemërak kur vendosni ta mposhtni frikën nga auditoriumi? Digjini pas vetes çdo ndjenjë dyshimi dhe mbyllni dyert e çelika, para së cilave përpiqeni për të ikur në të kaluarën e pasigurt. Po aty, fq.____.

17. Po aty, fq.22 (Në lidhje me këtë Carnegie jep shembuj: Clarence B.Randal, këshilltar shtetëror për ekonominë botërore, në njërin prej librave të tij mendjethellë, mbi gojëtarinë publike ka thënë: *"Kam tërë forcën e dekoratave, nga pjesëmarrja nëpër darkat dhe drekat solemne të të gjitha shoqatave të mundshme. Kam mbajtur fjalim aq patriotik gjatë Luftës së Parë Botërore, në Esanabi, shtet i Michigan-it, sa që edhe vetë u lajmërova për vullnetar... Madje, edhe pas një darke, mbajta fjalim në një frëngjishte të dobët.*

Ai më tutje sqaron: Në njërin nga kurset e mia në Perëndimin e Mesëm, një njeri, pa ngurrin u ngrit dhe deklaroi se si ndërtues i banesave nuk do të kënaqet, gjersa të mos bëhet delegat i Shoqatës Amerikane për ndërtimtari urbane. Joe Haverstrick këtë seriozisht e mendoj. Ishte nxënës që e ngazëllente arsimtarin: me seriozitetin e plotë. Me kujdes i përgatiste fjalimet, me kujdes i ushtronte ato, kurrë nuk mungoi nga ora, edhe pse në atë kohë kishte shumë punë. Për dy muaj u bë njëri ndër ndjekësit më të mirë të kursit dhe u zgjodh kryetar i klasës së vet. Një vit më vonë, arsimtari i atij grupi u gjend në Norfolk, shteti Virgjinia, dhe ja se çka shkroi: *"Plotësisht kisha harruar Joe Havertrick-un derisa një mëngjes gjatë kafjallit e hapa gazetën "Virginia Pilot". Në të ndodhej fotografia e Joe-s dhe artikulli ku shkruante më gjerësisht për të.. .kuptova se Joe nuk ishte bërë vetëm delegat i Shoqatës së ndërtimtarëve, ai ishte kryetari i saj"*.¹⁸ Po aty, fq.24.)

20. Po aty, fq.25 (Carnegie merr shembull Georg Bernard Shaw-in: "Kur e kishin pyetur Georg Bernard Shaw-in, sesi kishte mësuar të fliste aq bindshëm për publikun, ai u përgjigj: *"Ashu siç mësova të rrëshqas me qëndrueshmëri, veten e kam bërë budalla, gjersa u mësova në këtë"*. Shaw ishte njëri ndër djelmoshat më të turpshëm në Londër. Shpesh nëpër rrugë ecte rreth njëzet apo më tepër minuta para se të merrte guxim të trokiste. Pak njerëz, pranoi ai, kanë vuajtur dhe janë turpëruar aq shumë nga qyqarria. Më në fund rastësisht gjeti metodën më të shpejtë dhe më të sigurt për ta mundur qyqarinë dhe frikën. Vendosi që dobësinë e vet ta bëjë cilësi dalluese. U regjistrua në një klub për debate. Mori pjesë në çdo takim në Londër në të cilin publikisht diskutohet, prandaj, gjithnjë ngrihet dhe merrte pjesë në diskutim. U nxe për ide të socializmit, hapëronte para, dhe u transformua në njërin nga gojëtarët më të shkëlqyeshëm të pjesës së parë të shekullit njëzet. Po aty, fq.26).

22. Po aty.

5) Zhvillimi i vetëbesimit

E para: Nuk jeni të vetmit që frikësoheni të flisni para publikut. Anketat e bëra në fakultete, tregojnë se 80%-90% e studentëve vuajnë nga druajtja (frika fillestare).²⁴

E dyta: Është e dobishme që njeriu të ketë pak druajtje! Druajtja është mënyrë natyrore për t'u përgatitur për takim me nxitjet e pazakonshme të rrethit. Le të mos ju kaplojë paniku kur vëreni se me shpejtë dlersiteni. Gjithnjë i zgjuar për aktivitete të jashtme, trupi i juaj parapërgatitet për aksion. Nëse ato parapërgatitje fiziologjike mbesin në nivelin e kufijve normalë ju do të mund të mendoni më shpejtë, të flisni më rrjedhshëm dhe më bindshëm se në kushte normale.²⁵

E treta: Shumë oratorë profesionistë e vërtetojnë se kurrë nuk e humbasin plotësisht druajtjen. Ata që thonë se në çdo kohë janë të *ftohetë si trangulli*, zakonisht janë lëkurëtrashë posi trangulli dhe te publiku pikërisht zgjojnë aq interesin sa zgjon edhe trangulli.²⁶

E katërta: Frikësoheni ngase nuk jeni mësuar të flitni para masës. Frika është hibrid i pasigurisë, thotë profesor Robinsoni. Për shumë njerëz fjalimi publik është i panjohur dhe për këtë shkakton frikë e ngurrim. Për fillestarin ai është një seri e situatave të çuditshme që nxisin më tepër se mësimi i tenisit apo vozitja me automobil. Që ta thjeshtësoni këtë situatë tmerruese dhe ta bëni të qetë, ushtroni, ushtroni dhe sërish ushtroni.²⁷

6). Përgatituni si duhet²⁸

7). *Kurrë mos mësoni prezantimin fjalë për fjalë* - Njerëzit gjithë jetën flasin spontanisht duke mos menduar për fjalët, por për idetë. Nëse idetë i kemi të qarta, fjalët vijnë vetvetiu dhe në mënyrë të pavetëdijshme sikur frymëmarrja.²⁹ A mendoni se përgatitja e përsosur do të thotë fjalim i mësuar përmendësh? KURRSESI!³⁰ Nëse fjalimin e mbajmë mend fjalë për fjalë, është shumë e besueshme që do ta harrojmë kur të përballemi me dëgjuesit. Madje edhe nëse nuk e harrojmë fjalimin e mësuar përmendësh do ta themi mekanikisht. Pse? Ngase nuk del nga zemra por nga mbamendja. Kur flasim me njerëzit gjithnjë mendojmë në atë çka do t'u themi dhe atëherë e themi atë pa menduar në fjalët. Kështu ka qenë gjithnjë.³⁰

8) *Idetë duhet mbledhur dhe rregulluar paraprakisht* - Cila është, pra, metoda e qëlluar për përgatitjen e prezantimit? Thjeshte kjo: kërkon në përvojën tuaj çaste të rëndësishme që ju kanë mësuar për diçka në jetë, mbledhni mendimet tuaja, idetë tuaja, bindjet tuaja nga ato përvoja. Përgatitja e parë, do të thotë, mendimi mbi temat. Para disa vitesh dr. Charles Reynold Brown, në një seri të mrekullueshme të ligjërimeve, në Yale, tha: "Përpunoni temën nga të gjitha anët gjersa të mos bëhet ajo elastike dhe e lakueshme... më pastaj të gjitha ato ide i nënvizoni, vetëm në disa fjalë, vetëm aq sa ta ngërtheni kuptimin... Shkruajeni atë në copëza të letrës, do ta keni më lehtë t'i organizoni dhe t'i klasifikoni ato copëza të palidhura, atëherë kur të filloni ta rregulloni tërë materialin."³¹

24. Carnegie jep shembullin e njerit prej studentëve të tij: Zotëri Carnegie, para pesë vitesh erdha në hotel në të cilin keni mbajtur një nga kurset tuaja. Erdha deri te dera e dhomës dhe u ndala. E dija se nëse hyj në atë dhomë, herët a vonë do të duhej të mbaj fjalim. Nuk mblodha guximin për ta hapur derën që të hyj. U ktheva dhe dola nga hoteli. Sikur atëherë ta dija sesa lehtë është të mësosh për ta mposhtur frikën paralizuese nga auditoriumi, nuk do t'i humbja këto pesë vjet. Po aty, fq.28.

25. Po aty.

26. Po aty, fq.29.

27. Po aty.

28. Carnegie jep këtë ilustrim: Prezantimin kryesor në një darke solemne në Nju-Jork e mbante një nëpunës i njohur i qeverisë. Menjëherë u pa se fjalimin nuk e kishte përgatitur. Në fillim u përpoq të improvizojë dhe kur kjo nuk i shkoi ndoresh, nxori nga xhepi një tubë shënimesh, në të cilat mbretëronte një ngatërrim i përgjithshëm. Një kohë llototiti, bëhej gjithnjë më i mllëfësor, gjithnjë më i pakuptueshëm, më i penguar, por vazhdoi të përpëlitet, të kërkojë falje, orvatej t'u jipte njëfarë kuptimi shënimeve derisa, me dorë të dridhur, e ofroi gotën me ujë në buzët e terura. Ishte pamje e mjerë e njeriut të kapluar nga frika, dhe gjithë kjo për shkak të papërgatitjes së duhur. Më në fund u ulë, i turpëruar dhe i nënçmuar. Fjalimin e kishte përgatitur ashtu, siç do të thoshte Rousseau, se shkruhen letrat e dashurisë: *kishte filluar duke mos ditur për çka do të flasë dhe e përfundoi, duke mos ditur se çka kishte thënë*. Po aty, fq.32.

28. Po aty, fq.33.

29. Po aty.

30. Carnegie sjell shembullin e Churchil-it: Kur ishte i ri, Churchil-i, i shkruante dhe i mbante mend fjalimet e tij. Një dite kur mbajti fjalimin e mësuar përmendësh para parlamentit britanik, menjëherë mbeti si i ngrirë. Ishte i hutuar dhe i turpëruar. E përsëriti fjalë për fjalë fjalinë e fundit. Kujtesa iu zbehtë, ndërsa fytyra iu skuq. U ulë, dhe prej atëherë, kurrë më nuk ra në sprovë për të mbajtur fjalim të mësuar përmendësh. Po aty, fq.34.

31. Po aty, fq.36.

9). *Ushtroni prezantimin para miqve* - Idetë që i keni zgjedhur për fjalimin tuaj, shprehini në biseda të përditshme para miqve apo kolegëve të punës. Shikoni reaksionet, dëgjoni përgjigjet. Ndoshta do të merrni ndonjë vërejtje interesante e cila mund t'ju shërbejë.³²

B. Mënyrat e përgatitjes së suksesshme

1). *Thellohuni në temë* – Pasi që keni zgjedhur temën dhe e keni përpunuar atë po ashtu, duke "e provuar" atë para miqve, përgatitja ende nuk është e gatshme. Duhet që me themel t'i përkushtoheni temës së zgjedhur dhe të thelloheni në të. Duhet të bashkëjetoni me të gjitha detajet dhe kuptimet e thella të temës së zgjedhur, duke pyetur sesi me fjalimin tuaj, t'ju ndihmoni dëgjuesve që të bëhen njerëz më të mirë.³³

2) *Mos lejoni t'ju kaplojë zemërngushtësia* – Nëse, për shembull, paramendoni se bëni gabime gramatikore, belbëzoni apo frikësoheni se do të ndaleni në gjysmë të prezantimit, kjo me siguri se do t'ua lëkundë vetëbesimin, para vetë fillimit të ligjërimit. Është shumë me rëndësi që të mos merreni me veten tuaj para prezantimit.³⁴

3) *Silluni të vetëdijshëm* - Që të fitoni kurajë kur të përballeni me dëgjuesit, silluni sikur jeni tashmë të guximshëm. Natyrisht nëse nuk jeni të përgatitur, as i tërë aktrimi i kësaj bote nuk do t'ju ndihmojë. Me supozim se dini për çka do të flitni, dilni të mprehtë dhe merrni frymë thellë. Në të vërtetë merrni frymë tridhjetë sekonda para çdo daljeje pranë dëgjuesve. Depoja e shtuar e oksigjenit do t'ju çlodhë dhe do t'ju trimërojë.³⁵

Drejtohuni në tërë gjatësinë tuaj, shikoni dëgjuesit mu në sy dhe filloni të flitni me aq vetëbesim sikur secili nga të pranishmit t'ju ketë borxh një shumë parash.

4) *Flitni mbi atë që ju jep të drejtë përvoja jetësore apo njohuria e përfutur* - Gojëtarë të panumërt në tubime e ndeja bëjnë pikërisht një gabim. Vendosin të flasin për temat me të cilat nuk janë marrë, apo, fare pak ose asgjë nuk dinë për to.³⁶

5) *Rrëfëni për atë çka ju ka mësuar jeta* - Oratorët që flasin për jetën, ndonjëherë nuk e përfitojnë vëmendjen e dëgjuesve. Ata shmangen së shërbyeri me përvojën personale, duke e konsideruar të parëndësishme dhe të kufizuar. Me më dëshirë do të kapeshin për mbretërinë e ideve të përgjithshme dhe parimeve filozofike. Na japin editoriale, përderisa ne jemi të etshëm për lajme. Me rëndësi, megjithatë, është kjo: flitni mbi atë që keni përjetuar dhe me përkushtim do t'ju dëgjojnë.^a

32. Po aty, fq. 37.

33. Po aty, fq. 39.

34 Po aty, fq.

35. Sipas Carnegieut, tenori i madh Jan de Rezske thoshte se nervoza zhduket kur frymën e keni aq të fortë sa që mund të uleni mbi të, Po aty, fq. 41.

36. Carnegie jep një shembull pothuajse fascinant: Në një takim të arsimitarëve të mi në Chicago, njëri nga ndjekësit e kurseve filloi kështu: "Liria, barazia, vëllazëria. Këto janë ide të fuqishme në fjalorin e njerëzimit! Pa liri jeta nuk vlen të jetohet. Paramendoni se në çka do të ngjante jeta e njeriut sikur liria e veprimt të na kufizohej në çdo aspekt". Në atë vend e ndali arsimtari dhe e pyeti se pse beson në atë që tha. E pyeti se a ka ndonjë dëshmi apo përvojë personale që do ta përmbanin theksimin e tij. Na tregoi tregimin impresiv. Kishte qenë luftëtar në lëvizjen e rezistencës franceze. Fliste për nënçmimet që ai dhe familja e tij kishin përjetuar gjatë kohës së okupimit nazist. Në mënyrë piktoreske tregoi se si kishte ikur nga policia sekrete dhe si, më në fund, kishte arritur në Amerikë. Përfundoi me fjalët: "Sot kur ecja rrugës drejt hotelit kam qenë i lirë që sipas dëshirës sime të zgjedh se a do të hyj këtu apo të kaloj pranë hotelit. Hyra në hotel dhe nuk m'u desh që ta tregoj lejen e njoftimit, dhe kur ky takim mbaron mund të shkoj në cilindo vend në Çikago që vetë e zgjedh. Më besoni, për liri vlen të luftohet". Të gjithë e përshëndetën me duartrokitje të gjatë. Po aty, fq. 46.

37. Ja shembulli të cilin e sjell Carnegie: Para disa vitesh, një arsimtar mbante kursin e oratorisë publike për nëpunësit e bankave nga Nju-Jorku. Një të premtë z.Jackson doli nga enti, rrugës bleu gazetën e tij të preferuar dhe në hekurudhën nëntokësore, rrugës drejt vendit ku mbahej kursi, e kishte lexuar artikullin "Dhjetë vjet gjer te suksesi". Një orë më vonë u ngrit dhe përpqej bindshëm dhe me interesin të fliste për përmbajtjen e artikullit... Në të nuk kishte kurrfarë mësimi që digjet zjarr për t'u treguar, e këtë e dëshmuar edhe toni dhe mënyra e fjalimit. Si mund të priste se do të mund të linte përshtypje te dëgjuesi? U thirr në artikull, në fjalët e autorit. Në gjithë ato z.Jacksoni ishte shumë pak i pranishëm. Kur e përfundoi fjalimin, arsimtari tha: "Z.Jackson, nuk na intereson ai njeri i panjohur që e paska shkruar artikullin. Ai nuk gjendet këtu. Nuk e shohim. Neve na interesoni ju dhe idetë tuaja... Lexojeni sërish artikullin dhe mendoni se a pajtoheni me autorin e tij apo jo. Nëse pajtoheni, na tregoni pse. Le të jetë ky artikull pikënisje për ligjërimit tuaj të ardhshëm. Z. Jackson sërish e lexoi artikullin dhe përfundoi se me autorin fare nuk pajtohej. Gjetei shembuj për ta përkrahur mospajtimin. Zhvilloi dhe zgjeroi idetë nga përvoja e vet, si drejtues i bankës. Javën e ardhshme mbajti ligjëratë e cila mbështetej në bindjet dhe pikëpamjet e tija personale, 37. Po aty, fq. 47 – 49.

6). *Kërkoni temat në jetën e përditshme* - Cila është tema e qëlluar? Mund të jeni të sigurt se e keni temën e qëlluar nëse keni jetuar me të, nëse e keni fituar me përvojën dhe me të menduarit.

- *Fëmijëria dhe edukimi*. Temat që kanë të bëjnë me kujtimet në fëmijëri, në ditët shkollore, vazhdimisht e tërheqin vëmendjen, ngase neve, secilit, na intereson se çfarë vështirësish kanë pasur njerëzit e tjerë në rrethin në të cilin janë rritur dhe si i kanë përjetuar ato. Kudo që është e mundur futni ndodhitë nga rinia... nëse edhe pas shumë vitesh ju ka mbetur e gjallë në kujtesë ngjarja, atëherë gati me siguri do t'ju pëlqejë edhe dëgjuesve.³⁸

- *Lufta për afirmim në rini*. Edhe ky lëmë është i pasur me tema interesante. Vëmendja e grupit mund të tërhiqet duke ua treguar orvatjet e para që të depërtoni në jetë. Si e zgjidhët profesionin apo si gjetet punë? Çfarë loje e rastësisë ju ndihmoi që t'ia dilni në punë? Tregoni mbi dështimet personale, shpresat dhe triumfin. Fotografia realiste, e çfarëdo aventure jetësore, gjithnjë do të hasë në mirëkuptim, nëse është treguar me zemër.³⁹

- *Hobi dhe dëfrimi*. Nuk do të gaboni në zgjedhje nëse flitni diçka me të cilën merreni nga kënaqësia e pastër. Ngazëllimi për hobi do t'ju ndihmojë që atë temë t'ua ofroni dëgjuesve.⁴⁰

- *Lëmi i specializimit të ngushtë*. Duke u marrë me vite me të njëjtin profesion, jeni bërë mjeshtër në lëmin tuaj. Me siguri do t'ua tërhiqni vëmendjen nëse diskutoni duke u bazuar në vitet e përvojës apo të studimit.⁴¹

- *Ndodhitë e pazakonta*. A e keni takuar ndonjë personalitet të njohur? A keni marrë pjesë në luftë? A jeni ndodhur në krizë shoqërore? Këto përvoja ofrojnë materialin më të mirë gjatë ligjërimeve.⁴²

- *Besimet dhe bindjet*. Përgatitja e ligjërimeve nuk përbëhet nga shkrimi mekanik i fjalëve në letër apo nga mbamendja e ideve nga ndonjë libër i lexuar me shpejtësi, apo nga artikulli gazetaresk. Ajo përbëhet nga depërtimi në frymën personale dhe gjetja e ideve dhe besimeve që jeta i ka ve ndosur aty. Kurrë mos dyshoni se atje nuk ka materiale. Ka! Depot e pasura presin t'i zbuloni.⁴³

7). *Verifikoni se a ju ngazëllen me të vërtetë tema*

Ja pyetja që do t'ju ndihmojë që të vendosni mbi të përshtaturit e temës, për të cilën ndiheni të aftë të flitni para të gjithëve: nëse kushdoqoftë do t'i kundërvihet fort shpjegimit tuaj, a do të ishit të gatshëm, me bindje dhe sinqeritet, për ta mbrojtur pikëpamjen tuaj? Nëse jeni të gatshëm e keni zgjedhur temën e qëlluar.⁴⁴

8) *Tregojuni dëgjuesve dëshirën që fjalimin ta ndani me ta*

Ligjërimi mund të jetë i përgatitur mirë, mund të jetë në temën që ngazëllen oratorin, por, për sukses të plotë duhet të ekzistojë edhe një shkaktar. Oratori duhet t'i bindë dëgjuesit se atë që do t'ua tregojë është shumë e rëndësishme. Këtë do ta arrijë vetëm atëherë, nëse ngazëllimin personal e bartë te dëgjuesit.⁴⁵

38. Po aty, fq.50.

39. Po aty, fq.50.

40. Po aty, fq.50.

41. Po aty, fq.51.

42. Po aty, fq.51.

43. Po aty, fq.51.

44. Si zakonisht Carnegie jep shembull: Një njeri mblidhte pako të shkrepeve. Arsimitari e pyeti për këtë hobi të pazakonshëm dhe njeriu plotësisht u gjallërua. Së shpejti filloi t'i përshkruajë raftet në të cilët e radhiste koleksionin e vet. I tha arsimtarit se ka kutia gati nga të gjitha vendet e botës. Kur plotësisht u ngazëllua me temën e vet të adhuruar, arsimtari e ndërpreu: pse të mos më flisni mbi atë? Mua kjo më tingëllon si tejet interesante. U përgjigj se ai mendon që ajo temë askujt nuk do t'i interesonte! Ai njeri me vite qëndronte në hobin që për të gati ishte afsh, por megjithatë mendonte se nuk është temë për të cilën ka kuptim të flitet. Po aty, fq.54.

45. Edhe për këtë Carnegie sjell shembull: Një nga ndjekësit e kursit tim nëpunës i Institutit amerikan për bankieri, të cilët i mësoja vetëm sesi duhej ta mbanin fushatën e kursimit, assesi nuk ia dilte të vendoste kontaktin e suksesshëm me dëgjuesit. E këshillova të fillojë nga vetja dhe të mendojë mbi temën derisa nuk fillon të ngazëllehet. E përkujtova në faktin që, më tepër se 85% e njujorkasve vdesin pa kurrfarë mjetesh të kursyera dhe se vetëm 3.3% të njerëzve lënë 10.000 dollarë dhe me shumë. Duhej të mendonte vazhdimisht në atë se ai nga njerëzit nuk kërkon shërbim apo diçka që ata nuk mund t'ia lejojnë vetes. E këshillova që t'ia përsërisë vetes si i përgatitë ai njerëzit me atë që më së shumti u nevojitet në pleqëri, që gruan dhe fëmijët t'i lënë të përkujdesur. Duhej të kishte ndërmend se plotëson një detyrë të rëndësishme shoqërore. Thënë shkurt, duhej të bëhej misionar. Shpejt u nxeh për temën dhe erdhi në përfundim se me të vërtetë kishte mision të rëndësishëm. Kur doli në podium, fjalët e tija tingëllonin bindshëm. Ia doli t'i bindte dëgjuesit për të mirën e kursimit, ngase, sinqerisht dëshironte t'u ndihmonte njerëzve. Më nuk ishte vetëm gojtar i armatosur me fakte, por ishte misionar i cili kërkon ihtarë për ide më të vlefshme. Po aty, fq.56.

III. PREZENTIMI, ORATORI DHE DËGJUESIT

Në këtë pjesë do të shqyrtojmë trekëndëshin e prezantimit të cilin e ndërtojnë tri aspekte të secilës situatë biseduese.⁴⁶

1). *Mos e teproni në aspektin e përgjithësimin të temës* - Para shumë vitesh në kursin tim në Nju-Jork u regjistruan dy njerëz: doktori i filozofisë, që me diplomë ishte profesor fakulteti dhe njeriu që rininë e kishte kaluar në marinën britanike, që ishte pronar i një ndërmarrjeje për transport. Grupi shumë më mirë reagoonte në fjalimet e ish-marinarit sesa në ato të profesorit. Pse? Profesori përdorte gjuhën e bukur. Ishte i kulturuar, i lustruar, i rafinuar. Ligjërimet gjithnjë i kishte të logjikshme dhe të qarta, por mungonte diçka e rëndësishme - ana konkrete. Ishin të papërcaktuara dhe të përgjithshme. Kurrë nuk e ilustroi mendimin me përvojën personale, prandaj ligjërimet i kishte një sërë idesh abstrakte të lidhura me fije të holla të logjikës. Gjuha e transportuesit ndërkaq, ishte e përcaktuar, konkrete dhe piktoreske. Fliste me fjalorin e të përditshmes. E shfaqte mendimin, dhe pastaj e ilustronte me ndodhitë në punë. Gjallëria dhe freskia e të shprehurit i dhanë ligjërimet të tija notën e argëtimit dhe vlerës mësimore.⁴⁷ Kur e zgjidhni temën, me rëndësi është që ta përkufizoni lëmin e interpretimit dhe të mbeteni rreptësisht në kornizat e kufijve të caktuar. Mos gaboni që të orvateni ta përmbledhni tërë lëmin. Kjo vlen për secilën temë, pa marrë parasysh nëse është fjala për pjekjen e kuleçve, për lehtësimet tatimore apo për projektilet balistike. Temën duhet përkufizuar para fillimit të pjesëmarrjes dhe ta përshtatni me madhësi që dispononi.⁴⁸

2). *Përgatitni një rezervë të të dhënave* - Thonë se botaniku i njohur Luther Burbank, kishte kultivuar një milion bimë vetëm që të vinte deri te disa shembuj të përsosur. Miku im kirurg më tha: *Mund të të mësoj për pesë minuta sesi nxirret zorra e verbër, por do të nevojiteshin katër vjet për të mësuar se çka duhet bërë nëse shfaqen komplikimet*. Ashtu është edhe me oratorinë: gjithnjë përgatituni ashtu që të jeni të gatshëm për rrezikun, sikur për shembull, ndërrimi i poetës për shkak të përmbajtjes së prezantimit të diskutuesit paraprakë, apo ndonjë pyetje e drejtpërdrejtë nga dëgjuesit.⁴⁹

3) *Mbusheni prezantimin me ilustrime dhe shembuj* - Norman Vincent Peale, ligjërimet e të cilit në radio dhe televizion i kanë dëgjuar miliona njerëz, thotë se ilustrimi apo shembulli është formë e adhuruar e materialit ndihmës në ligjërim. Një reporter i tha se zakonisht shërbehej me disa shembuj për të mbështetur çdo porosi të rëndësishme.⁵¹ Ekzistojnë pesë mënyra për ta përvetësuar këtë metodë të materialit të ilustruar:

a) *Jepni prezantimit dimension njerëzor*. Prezantimi mesatar do të ishte më atraktiv kur do të pasurohej me tregime për njerëzit. Prezantuesi do të duhej të potenconte vetëm disa pika, dhe pastaj ato t'i sqaronte me shembuj të vërtetë. Një prezantim i përgatitur kështu duhet gjithsesi ta mbajë vëmendjen e dëgjuesve. Jeta juaj është materiali më interesant për njerëzit. Mos ngurroni të flitni mbi përvojën tuaj vetëm ngase druan se nuk duhet të flitni për vete. Njerëzit nuk duan të dëgjojnë sesi dikush flet për veten vetëm kur prezantuesi e bën këtë në mënyrë ofenduese dhe narcisoide.⁵²

b) *Emërtoni personat mbi të cilët flitni*. Kur flitni mbi të tjerët, gjithsesi duhet të shërbehni me emra, pa marrë parasysh se a janë të vërtetë apo të imagjinuar. Madje edhe emrat jopersonalë si, zotëri Smith apo Joe Brown janë shumë më të vërtetë se "ai njeri" apo "person". Emri jep përshtypje të autenticitetit dhe të individualitetit.⁵³

46. Po aty, fq.59.

47. Po aty, fq.60.

48. Po aty, fq.60.

49. Po aty, fq.63 (Carnegie, për këtë sjell dy mendime të çmueshme: Mark Tuen i kishte thënë: *Gjërat e shkruara nuk janë për fjalim. Formën e kanë librorë, janë të frenuara, jo të lakmueshme dhe nuk mundin që shkathësisht dhe me sukses t'i barten gjuhës*. Charles Ketterini, njëri ndër themeluesit e Gjeneral Motorsit, ishte njëri ndër oratorët më të njohur amerikan. Kur e pyetën se a kishte shkruar ndonjë nga ligjërimet e tij, ai u përgjigj: *Mendoj se atë që kam për ta thënë është së tepërmi e rëndësishme që të shkruhet në letër*. Po aty, fq.65).

51. Po aty, fq.65.

52. Po aty, fq.67.

53. Po aty, fq.68.

c) *Bëhuni konkret - mos i lëni pas dore hollësitë*. Për të ditur se a keni mbledhur mjaft detaje për ligjërimet, përdorni formulën prej pesë pyetjeve të cilës i përmbahet secili gazetar gjatë shkrimit të raportit. Përgjigjuni në pyetjet: **Kur? Ku? Kush? Çka? Pse?** Natyrisht, të përdorësh tepër hollësi është

më keq se të mos këtë fare. Në shkollë gjithnjë na kanë mërzhitur me numërimin e stërgjatë të hollësive sipërfaqësore. Secila nga ato pesë pyetje ka përgjigje të mjaftueshme dhe përmbajtësore. Nëse një prezantim e mbushni së tepërmi me hollësi, dëgjuesit do ta kritikojnë atë duke mos e dëgjuar me vëmendje. *S'ka kritikë më të rreptë se dëgjuesit e pakujdesshëm.*⁵⁴

d) *Dramatizoni fjalimin me anë të dialogut.*

e) *Jepni prezantimit dimensionin vizuel.* Psikologët thonë se 85% të njohurisë vjen përmes përshtypjes vizuele: pa dyshim, kjo e arsyeton suksesin e madh të televizionit, si medium për reklamim dhe argëtim. Prezantimi publik është edhe shkathtësi vizuale dhe auditive. Vendosija e shembujve vizuelë është njëra nga mënyrat më të mira të pasurimit të prezantimit. Do të mundnit, me orë të tëra, të flitni sesi silleni me shkopin e golfit, por kjo mua do të më bezdiste. Por të ngriheni dhe me lëvizje të tregoni sesi arrini që topthi të mbetet në shteg, i tëri do të shndërrohem në sy e vesh. Nëse fluturimi i aeroplanit, që për pak nuk është rrëzuar, përshkruhet me dorë dhe krah, kureshtja ime që të dëgjoj sesi keni qenë në rrezik të vdekjes, do të jetë më e madhe.⁵⁵ Filloni me përshkrime, ngase, siç kanë thënë kinezët, një fotografi vlen më tepër se dhjetë mijë fjalë.⁵⁶

4) *Shërbehuni me fjalë konkrete për t'i magjepsur fotografitë* - Për ta fituar dhe mbajtur vëmendjen – që është qëllimi i parë i çdo ligjëruesi - ekziston një mjet ndihmës, veprim tejet i rëndësishëm, të cilin shumë njerëz e lënë pas dore: shfrytëzimi i fjalës së përshtatshme për formimin e fotografisë. Është lehtë të dëgjosh prezantuesin që na magjeps me fotografi para syve. Kush përdor simbole mjegulluese të pangjyra dhe të thjeshta, e vë në gjumë auditoriumin. Fotografitë! Fotografitë! Fotografitë! Janë të lira si ajri që thithim, prandaj është lehtë për t'i thurur në ligjërim apo bisedë. Po të veproni ashtu, do të bëheni gojëtar argëtues dhe njeri me ndikim në shoqëri.⁵⁷ Faqet e Biblës dhe të Shekspirit vlojnë me thënie piktoreske. Si është shprehur Shekspiri me fjali të pavdekshme piktoreske: *E praruan arin, e ngjyrosën zambakun, me aromë e spërkatën shalqinin.* A keni vërejtur se aforizmat që barten nga gjenerata në gjeneratë, gati gjithnjë janë thënie piktoreske? *Më mirë trumcaku në dorë sesa pëllumbi në degë! Kalin mund ta sillni deri te uji, por nuk mund ta detyroni të pijë! Dinak posi dhelpra. I dehur tapë. I fortë si guri.* Lincloni përherë ka përdorur shprehje piktoreske. *Kur blej kalë, tha ai, nuk dua të më thonë sa qime i ka në bisht. Vetëm dua të di si janë cilësitë e tij.*

Shprehuni në fjalim me fotografi të caktuara dhe të shkoqitura. Paraqitni pamjen që e përshkruani në mënyrë aq piktoreske sa që të duken siluetat e brirëve të kaprojeve të shkëlqyera me diellin në muzg. A është më piktoreske të thuhet: *poni i zi shetland*, sesa të flitet për "kalin"? A nuk përfytyron shprehja "Gjeli i vogël i bardhë me këmbën e thyer", fotografinë e caktuar dhe më të qartë sesa nëse thuhet vetëm "gjeli"?⁵⁸ *Stili abstrakt*, tha filozofi francez Alain, *gjithnjë është i dobët. Fjalitë duhet të jenë përplot gurë, metale, karrige, tavolina, burra dhe gra.*⁵⁹

5) *Gjallërimi i prezantimit* - Vitaliteti, frymëzimi, dalldia - këto janë tri karakteristika të rëndësishme të prezantuesit. Gojëtari energjik papërballueshëm tërheq njerëzit.⁶⁰ Ja disa nga mënyrat e sigurta të cilat mund t'ju ndihmojnë që të futni ngazëllim dhe entuziazëm në prezantim.

- *Zgjidhni temën në të cilën besoni fort.* Nëse nuk jeni të lidhur emocionalisht me lëndën mbi të cilën synoni të flitni, nuk mund të pritni se dëgjuesit do t'i besojnë porosisë suaj. Nëse e zgjidhni temën që ju ngazëllen, sepse një kohë të gjatë merreni me të... atëherë lehtë mund të flitni me ngazëllim.⁶¹ Nëse prezantuesi beson thellë, dhe atë e thekson bindshëm, do të fitojë ithtarë, madje edhe atëherë nëse thekson se nga pluhuri dhe hiri mund të prodhohet bari i kaltër!

54. Po aty, fq.70.

55. Po aty, fq.72.

56. Po aty, fq.72.

57. Po aty, fq.73.

58. Po aty, fq.74.

59. Po aty, fq.75.

60. Po aty, fq.76.

61. Po aty, fq.78.

Atëherë sa të bindshme do të jenë bindjet tona nëse janë në anën e së vërtetës dhe të arsyes së shëndoshë. ⁶²Në historinë e oratorisë suksese më të mëdha kanë arritur ndjenjat e thella dhe bindjet. Singëriteti prehet në besim, ndërsa besimi është çështje e zemrës dhe e ndjenjave të ngrohta, e barabartë si dhe çështja e mendjes dhe të menduarit të ftohtë. ⁶⁴

- *Silluni bindshëm*. Kur të dilni para dëgjuesve, le të bëhet kjo me qëndrim të vetëbesimit dhe pritjes - shpresës, e jo sikur t'ju shpie dikush në trekëmbëshin për varje. Gjallërimi i ecjes mund të jetë i qëllimtë, por do të ndihmojë, ndërsa, dëgjuesit do të fitojnë përshtypjen se ju mezi prisni të flitni. Menjëherë para fillimit, frymoni lehtë. Largohuni nga tavolina e prezantuesit. Ngrini kokën, qiteni mjekrën përpara. Ta dini se jeni të gatshëm të thoni diçka me rëndësi, e kjo duhet të shihet në pamjen tuaj. Edhe gjesti më i vogël, me të cilin e përcillni fjalimin, do të kontribuojë të çlirohëni dhe do t'ju japë nxitje. Filozofi William James thoshte: Silluni bindshëm dhe me çdo gjë me çka merreni, natyrshëm do të bëhet e bindshme. ⁶⁵

- *Përshtateni prezantimin sipas dëgjuesve*. Russel Cenwell, ligjërimin e vet të famshëm "Toka e diamanteve", e mbajti gati gjashtë mijë herë. Mashtroheni nëse mendoni se Cenwell gjithnjë fliste në të njëjtën mënyrë, me fjalor të njëjtë dhe intonim... asnjëherë plotësisht nuk e kishte përsëritur, edhe pse përherë fliste mbi temën e njëjtë. ⁶⁶

- *Flitni për gjërat që janë të afërta për dëgjuesit*. Këtë pikërisht e kishte bërë dr. Conwell. U përpoq që në ligjërim të vërë shumë raste lokale dhe ilustrime. Dëgjuesit kanë treguar interesim ngase ligjërimi ishte për ta, mbi problemet dhe dëshirat e tyre... kjo ju siguron vëmendjen dhe ju ofron mundësinë e komunikimit. ⁶⁷

- *Tregojuni dëgjuesve respekt të singërtë*. Auditoriumi përbehet nga individë dhe ata reagojnë si individë. Nëse për diçka i kritikoni haptas dëgjuesit, kjo nuk do t'ju pëlqejë. Lavdëroni diçka të dobishme që kanë bërë dhe rruga drejt zemrave të tyre do t'ju hapet. Kjo natyrisht kërkon hulumtim. Frazat sikur *ky është publik inteligjent para të cilit kurdoherë kam mbajtur fjalim me kënaqësi*, zakonisht, çdokush i hedh si lëndë të zbrazëta. ⁶⁹ Nëse nuk mund të shprehni respekt të singërtë, më mirë mos shprehni kurrfarë respekti. Deklarata jo e singërtë ndoshta, mund ta mashtrojë individin, por auditoriumin asnjëherë. ⁷⁰

- *Njëjtësohuni me dëgjuesit*. Sa më parë që është e mundur, më së miri me fjalët e para, vendosni kontakt të drejtpërdrejtë me masën së cilës i drejtoheni. Nëse jeni të nderuar me ftesën thoni këtë. Dëgjuesve mund t'ju afroheni dhe t'ua përmendni emrat e disa individëve që janë prezentë. Megjithatë, keni vëmendjen: nëse dëshironi t'i përmendni emrat e huaj që i keni mësuar me atë rast, kushtoni rëndësi asaj që t'ju thoni drejt dhe të keni shkas të arsyeshëm se pse i përdorni dhe mos i numëroni së tepërmi. Përdorimi i përemrave "ju", në vend se "ata", gjithashtu e forcon vëmendjen e dëgjuesve. ⁷¹

62. Po aty, fq. 79 (Carnegie tregon se si "njëherë në Baltimor kishte dëgjuar fjalimin e një kursisti, i cili tërhiqte vërejtjen për shfarosjen e një lloj peshku në bregun e Chesapeakut." Fliste i angazhuar dhe me zjarr, dhe me të vërtetë tregonte brengosje të singërtë. Para se të fillonte të fliste, nuk e dija se a ekziston një lloj i tillë i peshkut në bregun e Chesapeakes, dhe supozoj se më shumë se gjysma e dëgjuesve e ndanin mosdijen time. Mirëpo, në fund të fjalimit, sigurisht se të gjithë do ta nënshkruanin peticionin që ai lloj i peshkut të mbrohet me ligj." Po aty, fq. 80).

63. Po aty, fq. 80.

64. Carnegie sjell një kujtim të vetin: Më kujtohet një avokat nga Bostoni, i cili karakterizohej me një prezantim jashtëzakonisht të bukur dhe fliste pabesueshëm lehtë dhe rrjedhshëm, por kur e përfundonte fjalimin, njerëzit vetëm thoshin: *Djaloshi i kulluar*. Kaluan më shumë se njëqind vjet nga vrasja e Abraham Lincolnit, por singëriteti i fjalëve të tija dhe jetës së tij ende jeton me ne. Shumë bashkëkohës ia tejkalonin me dituri, me elegancë, me këndshmëri dhe sjellje të mirë. Megjithatë, ndershmërinë dhe singëritetin e Lincolnit, në Gettysburg dhe në shkallët e Capitolit, në Washington, asnjëri deri më tani nuk e arriti. Po aty, fq. 82.

65. Po aty, fq. 85.

66. Po aty, fq. 86.

67. Po aty, fq. 87 (Për këtë Conwelli udhëtoi në qytetin apo në vendin mjaft herët që ta njoftojë drejtorin e postës, rojtarin, drejtorin e hotelit, drejtorin e shkollës, pastaj vizitoi disa shitore dhe bisedoi me njerëzit që të kuptojë diçka mbi të kaluarën e tyre dhe mbi atë se si jetojnë tash. Vetëm atëherë ishte i gatshëm për ligjërim, ngase atyre njerëzve mund t'ju fliste për temat që ishin të afërta për ta. Po aty, fq. 86.

69. Po aty, fq. 91.

70. Po aty, fq. 92.

71. Po aty, fq. 93.

- *Ftoni dëgjuesit për bashkëpunim*. Posa të zgjidhni ndonjërin prej dëgjuesve që t'ju ndihmojë për ta arsyetuar mendimin apo idenë e dramatizuar, vëmendja më e madhe ka për t'u rritur. Nëse në mes të dëgjuesve dhe prezantuesit ekziston muri, prania e publikut do ta rëndojë atë. Metoda ime e adhuroar për të arritur bashkëpunimin me dëgjuesit është parashtimi i pyetjeve në të cilat përgjigjen ata. Adhuroj kur dëgjuesit ngrihen, e përsërisin fjalë për fjalë fjalinë pas meje, apo përgjigjen në pyetjen me ngritjen e dorës. Pa këtë shfaqje të vogël, ndoshta auditoriumi do të merrej me mendime mbi atë se ç'ka për të ngrënë për darkë apo, çfarë është programi në televizion.⁷²

- *Dilni në skenë me modesti*. Në raportin dëgjues-prezantues asgjë nuk mund ta zëvendësojë sinqeritetin. Nëse dëgjuesve u tregoni se konsideroni veten superior, me siguri se do të kthehen kundër jush. Gjatë kohës së prezantimit ndodheni sikur në vitrinë dhe çdo vijë e fytyrës dhe e karakterit tuaj është një pano-reklamë. Edhe aluzioni më i vogël për lavdërim do të lë këtë përshtypje. Në të kundërtën, modestia provokon besimin dhe vullnetin e mirë. Në librin *"Bibliografia e liderëve fetarë"*, Henry dhe Dara Lee Thomas, thonë për Konfuqin: *"Kurrë s'është përpjekur që t'i magjeps njerëzit me njohjen e jashtëzakonshme. Vetëm është përpjekur t'i ndriçojë me mirëkuptimin e tij."*⁷³

Ja edhe disa prej rregullave të Carnegieit për prezantim të suksesshëm:

- *Përshtatjani temën kohës që keni në dispozicion,*⁷⁴
- *Radhitni mendimet sipas rendit logjik,*⁷⁵
- *Termet e panjohura krahasoni me ato të njohura,*⁷⁶
- *Faktet tregoni në mënyrë përshkruese,*⁷⁷
- *Shmanguni nga shprehjet shkencore,*⁷⁸
- *Shërbehuni me mjete ndihmëse vizuale,*⁷⁹
- *Mos i imitoni të tjerët - bëhuni ai që jeni.*⁸⁰

72. Percy H. Witing në librin *"Humori në fjalim dhe shkrim"*, thotë: *Ligjërimi s'është recitim. Atij i duhet mirëpritja e dëgjuesve, nevojitet që dëgjuesit të marrin pjesë në atë ndërmarrje.* Dëgjuesit që marrin pjesë në ligjërime kanë status të bashkëpunëtorit. Po aty, fq. 89.

73. Po aty, fq. 98 (Po kështu: Kap. VII. pika 2 i rregullave standarde mbi programet AVL, që i kushtohet prezantimit gojor, përcakton se: "Programet AVL janë të dizajnuara për të edukuar e jo për të impresionuar", "Avokatura", buletin i OAK, Prishtinë, 5/2007). Një nga profesorët më të adhuroar dhe më të popullarizuar në universitetin Yale gjithsesi ishte William Lyon Phelps. Në librin *"Kënaqësia e dhënies së mësimi"*, ai thotë: *Për mua dhënia e mësimi është më shumë se shkathhtësia dhe titulli. Ajo është pasioni imi. Adhuroj të jap mësim, ashtu siç piktori adhuron të pikturojë, këngëtari të këndojë, ndërsa poeti të shkruajë vjersha. Çdo mëngjes kur zgjohem nga shtrati me entuziazëm mendoj për studentët e mi.* Billy Phelps pati një ndikim të madh te studentët e vet, më së shumti për shkak të dashurisë, pasionit dhe entuziazmit me të cilat ishin kapluar ligjërimet e tija. Dale Carnegie. Po aty, fq. 244.

74. "Fillestarët janë të ngjashëm me udhëheqësit të cilët dëshirojnë të na tregojnë Parisin brenda një dite. Kjo është e mundshme, ashtu siç është e mundshme të kalohet nëpër secilin muze për tridhjetë minuta, por nuk na ofron as kënaqësi, as mësim". Po aty, fq. 121.

75. Gati çdo temë mund të përpunohet me shembullin e parimit të radhës logjike, qoftë nëse bëhet fjalë për renditjen kohore, qoftë atë hapësinore, apo përmbajtjesore. Në renditjen kohore, temën mund ta vështrorjmë nga aspekti i së kaluarës, i së tashmes dhe i së ardhmes, apo mund të fillojmë me datën e caktuar dhe të shkojmë nga ajo prapa apo para. Numri i hollësive që dëshironi t'i shfaqni në ligjërim do të varet, natyrisht, nga koha që keni në dispozicion. Në renditjen hapësinore idetë vlen të organizohen rreth pikës qendrore dhe të fillohet nga aty në një drejtim apo edhe në katër drejtime: veri, jug, lindje dhe perëndim. Disa tema e kanë vetvetiu një rend të gatshëm të caktuar. Nëse dëshironi të flitni për strukturën e qeverisë apo të rendit shoqëror, më së miri do të jetë ta përcillni strukturën ekzistuese të organizimit sipas skemave ligjore. Po aty, fq. 123.

76. Për ju problemi është plotësisht i qartë, por ai kërkon sqarim rraskapitës në mënyrë që dëgjuesit ta kenë të qartë. Çka do të bëni? Krahasoni me diçka që dëgjuesit e kuptojnë. Po aty, fq. 125.

77. Po aty, fq. 126.

78. Shprehuni me fjalë të thjeshta dhe komentoni hollësitë e nevojshme. Po aty, fq. 128 (*Ngjashëm edhe*: Kap. VIII, pika 1, rregullat standarde mbi programet AVL "... prezantuesit duhet të përdorin një gjuhë të thjeshtë dhe fjalë të shkurtra. Ata duhet t'i shpjegojnë termet të cilat vështirë mund të kuptohen edhe nga profesionistët", "Avokatura", buletin i OAK, Prishtinë, 5/2007).

79. *Nervat që lidhin syrin me trurin janë shumë më të trasha se ato që lidhin veshin me trurin. Shkenca na përkujton që shqisave të të parit u kushtojmë vëmendje njëzet e pesë herë më shumë sesa atyre të të dëgjuarit... Tregimi grafik apo diagrami duhet të jenë mjaft të mëdha, në mënyrë që t'i shohin të gjithë... Përdorni shkurtesat, shkruani me shkronja të mëdha dhe lexueshëm, flitni derisa shkruani me vizatoni dhe kthehuni drejt dëgjuesve... Kur ta tregoni ekzemplarin, ngrini lart që ta shohin të gjithë. Një ekzemplar në lëvizje vlen më shumë se dhjetë të tjerë statikë. Gjatë kohës së fjalimit mos i ngulni sytë në ekzemplarin - orvatuni që të komunikoni me dëgjuesit e jo me lëndën... Po aty, fq. 132.*

80. Secili është jetë e re, një individualitet i ri. Kurrë para jush s'ka ekzistuar njeri i tillë, dhe as që ka për të ekzistuar më. Kështu duhet të mendojë për vete secili njeri. Duhet që në vete të kërkojë shkëndijën e individualitetit, përmes së cilës dallohet nga gjithë të tjerët dhe të përpriqet që, sa më fuqishëm të shndrisë. Shoqëria dhe shkolla përpriqen ta fikin, duke u përpjekur që, të gjithëve, të na vendosin në kallëp të njëjtë, por unë ju them: mos lejoni që ajo të shuhet, ajo është e drejtë juaja e vetme për veçanti. Po aty, fq. 164 (Në programet AVL "Prezantuesit inkurajohen që të përdorin lirish idetë, informacionin dhe njohuritë për çështjet", kap. VI/2, rregullat standarde mbi programet AVL, "Avokatura", buletini i OAK, Prishtinë, 5/2007).

DISA ÇËSHTJE TË PROCEDURËS KUNDËRVAJTËSE NDAJ TË MITURVE

Në Ligjin për kundërvajtje të Kosovës, ekzistojnë paqartësi dhe mangësi të shumta, meqë i njëjti është në zbatim rreth tri dekadave dhe prej atëherë nuk ka pësuar asnjë ndryshim apo plotësim eventual, përkundër ndryshimeve që janë bërë në lëmin penal, me të cilën fusha kundërvajtëse qëndron në afërsi dhe ngjashmëri formale dhe materiale.

Ligjit në fjalë i mungojnë: institutet themelore që përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse në kushte dhe në rrethana që i parashohin ligjet e tjera në të drejtën penale, i mungojnë parimet themelore të procedurës kundërvajtëse si dhe rregullat e tjera të procedimit si ndaj të pandehurve madhorë ashtu dhe ndaj të miturve si kryes të veprave përkatëse kundërvajtëse.

Ligji i cituar përmban dispozita të cilat të miturin e vënë në pozitë më të disfavorshme në raport me të pandehurit madhorë, p.sh. nenin 254 i Ligjit mbi kundërvajtjet është në kolizion me nenin 195 të po këtij ligji si dhe në kolizion me nenin 71 LPMK, ngase sipas nenit 195 të LK, shprehimisht përcaktohet se i pandehuri madhor në procedurën kundërvajtëse në kushte dhe rrethana të caktuara ligjore për një vepër të kryer, mund të shpallet “PËRGJEGJËS” kurse në të njëjtat kushte dhe rrethana i mituri mund të shpallet “FAJTOR”, ky përcaktim është në kolizion edhe me nenin 71 LPMK dhe standardet e së drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat e LPMK, ndaj të miturve si kryes të disa nga veprat të parapara penale ju ofrojnë mbrojtje dhe trajtim më të favorshëm, bazuar në faktin se parashohin mundësinë e përcaktimit -shqiptimit të disa masave të diversitetit, përkundër dispozitave kundërvajtëse në këto rrethana parashihen vetëm dy raste kur të miturit mund t’i shqiptohet masa edukative:

1. vërejtje gjyqësore dhe
2. mbikëqyrje e shtuar nga ana e prindërit (në kohëzgjatje jo më tepër derisa i mituri të mbush moshën madhore).

Procedura kundërvajtëse ndaj të miturve është specifike dhe e veçantë, kjo ndikon që shkeljet procedurale të manifestohen diku me rrallë e diku më shpesh, ndaj dhe duke marrë parasysh moshën dhe tiparet e tjera të personalitetit të të miturit, është e natyrshme të konsiderohen si shkelje esenciale (të rënda) të procedurës kundërvajtëse.

Pas mbarimit të luftës dhe rifillimit të punës së gjyqësorit në Kosovë, falë IGJK-së, dhe përfshirjes të disa gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje të Kosovës, përmes trajnimeve profesionale, është arritur që sado pak këto shkelje procedurale aq sa është e mundur të minimizohen, përkundër faktit se gjendemi në fazën e ndryshimeve të tërë infrastrukturës ligjore, ku janë gjithashtu në zbatim një mori ligjesh dhe dispozitash të tjera të së drejtës ndërkombëtare në Kosovë.

Duke u mbështetur në këto kushte dhe rrethana të lartpërmendura, qëllimi i këtij trajnimi ka për synim ofrimin e ndihmesës modeste të gjyqtarëve të shkallës së parë në mënyrë që procedura kundërvajtëse ndaj të miturve të zhvillohet dhe zbatohet konform normave ligjore vendore dhe të standardeve të së drejtës ndërkombëtare në këtë fushë.

Përfundimisht duke u bazuar në eksperiencën e punës së deritanishme, në pika të shkurtra në këtë prezentim do t'i paraqesim disa nga rastet më të zakonshme të shkeljeve procedurale ndaj të miturve si kryes të veprave kundërvajtëse.

Shkeljet procedurale në kuptimin e përgjithshëm, natyrisht kanë pasojat e njëjta edhe në procedurën kundërvajtëse ndaj të miturve, megjithëkëtë kjo procedurë ka disa specifika, andaj sot në këtë prezentim shkurtimisht do të fokusohemi në disa nga rastet më të zakonshme të shkeljeve procedurale të cilat ekskluzivisht manifestohen si shkelje të veçanta (të posaçme) gjatë fillimit dhe zhvillimit të procedurës kundërvajtëse ndaj të miturve, si kryes të veprave kundërvajtëse.

Për ta pasur më të qartë këtë, sot do të bëjmë një simulim gjykimi të një rasti për një të mitur i cili pandehet t'i ketë kryer dy vepra kundërvajtëse, njëren nga rendi dhe qetësia publike, kurse tjetrën nga siguria e trafikut rrugor.

Kryerje e veprave kundërvajtëse në bashkim real dhe ideal (neni 13 LK).

1. Një prej rasteve të shkeljes së mundshme të procedurës kundërvajtëse ndaj të miturve ndodhet kur i mituri kryen disa vepra kundërvajtëse në bashkimin real apo ideal, kurse gjykata e faktit të njëjtit i shqipton dy dënime, p.sh. për veprën e parë dënimin me burgim në kohëzgjatje deri 15 ditë, kurse për veprën e dytë i shqiptohet dënimi me gjobë.

Kjo mënyrë e të gjykuarit bie ndesh me të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare, ngase në këtë rast gjykata ka pasur mundësinë që të miturit t'i shqiptojë vetëm dënimin me të ashpër, në rastin e dhënë vetëm dënimin me burgim në kohëzgjatjen e përmendur.

Shqiptimi i dënimit mbi maksimumin e paraparë me ligj

2. Raste të tjera të shkeljeve të dispozitave esenciale të procedurës kundërvajtëse ndaj të miturve ndodhin kur gjykata një të mituri i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje me tepër se 15 ditë, apo i shqipton gjobën mbi maksimumin e paraparë me ligj.

Zbatimi i gabuar i nenit 267 të LK

3. Rast edhe më të rëndë të shkeljes së kësaj procedure mund të ndodhë kur gjykata ndaj të miturit i shqiptohet dënimi me burgim duke vendosur që i mituri të dërgohet menjëherë në vuajtjen e këtij dënimi para se aktvendimi të marrë formë të prerë, konform nenit 267 të LK. Se çfarë pasojash mund të sjellë kjo mënyrë e vendosjes për të miturin, mendoj se nuk ka vend dhe arsye për të sqaruar më tepër.

Parashikimi i dënimit alternativ: me gjobë dhe me dënim burgimi

4. Kjo shkelje procedurale mund të ndodhë kur një i mitur kryen një kundërvajtje nga rendi dhe qetësia publike p.sh. të sanksionuar sipas nenit 21 al.1 pika 1 të LRQP, dhe gjykata të njëjtit i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 10 ditë, edhe pse për këtë vepër parashihen dy mundësi dënimesh alternative, alternativa e parë me gjobë, kurse alternativa e dytë me dënim burgimi.

Në rastin e dhënë alternativa e dytë mund të zbatohet vetëm kur të pandehurit janë të moshës madhore dhe veprën ta kenë kryer në rrethana objektive dhe subjektive veçanërisht rënduese,

(shkallë të lartë përgjegjësie, shkaktimi i pasojave të rënda, rastet recidive e tjera), gjë që edhe në këto raste gjykata e shkallës së parë duhet në mënyrë të veçantë t'i arsyetojë shkaqet dhe rrethanat që justifikojnë zbatimin e alternativës së dytë.

Shkelje të nenit 249 LK

5. Shkelje procedurale të kësaj natyre janë reflektuar në intervale më të shpeshta të rasteve, kjo ndodh kur gjyqtari të miturin nuk e thërret – nëpërmjet prindërit apo kujdestarit të tij në seancën e shqyrtimit të çështjes kundërvajtëse, (neni 249 të LK).

Shkelje të nenit 252 LK

6. Ngjashëm me këtë ka pasur disa raste kur gjykata e shkallës së parë fare nuk e informon QPS-organin e kujdestarisë, përkatësisht nuk i njofton fare me rrjedhën e procedurës për t'iu dhënë mundësi të bëjnë propozime lidhur me faktet e rëndësishme të natyrës objektive dhe subjektive për të miturin.

Mospërfillja e nenit 26 LK

7. Kjo shkelje manifestohet kur gjykata e shkallës së parë, para se të vendosë lidhur me masën sanksionuese apo edukative ndaj të miturit, paraprakisht nuk e kërkon mendimin e QPS. Organit të kujdestarisë së cila masë do të ishte më efektive t'i shqiptohet të miturit për veprën e kryer (neni 26 të LK).

8. Shumica e gjykatave komunale për kundërvajtje, të miturin në procedurën kundërvajtëse për veprën e kryer parimisht e shpallin fajtor, përkundër faktit se shumica e dispozitave ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare janë decidive që i mituri në asnjë mënyrë nuk mund të shpallet fajtor për një vepër të kryer, (përfundimisht aktgjykimi për vepër penale). Edhe gjatë trajnimeve të mbajtura kemi theksuar se dispozita e nenit 254 të LK, është në kundërshtim me nenin 195 të LK, meqë të miturin e vënë në pozitë diskriminuese në raport me të pandehurin madhor, (sepse personi madhor për një vepër të kryer mund të shpallet përgjegjës, kurse i mituri mund të shpallet fajtor).

Kjo dispozitë (254 të LK), është në kolizion edhe me nenin 71, paragrafi 3 LPMK, si dhe me KEDN si dhe të konventave për të drejtat e fëmijëve, konsiderojmë se në këtë mënyrë cenohen dispozitat dhe standardet e të drejtës vendore dhe asaj ndërkombëtare, meqë sipas këtyre standardeve personat deri në moshën 18 vjeç trajtohen si FËMIJË. Bazuar në këto norma dhe standarde personi deri në këtë moshë me aktvendim nuk mund të shpallet FAJTOR dhe as PËRGJEGJËS për çfarëdo vepra të kryer, por në dispozitiv vetëm përshkruhet vepra (përshkruhen veprat) dhe rrethanat në të cilat është kryer ajo-ato, më në fund i shqiptohet masa përkatëse sanksionuese apo edukative, përkatësisht ndonjë nga masat e diversitetit. (Përfundimisht aktgjykimi penal).

Shkelje e të drejtës së ankimit neni 213 LK

9. Një ndër shkeljet procedurale në dëm të të miturit ka ndodhur kur gjyqtari i shqipton gjobën për ndonjë vepër të kryer, duke konstatuar se i mituri ka hequr dorë nga e drejta e ankimit, ashtu që kur i mituri apo prindi-kujdestari i tij parashtron ankesë, gjykata e shkallës së parë këtë ankesë e HEDHË POSHTË, me arsyetim se i mituri ka hequr dorë nga e drejta e ankimit,

konform nenit 213 të LK. Megjithëkëtë, kjo dispozitë dhe ky konstatim nuk mund të zbatohen në procedurën për të miturit, sepse i njëjti si kryes i veprës kundërvajtëse ka status të posaçëm dhe si i tillë gëzon edhe të drejta të veçanta.

10. Ngjashëm me shembullin e dhënë, ndodh kur i mituri arkëton gjobën e shqiptuar para se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të marrë formë të prerë, nëse parashtrohet ankesë, gjykata këtë e trajton si në rastin e paraqitur duke ia hedhur poshtë ankesën, me arsyetim se i mituri me faktin e arkëtimit të dënimit të shqiptuar konsiderohet se me këtë veprim ka hequr dorë nga e drejta e ankimit - në mënyrë identike si për të pandehurin të moshës madhore, gjë që nga kjo praktikë në të ardhmen duhet hequr dorë.

Shkelje e parimit të një kërkesë

11. Shkelje tjetër procedurale ka ndodhur kur ndaj një të mituri dhe për të njëjtën kundërvajtje janë paraqitur dy kërkesa për inicimin e procedurës kundërvajtëse, njëra nga prokuroria publike komunale e tjetra nga stacioni përkatës policor, kurse gjykata e fillon, e zhvillon dhe e përfundon procedurën sipas të dy kërkesave të parashtruara. (Kërkesa e fundit e regjistruar në gjykatë është dashur të hidhej poshtë).

12. Rasti tjetër ka ndodhur kur seanca e shqyrtimit në gjykatën e shkallës së parë ka qenë tërësisht publike.

13. Shkelje procedurale paraqet rasti kur i mituri merret në pyetje në prezencën e disa dëshmitarëve.

Shkelje e të drejtës për mbrojtje efektive

14. Një prej shkeljeve të procedurës ndaj të miturve ka ndodhur kur gjykata ka marrë aktvendim dënues ndaj të miturit në mungesë të deklaramit të tij (neni 200 të LK).

15. Ka pasur raste kur i mituri është shpallur përgjegjës edhe pse ka pasur indikacione se i njëjti vuan nga sëmundja e përhershme ose e përkohshme shpirtërore.

16. Një prej shkeljeve të natyrës së tillë ka ndodhur kur procedura kundërvajtëse ndaj të miturit ka filluar dhe është zhvilluar në mënyrë të përbashkët me të pandehurit madhorë.

17. Ka pasur raste kur i mituri ka kryer dy e më tepër vepra kundërvajtëse, kurse gjykata për secilën vepër i ka shqiptuar dënimin veç e veç dhe më në fund konform nenit 13 të LK, i ka shqiptuar një dënim të përbashkët, edhe përkundër faktit se më parë kemi sqaruar se në dispozitivin e aktvendimit përkatës bëhet përshkrimi faktik i çdo vepre veç e veç dhe përfundimisht ndaj të miturit si kryes i veprave të tilla i shqiptohet vetëm një masë sanksionuese apo edukative.

Analog me këtë, gjykata e shkallës së parë ndaj të miturit nuk mund t'i shqiptojë një dënim me gjobë për njëren vepër të kryer, kurse për veprën tjetër t'i shqiptojë masën edukative, por në këtë rast duhet t'i shqiptohet vetëm dënimi me gjobë.

Kontribute

**Doprinosi
Contributs**

ORGANIZIMI DHE ROLI I SHOQATAVE TË AVOKATËVE NË SHBA (Nga një vizitë studimore)

1. HYRJE

Një grup avokatësh, anëtarë të Dhomës së Avokatëve të Kosovës, në organizim të USAID-it dhe ABA-CEELI, prej datës 14-28 prill 2001, qëndroi në SHBA, për VIZITË STUDIMORE . Qëllimi i përgjithshëm i kësaj vizite ishte (i përcaktuar nga organizatori) marrja e njohurive për organizimin dhe aktivitetet e shoqatave të avokatëve në Amerikë .Grupi i cili vizitoi dy shtete: Minesota (prej 14-22 prill) dhe rajonin e Kolumbisë (22-28 prill) duke qëndruar në kryeqytetet e tyre; Minneapolis dhe Washington DC përbëhej nga 13 avokatë.

Vizita u përqendrua në veprimet e shoqatave ligjore të avokatëve në SHBA, duke u përcaktuar në këto tema kryesore:

- organizimi dhe veprimi i shoqatave të avokatëve në SHBA,
- rekrutimi dhe komunikimi me anëtarët,
- ofrimi i shërbimeve me vlera të veçanta për anëtarët,
- roli i shoqatave në komunitete, dhe
- zhvillimi dhe promovimi i standardeve etike të profesionit,

Përkundër kohës mjaft të kufizuar, grupi ia doli t'i perceptojë njohuritë kryesore lidhur me çështjet të cilat ishin përcaktuar si qëllim i kësaj vizite. Sigurisht që ato ishin mjaft të dobishme në kohën kur në Kosovë, në rrethana të ndryshuara, ishte duke u ndërtuar një gjyqësi e pavarur dhe një avokaturë profesionale, e besueshme dhe etike. Njohuritë e marra, si të parat dhe pioniere që ishin atëherë në lidhje me të gjitha këto çështje, kanë shërbyer si përvoja të mira gjatë konsolidimit të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Përvojat në lidhje me llojet dhe qëllimet e shoqatave të avokatëve; organizimin, veprimin dhe rëndësinë e tyre për sistemin e drejtësisë; komunikimi me anëtarët dhe opinionin publik; organizimi i punëve; programet për anëtarë dhe për komunitetin; angazhimi i vullnetarëve në aktivitetin e shoqatës; krijimi, disponimi dhe menaxhimi fondeve, përpilimi dhe zbatimi i planeve strategjike të zhvillimit, aktiviteve dhe objektivave; programet dhe iniciativat humanitare për personat që nuk kanë mundësi që të përballojnë aksesin në sistemin ligjor; format e ndihmës për kontaktimin e palëve me avokatët; rregullat e etikës dhe sistemi disiplinor së bashku me sistemin e trajtimit të ankesave; rekrutimi i avokatëve vullnetarë; edukimi i vazhdueshëm ligjor; anëtarësia dhe shërbimet, pagesa e anëtarësisë, lartësia e saj dhe kategoritë e veçanta të avokatëve të cilët edhe lirohen nga pagimi i anëtarësisë; shfrytëzimi i teknologjive janë të mirëseardhura dhe mund të shfrytëzohen sidomos tani kur është i nevojshëm reformimi kuptimplotë i Odës së Avokatëve të Kosovës.

2. SISTEMI JURIDIK DHE AVOKATURA NË SHBA

Sistemi juridik në SHBA kryesisht bazohet në sistemin common law anglez, që është zhvilluar dhe interpretuar nga gjyqtarët – praktika gjyqësore për dallim nga një organizim fiksisht i përbërë nga rregullat ligjore të këtilla si sistemi i të drejtës kontinentale (evropiane apo franceze-gjermane). Për këtë ky sistem edhe bart veçori dhe specifika të veta, bazën e të cilave e paraqet precedenti, sipas të cilit gjyqtarët për gjykimin e çështjeve të reja që kanë fakte të

ngjashme, përdorin parimet ligjore të vendosura në çështjet e mëparshme. Nga gjyqtarët e gjykatave më të ulëta kërkohet që të ndjekin vendimet e gjykatave më të larta brenda juridiksionit të tyre.

Kushtetuta e SHBA-së, e miratuar në vitin 1789, e ndryshuar rrallë, është ligji suprem i Amerikës. Ajo themeloi një republikë në të cilën secili shtet ruante sovranitetin dhe autoritetin e caktuar. Secili shtet ka autoritetin e vet ekzekutiv (qeveritar) dhe gjyqësor.

Në kuadër të sistemit të jurisprudencës, shoqatat e avokatëve kanë një rol jashtëzakonisht të madh për funksionimin e sistemit juridik. Profesionit ligjor, në përgjithësi mbështetet në shoqatat e avokatëve, duke krijuar kështu organizata profesionale, të respektuara dhe moralisht përgjegjëse të avokatëve.

Ekzistojnë dy lloje kryesore të shoqatave të avokatëve të cilat hasen në të gjitha shtetet e Amerikës.

a) Shoqatat e detyrueshme - formohen nga shteti dhe anëtarësimi në to është i detyrueshëm për të gjithë avokatët të cilët praktikojnë ligjin. Ato luajnë rol mbrojtës duke vendosur dhe zbatuar standarde profesionale dhe duke parandaluar kështu ofrimin e shërbimeve juridike nga personat e pakualifikuar. Roli i tyre është i madh në forcimin e administrimit të drejtësisë duke ngritur respektimin e ligjit dhe institucioneve ligjore si dhe duke u identifikuar dhe angazhuar për ndryshimet e nevojshme të ligjeve. Detyrimi i anëtarësimit në këto shoqata është për të gjithë juristët në SHBA (gjykatës, prokurorë, avokatë shtetërorë, civilë apo mbrojtës). Kjo është specifika e sistemit amerikan të shoqatave të avokatëve.

b) Shoqatat vullnetare - shpesh formohen në rajone të veçanta gjeografike (p.sh. ShA për qytetin Nju- Jork) apo sipas specializimit (p.sh. për avokatët paditës penalistë, për të drejtën e autorit në pronësi, kontestet familjare, divorcet etj.).

Vërtet nga shoqatat e avokatëve në SHBA përfitojnë të gjithë: anëtarët, profesionit ligjor dhe komiteti. Ato kanë arritur të krijojnë standarde të larta të cilat e bëjnë këtë profesion të respektuar, të besueshëm dhe shumë profesional. Anëtarëve të vet këto shoqata u ofrojnë programe të shumta të shërbimeve me të cilat ato bëhen shumë atraktive për anëtarësimin. Kështu, prej “edukimit të vazhdueshëm ligjor”, i cili në SHBA është i obliguar për secilin avokat (në numër të caktuar orësh brenda vitit) dhe paraqet kusht për vazhdimin e licencës, sistemit të referimit, pastaj te informimet me ndryshimet dhe risitë ligjore, deri te shërbimet që kanë të bëjnë më çështjet jetësore të anëtarëve (si p.sh. sigurimi i automjeteve etj.). Shoqatat kanë programe të veçanta për ndihmë anëtarëve të vet, të cilët kanë rënë në vështirësitë jetësore (janë sëmure vetë, apo ndonjë anëtar i familjes, vështirësitë materiale etj.). Kështu, një shoqatë e avokatëve ofron edhe deri 200 programe të ndryshme brenda një viti për anëtarët e vet.

Shoqatat e avokatëve bashkëpunojnë ngushtë me degët e ndryshme të judikaturës, e veçanërisht me gjykatat dhe prokuroritë. Gjyqtarët, prokurorët, avokatët publikë, juristët të cilët nuk praktikojnë ligjin etj. janë anëtarë të shoqatave të avokatëve, edhe të atyre vullnetare. Me ta organizohen klube të përbashkëta për çështje të caktuara profesionale, organizojnë së bashku mbrëmje shoqëruese, piknikë etj. Vetë avokatura në SHBA nuk definohet kot si “krah i fortë i gjykatave në zbatimin e ligjit”.

Edhe komuniteti përfiton nga shoqatat e avokatëve. Ato kanë një sërë programesh të cilat iu dedikohen komunitetit. Programet e njoftimit të komunitetit me të drejta dhe detyrat ligjore, me organizimin dhe funksionimin e gjykatave dhe sistemit të jurisprudencës; programet e ndihmës

juridike për personat të cilët nuk kanë mjete ta përballojnë shpërblimin e avokatit; sistemi i referimit (rekomandimit), e shumë të tjera si këto, pothuajse janë të rregullta në secilën shoqatë avokatësh.

3. SHOQATA E AVOKATËVE TË KANTONIT HANENEPIN /Hannepin Contry Bar Association /MINNAPOLIS 600 Nicollet Ave, Suite 390/

-Roli i Shoqatës, Aron Barbar, kryetar

HCBA është shoqata më e madhe vullnetare në SHBA. Ka traditë 82-vjeçare dhe numëron 80.000 anëtarë (avokatë, gjyqtarë), të cilët anëtarësohen në baza vullnetare. Është e themeluar me qëllim që t'ju shërbejë anëtarëve, profesionit ligjor dhe komunitetit. Ajo zhvillon programe për lidhje me avokatët e tjerë, për t'ua njohur të tjerëve pjesëmarrjen në programin e edukimit etj.

Kryesia e shoqatës është e zgjedhur dhe funksionon sipas "sistemit të shkallëve": sekretar-nënkryetar-kryetar. Kompetencat e kryetarit të shoqatës janë komunikimi me opinionin publik, (zakonisht përmes konferencave për shtyp), përfaqësimi i shoqatës, kryesimi i mbledhjeve të këshillit drejtues, pjesëmarrja në ceremonitë e pranimit të gjyqtarëve, organizimi punëve (zgjedh personelin më të lartë udhëheqës, i cili zgjedh punëtorët e vet).

Shoqata ofron 200 programe në vit, shumica prej tyre me qëllim edukimi. Ajo zhvillon programe shoqërimi për gjyqtarët dhe avokatët - anëtarë të saj (së paku një herë në vit). Këtë të mërkurë p.sh. shoqata kishte organizuar të mbajë një sesion në të cilin do të nderoheshin anëtarët të cilët më parë kanë kontribuar në shoqatë.

Shoqata zhvillon aktivitete kontakti me komunitetin, si p.sh."Programi në shtëpinë e mallrave", i cili ka tubuar rreth 800 fëmijë dhe ka përfshirë njoftimin e tyre me gjykatat, qeverinë, policinë dhe funksionimin e ligjit.

Qëllimet e HCBA -Lary Baxtman

Qëllimi kryesor dhe udhërrëfyes i shoqatës është që t'ju ndihmojë anëtarëve përmes ofrimit të shërbimeve të ndryshme. E gjithë kjo bëhet me qëllim që anëtarët ta ndiejnë shoqatën për të veten. Staf i profesional luan rol të caktuar për funksionimin e saj. Ky është një staf i sofistikuar, i kualifikuar e profesional, i aftë dhe i gatshëm për t'i dëgjuar zërat e anëtarëve dhe vullnetarëve të shoqatës. Shoqata disponon fonde të caktuara për realizimin e programeve të veta. Fondet menaxhohen nga një ekip dhe strukturë shumë profesionale.

Kjo si dhe me shumë shoqata të tjera në SHBA, i kanë të përpiluara planet strategjike të zhvillimit, aktiviteteve dhe objektivave për të ardhmen (si 3,5 vjeçare etj.).

Qëllimi i parë dhe i fundit i shoqatës është që t'ju shërbejë sa më mirë dhe sa më shumë anëtarëve të vet. Themelimi i saj është bërë në bazë të akteve të cilat në hollësi përcaktojnë organizimin dhe format e aktiviteteve. Aktet e themelimit i paraqiten shtetit. Dekanët e fakulteteve juridike janë anëtarë të Odës shtetërore të avokatëve.

- **Aktivitetet komunikuese me publikun**, Duen Stenli, drejtor i këshillit ekzekutiv dhe këshillit për komunikim.

Asnjë nga shoqatat nuk udhëhiqen vetëm nga stafi. Ky (prezantuesi) vetë nuk është avokat, e as stafi i shoqatës nuk përbëhet vetëm nga avokatët. Shoqata mban komunikim me anëtarët e vet

përmes revistës e cila nxirret nga kontributet e vetë anëtarëve dhe me shkrime paraqiten avokatët e shoqatës, nga sfera shoqërore, politike, vlerat lidhur me drejtësinë, shoqërinë etj. (çdo numër i revistës i dedikohet një sferë të caktuar. Revista quhet “The Hennepin Lawyer”) dhe WEB-sajtit.

Sistemi i komunikimit me publikun bëhet përmes medieve ekzistuese (radios, tv, gazetave). Kur zgjidhet kryetari, këshilli i veçantë për komunikim me opinionin njihet me të dhe me programin e tij. Këto informata dërgohen edhe nëpër fakultetet juridike etj.

Avokatët dhe shoqatat e tyre janë të autorizuar që të vlerësojnë punën e secilit gjyqtar individualisht. Informatat e këtilla seleksionohen dhe shpërndahen në opinion dhe gjykata. Në këtë mënyrë opinioni i njeh gjyqtarët kur ata të marrin pjesë në zgjedhjet (çdo 8 vjet). Formë tjetër e komunikimit me publikun janë edhe “kartat telefonike“, ku janë të shkruara informatat për kontaktet me shërbimet (në këtë mënyrë plasohen informatat për dhunën në familje, pronën, sigurimin, të drejtat e minoriteteve etj.), mesazhe të regjistruara në sistemin telefonik (p.sh. 75 pyetjet më të shpeshta në sistemin ligjor etj.). Broshura për shërbimet juridike, broshura për adoleshentë (pjet, alkoolizmi, ngasjet e makinave, droga etj.) janë forma të tjera të komunikimit me publikun.

Shoqata ka edhe forma dhe programe të tjera për komunikim me opinionin, me të cilat angazhohet për ngritjen e vetëdijes dhe arsimimin e opinionit, për rolin e ligjit në shoqëri, programet për studentët e shkollave të mesme (p.sh. vetëm vitin e kaluar janë zbatuar 100 sish). Pastaj “byro për folësit“ (telefonata për organizuesit e mësimit, arsimtarët etj).

Program dhe njëherësh aktivitet i rëndësishëm në këtë drejtim është edhe “Programi për kontaktim me avokatin“, i cili ka për qëllim edukimin e publikut që pa shqetësim dhe ngurrin ta kontaktojë avokatin.

- Aktivitetet e shoqatës

a) Xhoen Hamilton ,drejtoreshë e aktiviteteve

“Programi i memorialit të shoqatës”, dedikohet dhe organizohet për nder të anëtarëve të cilët nuk janë më në mesin e të gjallëve. Financohet nga donacionet .

- “Programi i iniciativave të brendshme“, u dedikohet shkollave të mesme dhe nxënësve me më pak mundësi materiale (përfshin ndihmën në libra, bursa, ligjërata etj.). Këto janë programe dhe iniciativa humanitare.

- “Programi i shkollave verore”, përfshinë ndihmën studentëve në vitin e parë (bursa, bileta udhëtimi etj.).

- “Konferenca njoftuese për minoritetin”, organizohet në fundjavë dhe u kushtohet studentëve që vijnë nga jashtë, ku ata mund t’ju drejtohen zyrtarëve.

b) Stejsi Write, avokate, drejtoreshë e programeve

- Programi “Roli dhe informacioni“, ndihmon personat (palët) që të kontaktojnë avokatët. Në këtë program tre “persona të telefonatave”, përgjigjen në thirrjet e telefonit në mënyrë që t’ju ndihmojnë palëve të kontaktojnë me avokatët më të cilët dëshirojnë. Personeli cakton takimin (pagesa për këtë është 25 dollarë), kurse avokati e takon palën falas për seancën e parë, në të cilin e informon për çmimin e shërbimeve, çështjen e tij, gjykatën, kohën e përfaqësimit etj. Kjo është mënyra se si klientët ta gjejnë avokatin dhe avokati t’i gjejë klientët. Për këtë kontakt

avokati ndanë një pjesë nga pagesa të cilën ia bën atij klienti pas kryerjes së shërbimit (në rastet me vlerë mbi 25.000 dollarë, kjo pagesë është 10%). Nëse avokati do të jetë pjesë e këtij projekti, atëherë ai ia paguan një shpërblim të rregullt shoqatës.

- “Programi i reklamimit”, përfshinë publikimet e veçanta të reklamimit.
- “Programi i ndihmës për emigrantët”...

- **Rregullat e etikës**, bashkëdrejtuesi i Komitetit të etikës

Në shtetin e Minesotos Gjykata Supreme zhvillon rregullat profesionale të përgjegjësisë, të cilat përcaktojnë se si avokatët merren me gjyqtaret dhe si i trajtojnë klientët e vet. Rregullat e vendosura nga Gjykata Supreme e Minesotos trajtojnë edhe raportet midis vetë avokatëve .

Efekti i këtyre rregullave varet në pjesë të madhe nga zbatimi vullnetar i tyre. Gjykata Supreme cakton bordin e avokatëve, i cili përbëhet nga 13 avokatë dhe 9 joavokatë, i cili vështron zbatimin e këtyre rregullave. Është shumë e rëndësishme struktura e këtij bordi dhe pjesëmarrja në të e personave të cilët nuk janë avokatë.

Përveç këtij bordi, janë edhe 23 komitete të rretheve, që u përgjigjen sistemit të odave komunale. Kryetari i secilit komitet të rrethit caktohet nga Gjykata Supreme dhe shoqata e avokatëve nuk ka ndikim në të. Ankesa ndaj avokatit i drejtohet bordit të avokatëve. Ajo mund të përqendrohet në papërgjegjësinë në përfaqësim, përfaqësimin joprofesional, mospërgjigje ndaj kërkesave të klientit etj. Procedurat janë të mbyllura, sidomos në fazat fillestare, sepse kanë për qëllim që të mos dëmtohet reputacioni i avokatit, derisa të mos jetë e provuar përgjegjësia e tij dhe shkelja e rregullave të etikës.

a) Xheri Peterson, kryetare e Këshillit për mjetin vullnetar (stejdment)

Shoqata është kujdesur dhe nuk ka lënë anash personat të cilët nuk kanë mundësi që të përballojnë aksesimin në sistemin ligjor. Kjo është kategoria e personave të varfër. Shoqata për realizimin e këtyre programeve rekruton avokatë vullnetarë nëpër odat shtetërore të avokatëve. Në këto raste avokati i mbulon të gjitha fazat e procedurës para ligjit. Shërbimet e këtilla palët mund t’i shfrytëzojnë nga çdo sferë: e drejta familjare (shkurorëzimet), penale, etj. Nevojat janë të mëdha, kështu që numri i avokatëve të gatshëm për përfaqësimin falas nuk mund t’i përballojë të gjitha kërkesat të cilat i drejtohen shoqatës, prandaj edhe domosdoshmërisht bëhet klasifikimi i kërkesave. Kështu për vitin 2000 janë ndihmuar rreth 4000 raste (kryesisht nga divorcet, pastaj nga borxhlinjtë, largimi nga banesat, kontestet rreth marrëdhënieve të banimit - nuk punon rrjeti i ujësjellësit, WC etj.).

Për realizimin e këtyre programeve shoqata merr donacion edhe nga qeveria. Në Minneapolis ekzistojnë 12 firma të mëdha avokatësh që bëjnë punë për të varfrit.

b) Stejsi Write, avokate

Shoqatat e avokatëve për klientët japin ndihmë juridike pa pagesë në shumë raste.

-Shërbimet ”pro-bono”, për personat të cilët kanë nevojë për mbështetje juridike, por që nuk kanë mjete financiare për ta përballuar vetë këtë. Ky program aplikohet sidomos në fazën e parë, kur pala vetë bën përfaqësimin “pro-self”, por has në vështirësi për shkak të mosnjohjes së ligjit, kështu që i nevojitet ndihma udhëzuese e avokatit. Në këtë mënyrë dhënia e shërbimit udhëzues, pa përfaqësim të plotë, quhet shërbim “pro-bono”. Ai dallohet nga prezentimi i çështjes para gjykatës nga vetë pala, e që quhet “pro-self”.

Shoqata ka krijuar rrjetin vullnetar të avokatëve të cilët çdo ditë nga dy orë u japin përgjigje njerëzve të këtillë. Shteti nga ana e vet ka krijuar edhe:

- “Qendrën e ndihmës juridike”, e cila është formuar dhe financohet nga vetë qeveria federale që t’ju ofrojë ndihmë njerëzve të cilët përfaqësojnë veten “pro-self para gjykatave.
- “Qendra e ndihmës së parë”, merret me ndihmën juridike në raste penale,
- “Qendra e ndihmës për azilantë”, merret me dhënien e ndihmës juridike për azilantët,
Vlerësohet se vitin e kaluar rreth 20.000 veta janë paraqitur para gjykatave pa avokatin i cili do t’i përfaqësonte ata. Kjo konsiderohet si dështim dhe veprim jo i mjaftueshëm i shoqatave të avokatëve.

4. SHOQATA SHTETËRORE E AVOKATËVE TË MINESOTO /Minnesota State Bar Association/ 600 Nicollet Mall, Suite 380

- **Prezentimi i shoqatës**, Tim Groshens, drejtor ekzekutiv

Para 120 vjetëve në Minesotë kishte avokatë dhe njerëz me aspirata të jenë avokatë. Tridhjetë vjet më vonë Minnesota kishte rreth 5.500 avokatë. MSBA është themeluar në vitin 1883 nga 200 avokatë, anëtarë të parë të saj. Tani kjo shoqatë shtetërore numëron 14.820 avokatë (në gjithë shtetin Minesotës janë 22.388 avokatë të licencuar, d.m.th. 66.1% e të gjithë avokatëve të Minesotës janë anëtarë të MSBA) dhe 15.000 anëtarë të tjerë vullnetarë. Fondi i përgjithshëm i MSBA është mbi 4 miliardë dollarë. Shoqata ka një personel udhëheqës prej 30 anëtarësh. Gjykata Supreme e Minesotës kontrollon pranimin dhe disiplinën e anëtarëve të shoqatës.

- **Etikat**, Edward Cleary, drejtor i sistemit të përgjegjësisë ligjore (emëruar nga Gjykata Supr. Min.)

Në SHBA ekzistojnë dy lloje të shoqatave të avokatëve: shtetërorë dhe vullnetarë. Që të dyja këto shoqata u kushtojnë kujdes të veçantë rregullave të etikës profesionale.

Në vitin 1883 u krijuan rregullat e reja të sjelljes profesionale, kurse Minnesota i nxori ato në vitin 1893. Në këto rregulla kanë qasje sot rreth 1 milionë avokatë në Minesotë. Këto rregull janë duke u rishqyrtuar, kështu që në dy vjetët ardhshëm parashihen ndryshime të tyre. Rregullat mund të ndahen në 9 fusha, por më kryesoret janë: a) marrëdhëniet me klientët dhe avokatët (të cilat përfshijnë në gjirin e vet shumë rregulla mbi kompetencat, konfliktin interesave, komunikimin e avokatit me klientin etj.) b) Reklamimi (lejohet reklamimi me mjetet e komunikimit e nuk lejohet reklamimi i drejtpërdrejtë si p.sh. me telefon ose vetëreklamimi, p.sh. në rast të aksidentit avokati të shkojë vetë në vendin e ngjarjes dhe t’ju ofrojë palëve shërbimet e veta).

Sistemi i trajtimit të ankesave përfshin një procedurë të përcaktuar qartë. Ankesa i paraqitet me shkrim komisionit për ankesa (përbëhet nga 10 avokatë dhe 15 paraligjorë joavokatë). Prej ankesave të paraqitura brenda një viti (mund të jenë deri në 1.400), 40% e tyre largohen në fazën fillestare të shqyrtimit, sepse është konstatuar se nuk ka pasur shkelje të rregullave. Ankesat që kanë të bëjnë me pagesën e avokatit nuk shqyrtohen në këtë fazë. (Marrëveshja lidhur me pagesën duhet të bëhet me shkrim).

Në shtetin e Minesotes ekzistojnë 21 rrethe gjyqësore dhe po aq komitete të etikës, të cilat përbëhen nga avokatë dhe joavokatë – vullnetarë (të cilët nuk paguhen për këtë punë) .Secili komitet ka përafërsisht rreth 5 avokatë, kurse të gjitha komitetet kanë rreth 300 vullnetarë.

Vendimin përfundimtar për përgjegjësinë e avokatit e merr gjykata. Paraprakisht për këtë vendos bordi i përbërë nga 14 avokatë dhe 9 vullnetarë, nga të cilët zgjidhet kolegji i bordit i përbërë prej 2 avokatëve dhe 1 vullnetari.

Ekzistojnë dy nivele të përgjegjësisë disiplinore: 1) private dhe 2) publike. Përgjegjësia private disiplinore, sipas vetë përkufizimit, tregon se paraqet shkeljet e lehta të rregullave të sjelljes.

Vërejtja për këtë shkelje hyn në shënimet e avokatit në evidencën e shoqatës së avokatëve. Këto shënime ruhen për tre vjet, për të verifikuar nëse ankesat janë duke u përsëritur. Standardi më i ulët është qortimi. Këto procedura për shkelje të lehta të rregullave të sjelljes janë konfidenciale. Disiplina publike dallon nga lloji i parë për shkak të shkeljes së rregullave dhe organit i cili e udhëheqë procedurën dhe shqipton masën. Procedura për shkeljet e rënda të rregullave të etikës zhvillohet nga Gjykata Supreme. Dënimet për këto shkelje janë:

- publikimi i shkeljes,
- suspendimi i përkohshëm për 30 ditë - 3 vjet, dhe
- suspendimi i përhershëm i licencës.

Avokatët lidhur me përfaqësimin e klientëve të vet lidhin dy kontrata:

- 1) marrëveshjen mbi përfaqësimin, dhe
- 2) marrëveshjen mbi pagesën.

Avokatët kanë dy lloje të xhirollogarive:

- 1) të biznesit (për taksa, qira, tatime), dhe
- 2) të trustit (për paradhënien e pagesës së shërbimeve).

- Edukimi i vazhdueshëm ligjor, Frank Harris –udhëheqës i programit

Gjatë kësaj ore u bë prezentimi praktik i zbatimit të këtij programi. Ai mund të organizohet si "program njëorësh", "një pasdite" dhe "disaditor" (p.sh. 2-4). Organizohet për lëmenj të ndryshëm: etika, përgatitja dhe paraqitja e mbrojtjes etj.

- Struktura e shoqatës dhe shërbimet për anëtarët

a) Komitetet e shoqatës-Kent Denender, udhëheqës i punës së komiteteve (pozitë vullnetare) Shoqata ka 33 komitete të ndryshme me 500 anëtarë. Anëtarët e komiteteve zgjidhen nga kryetari i shoqatës. Komitetet ndahen në 3 fusha:

- 1) nga fusha e financave,
- 2) komitetet ad hoc (formohen për çështjet e caktuara që lindin brenda ditës), dhe
- 3) nga fusha e disiplinës.

Komitetet numërojnë prej 5-25 anëtarë. Mjetet për financimin e tyre vijnë nga fondi i përgjithshëm i shoqatës. Secili komitet ka stafin - sekretariatit e vet, i cili programon agjendën. Komitetet kanë autoritet të nxjerrin konkluzione për çështjet e caktuara. Konkluzionet e komiteteve nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me programin e shoqatës. Komitetet raportojnë para anëtarësisë një herë në vit.

b) Seksionet e shoqatës – Betsi Pirs

Seksionet themelohen për sfera të ndryshme. Seksionet i kanë fondet e veta të veçanta, prandaj edhe janë me anëtarësi më të mëdha sesa komitetet. Shumica e tyre i kanë statutet e veta. Seksionet e tyre i kanë statutet e veta. Seksionet mund t'i krijojnë se paku 50 veta, avokatë, anëtarë të MSBA. Ata nxjerrin statutin dhe përcaktojnë taksën për anëtarësim. Pas kësaj ata i bëjnë kërkesë bordit të shoqatës për t'u pranuar si seksion.

Seksioni më i madh në MSBA është ai për patundshmëri. Seksionet udhëhiqen nga kryetari, nënkryetari dhe sekretari me tre anëtarë të fondit (quhet "këshill"). Ky grup mblidhet zakonisht një herë në muaj. Disa nga seksionet nxjerrin publikimet e veta. MSBA ka 31 seksione, të gjitha mbi baza vullnetare.

c) Anëtarësia dhe shërbimet

Siç u theksua me rastin e prezentimit, MSBA përfshinë 66.1% të të gjithë avokatëve të licencuar në shtetin e Minesotës.

Anëtarët e saj, varësisht nga lartësia e pagesës, për anëtarësinë ndahen në 3 kategori;

- Anëtarët e rinj juniorë, pranohen pa paguar kontribute,
- Anëtarët e rinj (me 2-3 vjet anëtarësi) paguajnë 95,00 dollarë,
- Anëtarët intermediatorë (me mbi 6 vjet anëtarësi) paguajnë anëtarësinë e plotë,
- Anëtarët e vjetër nuk paguajnë fare anëtarësi.

Kategoritë e veçanta të avokatëve, të cilët edhe lirohen nga pagimi i anëtarësisë janë:

- I paafiti (disabled),
- I vjetri (emeritus), dhe
- Anëtarët që realizojnë nën censusin prej 25.000 \$ në vit.

Fatura për pagesën e anëtarësisë, anëtarëve u dërgohet njëkohësisht më 1 qershor. Avokatët janë të detyruar që pagesën e anëtarësisë ta bëjnë më së voni deri më 01.07 të vitit. Në këtë periudhë sipas praktikës së deritashme mbliidhen rreth 50% të fondit të përgjithshëm prej 4 milionë dollarë. Pagesa e anëtarësisë vazhdon deri në nëntor kur mbyllet përfundimisht.

Struktura e anëtarësisë është: 31% praktikantë, 31 % avokat publikë, 16 % firma avokatësh etj.

Përveç shërbimeve të përmendura, deri më tani MSBA për anëtarët e vet, komunitetin dhe profesionin ligjor ofron mjaft shërbime dhe mundësi. Kjo realizohet në saje të fondit të vet, më tepër fonde më tepër mundësi.

Projekti i shërbimeve përfshinë përcaktimin e strategjisë: a) Strategjia afatgjate, përfshinë përpjekjet për ndryshimin e dukshëm, si p.sh. cilët janë anëtarët, nevojat e tyre, shërbimet dhe programet. Të gjitha këto aplikohen si proces i vazhdueshëm i krijimit të vlerave dhe mesazheve afatgjate. b) Strategjia afatshkurtër, përfshinë programet për rekrutimin e anëtarëve të rinj. Kjo bëhet mes të tjerash edhe me dërgimin e faturave të anëtarësimi në strukturën e programeve dhe shërbimeve.

MSBA ofron një laramani të madhe të programeve dhe shërbimeve kualitative për anëtarët e vet:

- Programi i edukimit të vazhdueshëm ligjor (Continual Legal Education),
- Programi i ndërmjetësimi në gjetjen e avokatit (Attorney Referral Program),
- Programi i edukimit ligjor të publikut (Public Education Program),
- Programi i gjyqeve të improvizuara (Case study),
- Publikimi i risive ligjore (Legal News Digest). Më se 8.000 anëtarë në vit i kanë marrë publikimet e risive ligjore të vendosura në një program kompjuterik.
- Programi "Practis Law Org." që përbëhet nga tetë dosje nga sfera të ndryshme praktike (praktika e apelit, e drejta e punës, e drejta e marketingut, e drejta penale, familjare, trashëgimore).

Shfrytëzimi i teknologjive - drejtori ekzekutiv për teknologji

Që shoqata të jetë në shërbim sa më të mirë të anëtarëve të vet, ajo duhet të ketë mundësi sa më të gjera për komunikim me ta. Për këtë qëllim MSBA shfrytëzon mundësitë teknologjike:

- "E-mail" praqet mjetin më të mirë të komunikimit të shoqatës me anëtarët e vet (90% të anëtarëve kanë mundësi për komunikim të këtillë.
- "Telefonat celularë", ofrojnë mundësi të tjera komunikimi, dhe ato shfrytëzohen nga shoqata dhe anëtarët,

- Dërgimi i aktgjykimeve anëtarëve (ka një rëndësi shumë të madhe duke qenë se sistemi juridik amerikan i takon “sistemit Common law” në të cilin praktika gjyqësore luan rol të rëndësishëm në krijimin e rregullativës).

5. QENDRA QEVERTARE NË KANTONIN E UASHINGTONIT STILLWATER, 62-nd Stret, North

Grupi përcjell procedurat gjyqësore në gjykatën për kundërvajtje. Gjyqtari Gary Schurrer bën përcjelljen e grupit nëpër gjykatën për kundërvajtje. Grupi takohet me avokatët, anëtarë të shoqatës së avokatëve në Stillwater.

- Takimi i paraprindë prezentimi i dyanshëm.
- Shoqata ka organizuar drekë për mysafirët.

5. GJYKATA SUPREME NË MINESOTË, MINEAPOLIS, 25 Constitucion Avenue St. Paul, MN

A) -Sistemi i gjyqësisë në SHBA -Russell Anderson, gjyqtar

Gjyqtari Anderson ka diplomuar në fakultetin juridik në vitin 1968. Pas praktikës private, ka qenë avokat i komunës (publik), kurse në vitin 1987 është zgjedhur gjyqtar në Gjykatën e qarkut (përfshinte territorin e 17 komunave). Në vitin 1988 ai është zgjedhur gjyqtar në Gjykatën Supreme të Minesotës.

Kandidatët për gjyqtarë i propozon Shoqata e avokatëve, kurse emërimin e bën guvernatori i shtetit. Në sistemin gjyqësor federal emërimi është i përjetshëm, kurse gjyqtarët i emëron kryetari i shtetit, ndërsa i verifikon Senati. Gjykata Supreme e Minesotës përbëhet nga 16 gjyqtarë. Ajo pranon apelet (ankesat) për çështjet e rëndësishme nga kushtetuta ose interpretimi i ligjit, pastaj vrasjet e shkallës së parë, kur i akuzuari është i dënuar me vdekje.

b) -Bashkëpunimi i gjykatave me shoqatat e avokatëve - Paul Anderson, gjyqtar

Në çdo shtet ekziston së paku një shoqatë e avokatëve. Nga avokatët nuk kërkohet që të bashkohen me shoqatën, por shumica prej tyre e bëjnë këtë për shkak të shërbimeve dhe beneficioneve që i shfrytëzojnë nga kjo anëtarësi.

Në të gjitha shoqatat ekzistojnë grupet punuese, të cilat quhen komitete, të formuara për lëmenj të caktuar (penale, civile, divorcet, tatimet, dëmshpërblimet, sigurimet etj.), të cilët në radhët e veta kanë edhe gjyqtarë dhe avokatë dhe shqyrtojnë çështjet e ndryshme nga fushëveprimi i tyre. Përveç kësaj, Gjykata Supreme trajton rastet e shkeljes se etikës profesionale nga ana e avokatëve, kështu që edhe në këtë mënyrë është e implikuar në punën e avokatëve. Në këto raste gjyqtari individual e përshkruan rastin, kurse gjykata vendos për ekzistimin e shkeljes dhe përgjegjësinë e avokatit në kolegji (përbëhet nga 16 gjyqtarë të cilët ndahen në 3 kolegje me nga 7 gjyqtarë). Seanca e shqyrtimit është e paraparë të zgjasë gjithsej 60 minuta. (30 minuta për paraqitësin e apelit dhe 30 të tjerë për kundërshtarin), kurse pjesa tjetër përfshinë shqyrtimin e shkresave. Gjyqtari referues paraqet një memorandum me shkrim, në të cilin parashtron rekomandimet dhe argumentet e veta. Pjesa tjetër e procedurës zhvillohet sipas mënyrës së paraparë, deri në marrjen e vendimit meritor për çështjen.

Gjykata Supreme është ”fillimi dhe fundi “ në zbatimin e kodit të etikës, sepse ajo vendos prej nxjerrjes së rregullave e deri në marrjen e vendimit mbi shkeljen e tyre. Në sistemin amerikan ka edhe avokatë vullnetarë të cilët merren me zbatimin e rregullave të etikës profesionale. Kodi

në fillim është miratuar me një pëlqim të përgjithshëm. Më vonë rregullat e etikës janë aprovuar nga Gjykata Supreme, prandaj ai sot është zyrtar.

Bordi i përgjegjësive profesionale në shoqatat e avokatëve, lëshon rregullat e sjelljes, të cilat janë rekomandime dhe vlejné vetëm për avokatët e shoqatës. Kështu, shumica e rasteve të shkeljes së tyre mbasin në nivelin e shoqatave të avokatëve, kurse vetëm shkeljet e rënda vijnë në gjykatë.

Gjykata organizon provimin e judikaturës përmes komitetit (quhet “Komiteti për ekzaminimin dhe licencimin e avokatëve”). Provim mbahet dy herë në vit dhe zgjat dy ditë.

C) - Organizimi i Gjykatës Supreme - Kay Pedretti, drejtor i shërbimeve të gjykatës
Puna dhe organizimi i brendshëm në gjykatë bëhet përmes strukturës së komiteteve, të cilat i formon ajo vetë. Komitetet përbëhen nga 20-30 anëtarë, avokatë që praktikojné ligjin (të licencuar) dhe gjyqtarë me njohuri të mjaftueshme. Ndonjëherë mund të ketë anëtarë edhe nga nëpunësit e administratës gjyqësore. Këto komitete mund të jenë dy llojesh: komitetet për veprimet e ditës dhe komitetet e përhershme, si p.sh. për rregullat civile, penale, rregullat e përgjithshme, për të miturit etj. Vendimet e komiteteve botohen në buletin vjetor, të cilin e publikon gjykata. Komitetet, me rezoluta përcaktojnë fondet nga të cilat financohen.

7. SHOQATA SHTETËRORE E AVOKATËVE TË MINESOTËS

MINNEAPOLIS, 600 Nicollet Mall, Suite 380

ETIKAT - Grupi punues

a) Richard Wexler-av. vullnetar në Komitetin e etikës MSBA (punon në Departamentin e Shëndetësisë MN)

Komiteti i etikës MSBA është formuar në vitin 1985, kur shoqata ka nxjerrë rregulla standarde të sjelljes së avokatëve. Vështirësitë e zbatimit të standardeve në situatat faktike ka nxitur formimin e këtij komiteti. Zyra e prokurorit të përgjithshëm është zyra ligjore për shtetin e Minesotës, përgjegjës për disa lëmenj, një prej të cilëve është edhe pëlqimi i agjencive të ndryshme shtetërore (p.sh. për shëndetësi, ligj, etj.) pastaj për zbatimin e ligjeve të nxjerra nga ligjvënësi që kanë të bëjnë me të drejtat e individit lidhur me trustin apo kompanitë. Avokatët e komunës kanë autorizimet bazike për ndjekje.

Përveç vendosjes së komenteve të zyrës, komiteti është marrë edhe me problemet të cilat vetë avokatët i kanë ngritur. Lidhur me këtë janë hartuar projekte për përgatitjen e avokatëve në klasa.

b) David Schultz – av. Halleland Lewis Nilan Sipkins & Johnson

Z.Schultz është partner në një firmë ligjore, e cila numëron 40 avokatë, kurse në MSBA është vullnetar. Si zyrtar i etikës ka rol të këshillojë avokatët e firmës së vet lidhur me rregullat e etikës, në mënyrë që të mos bëjnë shkeljen e këtyre rregullave. Si çështje e cila më së shpeshti paraqitet në firmën e vet ai e veçon situatën e “konfliktit të interesave”.

c) Patrick Burns – Bordi përgjegjës i avokatëve profesionistë në MSBA

Aspekt i rëndësishëm i zbatimit të rregullave të etikës dhe sistemit disiplinor është ai që vetë avokatët të pajtohen se çka nënkuptojné ata me rregullat e etikës. Pra, me rëndësi është që vetë avokatët të vetëdijësohen për atë se çka janë këto rregulla, sa janë të dobishme dhe çka do të thotë mosrespektimi i tyre.

Deri te të gjitha këto arrihet me punë dhe duke përdorur sisteme të ndryshme: a) Njëra mënyrë është përmes të ashtuquajturit "sistem i vështirësive" dhe b) "sistemi i edukimit lidhur me zbatimin e rregullave të etikës". Sistemi i fundit përfshinë organizimin e seminareve, publikimin e artikujve dhe opinioneve këshilluese, (në rastet kur një avokat bie në kundërshtim me këto rregulla e thërret këtë zyrë dhe në mënyre konfidenciale këshillohet me kuptimin e rregullave të etikës në rastin e tij).

Në çështjen lidhur me heqjen e licencës për shkelje të këtyre rregullave, e cila u shtruar nga pjesëmarrësit, ligjëruesi shton shtetet, aplikon praktika të ndryshme, kështu në disa shtete heqja një herë e licencës do të thotë edhe përfundim i ushtrimit të veprimtarisë së avokatit, sepse personi i këtyre nuk mund të kërkojë rikthimin e saj. Për dallim nga kjo, në disa shtete të tjera heqja bëhet për 5 vjet dhe avokati ka të drejtë që të aplikojë për rikthim.

d) Kathy Messerich-Halleland Lewis Nilan Sipkins & Johnson

Zonja Messerich është partnere në firmën ligjore, kurse këtu si vullnetare është nënkryetare e Komitetit të etikës 3 muajt e fundit.

Komiteti i etikës përbëhet nga 130 anëtarë vullnetarë dhe ka kompetencë hetimin e ankesave në sjelljet dhe punën e avokatëve. Ankesa ndaj avokatit paraqitet në formën e aplikacionit, e cila shqyrtohet nga komiteti dhe pastaj brenda afatit prej 10 ditësh merret përgjigjja në thëniet e ankesës prej avokatit. Për t'u hulumtuar faktet kontaktohet ankuesi, me ç'rast vërtetohet se si ka rënë në kontakt me avokatin, pastaj me natyrën e çështjes dhe vërejtjet e tij në sjelljet e avokatit. Nëse shoqata vendos se një ankesë kundër avokatit është e bazuar, atëherë komiteti angazhon vullnetarët që për 90 ditë e ardhshme të bëjnë hetimet. Shkohet në zyrën e avokatit për t'u vërtetuar faktet. Lënda dërgohet në skenim dhe e gjithë kjo vendoset në dosje. Nëse komiteti vendos që hetimi duhet të kryhet, ai thërret palët, ankuesin dhe avokatin, për t'u paraqitur para komitetit. Pasi të vendoset lëshohet vendimi i arsyetuar.

9. SHOQATA E AVOKATËVE AMERIKANË (ABA)

WASHINGTON DC740 15-th Street,NW

c) Marrëdhëniet e shoqatës me qeverinë, Kevin Driscoll, zyrtar në zyrën për bashkëpunim me qeverinë.

ABA, si shoqatë vullnetare e cila vepron në nivel federal, zhvillon aktivitetin e vet për të ndikuar në legjislacionin federal. Nga 100 ligje, të cilat nxirren gjatë një mandati të legjislacionit, ABA ndjek rreth 10 çështje në vit të cilave, në krahasim me sferat e tjera, u kushton rëndësi më të madhe.

Në Dhomën e Delegatëve ABA i merr vendimet politike për çështjet e caktuara (quhen "pikëpamje"), pasi që komitetet dhe seksionet shumë çështje nga fushëveprimtaria e tyre i kanë kaluar kësaj dhome. ABA nuk u ndanë fonde kongresistëve gjatë fushatave të tyre zgjedhore, por thjesht ua paraqet pikëpamjet e veta lidhur me çështjet e caktuara nga legjislacioni. Shpesh edhe vetë ata kërkojnë pikëpamjet e ABA-s për çështjet e caktuara nga ky lëmë.

Aktualisht inkurajohet Kongresi i SHBA-së për rritjen e pagave gjyqtarëve federalë, pastaj për shtimin e fondeve për ndihmë atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme për të përballuar përfaqësimin nga avokati, thjeshtimin e legjislacionit të taksave, çështjet e emigracionit (që këto ligje të jenë më të favorshme për emigrantët, në mënyrë që p.sh. t'ju mundësojnë atyre të

marrin avokatë për përfaqësim në marrjen e qëndrimit në SHBA, etj.), pastaj përpjekjet që çështjet e vogla të zgjidhen jashtë gjykatës, etj.

Ndikimi i shoqatës në anëtarët e Kongresit bëhet në mënyra të ndryshme, kurse mënyra më e shpeshtë është caktimi i takimeve me kongresistë apo me ndihmësit e tyre. Pastaj, kur çështja e caktuar vjen në Kongres, shoqata i drejton letra Kongresit, në të cilat shpreh pikëpamjet e veta për çështje të caktuara të cilat shqyrtohen nga ai. Letra të këtilla i drejtohen edhe kryetarit të shtetit, sekretarit dhe funksionarëve të tjerë shtetërorë.

Avokatët më të shquar amerikanë një herë në vit vijnë në Uashington për t'u takuar me ligjvënësit.

d) Zyra për legjislacionet shtetërore (veprimtaria lobiste) -Ken Goldsmith,drejtor

Shpesh interesat e shoqatave shtetërore janë të njëjta me ABA, edhe pse të gjitha shoqatat në SHBA veprojnë të pavarura. Kjo zyrë organizon seminare në të cilat ftohen lobistët nga shoqatat shtetërore të avokatëve, për të shprehur pikëpamjet e veta për çështje të caktuara nga legjislacioni federal. ABA për këto qëllime bashkëpunon vetëm me shoqatat shtetërore të avokatëve, megjithëse shumë prej shoqatave të tjera vullnetare kanë komitetet lobiste për të propaganduar politikat (pikëpamjet) e veta, përmes takimeve, publikimeve, etj.

Kjo zyrë përbëhet nga 10 anëtarë të kualifikuar për lobizëm, asistentë administrativë, personi për hulumtime ligjore, personi për kontakte me shoqatat e tjera. Financimi i zyrës bëhet nga fondi i përgjithshëm i shoqatës.

Përveç kësaj, ABA ka edhe seksionin i cili merret me çështjet e legjislacionit ndërkombëtar. Ky seksion harton politikat mbi çështjet e caktuara të legjislacionit ndërkombëtar, si p.sh. ndikimi në Kongres për pagesën e detyrimeve financiare të SHBA-së ndaj OKB-së; mbi adaptimet e fëmijëve; krijimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut etj.

Duke qenë se legjislacionet e shteteve të federatës amerikane nuk janë të ngjashme as midis vetes e as me legjislacionin federal, zyra bën presion në arritjen e standardeve unike në çështjet e caktuara. Shembull të veçantë në këtë aspekt paraqet çështja e dënimit me vdekje, i cili parashihet në disa legjislacione penale të shteteve. Disa shtete, duke iu përgjigjur presionit të publikut, kanë evokuar ekzekutimin e tij, por nuk e kanë hequr nga legjislacioni i vet. Disa kanë zbutur mënyrën e ekzekutimit dhe nga karrigia elektrike kanë kaluar në ekzekutimin me injeksion helmues, si mënyrë më humane e ekzekutimit. Nga viti 1997 ABA ka filluar propagandimin e zvogëlimit të rasteve të ekzekutimit të dënimit me vdekje. Vetëm një shtet ka vendosur moratorium në ekzekutimin e dënimit me vdekje - duke e ndaluar përkohësisht ekzekutimin e tij; 32 shtete janë duke e studiuar çështjen e vendosjes së moratoriumit (sidomos nëse në rastet e tilla ekziston diskriminimi racor). Po kështu edhe çështja e abortit është sferë në të cilën ABA bën lobizëm të pikëpamjeve të veta.

Përgjithësisht fusha e lobizmit është e kufizuar me politikën e përgjithshme të cilën e ndjek ABA. Zyra është e kufizuar edhe me rregullat e përgjithshme të etikës profesionale të cilave duhet t'ju përmbahen të gjithë avokatët, e me këtë edhe avokatët - anëtarë të zyrës.

10. SHOQATA E AVOKATËVE TË DISTRIKTIT TË KOLUMBISË

1250 H Street NW B-1 Level

a) **Struktura e shoqatës** – Liz Kolby, ass. e drejtorit ekzekutiv

Në DK janë 32-33 shoqata vullnetare të avokatëve, të organizuara në bazë të fushave të interesimit (p.sh. lëmin penal, ankesat etj.) apo për lëmenj të caktuar kulturorë. Shoqata e Avokatëve të Qarkut Kolumbia, ka për qëllim që të inkurajojë formimin e sa më shumë shoqatave të vogla, për arsye se shoqatat e avokatëve në Amerikë janë krah i forte i gjykatave në zbatimin e ligjit.

Shoqata e Distriktit Kolumbia është themeluar në vitin 1972 si odë e detyrueshme me rreth 51.000 anëtarë (20.000 janë aktivë dhe 6000 të tjerë gjyqtarë). Shoqatën e qeveris bordi i cili numëron 15 anëtarë dhe kryetarin. Bordi mban përgjegjësinë fundamentale. Ai përcakton politikën që duhet ndjekur, aprovon vendimet e komiteteve etj. Kryetari i shoqatës zgjidhet për çdo vit dhe sjell programin për çështjet të cilat konsideron se duhet zgjidhur gjatë mandatit të tij. Ai drejton mbledhjet e bordit. Shoqata e ka drejtorin ekzekutiv i cili merret me punët ditore. Çdo anëtar aktiv i shoqatës paguan nga 120 dollarë në vit, kurse anëtarët joaktivë paguajnë nga 80 dollarë. Gjyqtarët, anëtarë të shoqatës, paguajnë nga 60 dollarë në vit në emër të anëtarësisë.

Shoqata shfrytëzon kontributet financiare vetëm për të aftësuar dhe pranuar avokatë të rinj, për të forcuar sistemin disiplinor, financuar klientët që kanë qenë viktime të mashtrimeve të avokatit si dhe për funksionet administrative. Në këto shërbime janë përfitimet e anëtarit të shoqatës. Shërbimet të cilat shoqata u ofron anëtarëve janë të shumta, si p.sh.:

- shërbimi i sigurimit të automjeteve,
- shërbimet telefonike, digjitale,
- shërbimet e sigurimit të jetës, shëndetit dhe të sigurimit nga aksidentet,
- shërbimet e bibliotekarisë,
- shërbimet profesionale,
- si dhe dhjetëra shërbime të tjera.

Shoqata disponon fonde të caktuara, të cilat formohet nga dy burime: a) kontributet e anëtarëve dhe b) burimet e tjera (shërbimi pro-bono, donacionet vullnetare, programet komerciale, etj.).

Komitetet dhe seksionet janë forma të veprimit dhe të aktivitetit të shoqatës. Ekzistojnë:

1) Komitetet e veçanta - ose të përkohshme, janë prej 10-15 dhe formohen çdo dy vjet. I këtuillë është p.sh. komiteti special për praktikat multidisiplinare.

2) Komitetet e përhershme - janë 10 dhe mbulojnë funksionet administrative, si:

- “komiteti i përgjegjësisë disiplinore”, shqyrton ankesat ndaj veprimeve të avokatëve lidhur me shkeljen e rregullave të etikës së Distriktit të Kolumbisë. Kundër vendimeve të tij mund të aplikohet në Gjykatën e Apelit të DC.

- “komiteti për vlerësimin juridik”, vlerëson punën e gjyqtarëve (ai përbehet nga gjyqtarët e lartë të DK dhe është komitet vullnetarësh. Vlerësimet e tij bazohen në sistemin numerik - me nota, të punës së

gjyqtarëve; por mund të paraqesin edhe komentet për punën e gjyqtarëve. Qëllimi është që gjyqtarët individualisht të përmirësojnë lëshimet e caktuara).

- “komiteti për edukimin e vazhdueshëm ligjor”, përbëhet nga vullnetarë të fushave të ndryshme të ligjit (avokatë, avokatë të firmave ligjore, gjyqtarë, prokurorë etj.). Rreth 20 kurse

të ndryshme organizohen vetëm nga lëmi i etikës. Certifikatat e kurseve pranohen në 25 shtete të tjera të Amerikës. Prej vitit 1990 në DK edukimi i vazhdueshëm ligjor është bërë i detyrueshëm. Materialet të cilat përdoren në këto kurse botohen dhe si të tilla shiten (me çka forcohen edhe fondet e shoqatës). Veçohet “kursi për avokatët e rinj”, të cilit duhet t’i nënshtrohen të gjithë avokatët që fillojnë të merren me avokaturë si dhe ata të cilët për 5 vjet kanë pushuar nga puna praktike. Ky është kurs njëditor dhe ka të bëjë me rregullat e etikës dhe njohjen e praktikës së gjykatave në DK, si dhe me rekomandimet për shërbimet pro-bono. Seksionet e shoqatës mund të formohen në të gjitha sferat e veprimtarisë së saj. Ajo momentalisht ka 21 seksione.

11. SHOQATA E AVOKATËVE TË KANTONIT ARLINGTON

Suite 1800 Arlington ,VA

a) Themelimi dhe struktura, Reiman Baxter, kryetar

Shoqata e Avokatëve të Kantonit Arlington (shteti Virgjinia), është shoqatë vullnetare e avokatëve, e cila është themeluar para 75 vjetëve, kurse tani ajo udhëhiqet nga bashkëshortët-avokatët Tim dhe Reiman Baxter. Shoqata ka 500 anëtarë dhe llogaritet shoqatë e vogël avokatësh - edhe për nga anëtarësia edhe për nga buxheti vjetor. Shoqatën e udhëheq bordi, i cili përbëhet nga kryetari (i zgjedhur dhe shërben për një vit), mbajtësi i thesarit (një herë në vit ia paraqet raportin anëtarësisë), sekretari (paraqet raport për çështjet ditore) dhe 6 anëtarë të tjerë (një nga ta përgatit dokumentet afariste, taksat etj.) dhe kuvendi i anëtarëve (përbëhet nga avokatët anëtarë të shoqatës). Anëtarët e bordit shërbejnë pa pagesë. Shoqata ka komitetet të cilat janë të formuara dhe aktivitetin e vet e zhvillojnë për një sferë të caktuar.

Shoqata financohet nga një buxhet prej 100.000 dollarë në vit, i cili sigurohet nga kontributet e anëtarëve, shërbimi referal dhe programi i edukimit të vazhdueshëm ligjor. Anëtarët e rregullt të shoqatës janë të detyruar të paguajnë anëtarësinë në lartësi prej 120 dollarë, kurse anëtarët e rinj të saj paguajnë shumën prej 65 dollarë. Për shërbimin referal, klienti i paguan shoqatës 35 dollarë, kurse avokati i rekomanduar nga shoqata konsultimin e parë e jep pa pagesë.

Anëtarë të AAB janë avokatët që praktikojnë individualisht, avokatët nga firmat e vogla, ndërmjetësuesit, avokatët e agjencive qeveritare, të korporatave etj. Shoqata i ka edhe anëtarët e vet të nderit. Anëtarë nderi të shoqatës janë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Kantonit të Arlingtonit, prokurori i përgjithshëm, sherifi i qytetit dhe sekretari i gjykatës.

Në shtetin e Virgjinisë, për marrjen e licencës së avokatit, përveç kushteve të tjera, personi duhet të jetë anëtarësuar në Shoqatën Shtetërore të Avokatëve. Në Virgjinia ekzistojnë edhe shoqatat e specializuara të avokatëve (p.sh. për pronën industriale, të drejtën e autorit, penale, civile, shoqata e avokatëve paditës etj.), të cilat kanë për qëllim lobimin e çështjeve të veçanta dhe arritjen e efekteve të veçanta për të shpjerë përpara interesat e atyre që janë anëtarë. Aktiviteti i shoqatës është i shumënduarshëm, me synim përfundimtar avancimin dhe forcimin e ligjit.

b) Shërbimet për anëtarët, Kim Baxter

Shoqata e ka bibliotekën, të cilën anëtarët e saj mund ta shfrytëzojnë për 24 orë pa ndërprerë. Shoqata organizon shërbime të ndryshme për anëtarët e vet dhe mu këto shërbime paraqesin motivimin kryesor të anëtarësimin në shoqatë. Ajo organizon diku rreth 20 kurse të ndryshme gjatë vitit. Kurset zgjasin prej 1 e 2 orë dhe madje deri 10 orë, varësisht nga karakteri i tyre. Kështu, p.sh. seminar 6 orësh për ligjin penal.

Personat pa mjete të duhura për të përballuar shpenzimet e shërbimeve të avokatit, i kanë dy rrugë për të kërkuar ndihmën juridike pa pagesë:

- nga gjykata, në rastet penale i pandehuri duhet të argumentojë se nuk ka mjete të duhura për të përballuar shpenzimet për avokatin. Avokati, pasi që të jetë paraqitur vetë para gjykatës dhe të ketë shprehur vullnetin të angazhohet në rastet e këtilla, do të caktohet nga gjykata që t'ia ofrojë përfaqësimin palës së cilës i është pranuar kjo e drejtë.

- përmes "shërbimit pro-bono" të cilin e organizojnë shoqatat e avokatëve. Edhe kjo shoqatë u ofron shërbime pa pagesë klientëve të cilët vetë nuk mund t'i mbulojnë shërbimet e avokatit. Shoqata paraprakisht e vërteton se klienti i paraqitur nuk ka mjete të veta për të përballuar shërbimin e avokatit. Të këtillë në Arlington, ku edhe vepron shoqata, ka mjaft. Ata zakonisht janë nga kategoria e emigrantëve, të moshuarit dhe njerëzit pa të ardhura. Pas pranimit të ndihmës, shoqata do t'ia caktojë palës avokatin, i cili është në këtë program me vullnetin e vet dhe e njeh materien përkatëse të cilës i takon rasti i palës.

Në Virginia, shteti programin e ndihmës juridike pa pagesë e ka organizuar përmes organizatës së veçantë, e cila quhet "Shërbimet ligjore për Virgjininë Veriore". Çelës për anëtarësim janë mu këto shërbime të cilat i ofron shoqata: "edukimi i vazhdueshëm ligjor", i cili avokatëve ua bën të mundshme mbajtjen e licencës; shërbimet e tjera përfituese dhe mundësitë e komunikimit, argëtimit dhe shoqërimit përmes programeve dhe aktiviteteve të caktuara të shoqatës (p.sh. "dita shoqëruese" etj.). Shoqata zhvillon edhe aktivitete të cilat lidhen me komunitetin. Ato kanë të bëjnë me njohjen e komunitetit me të drejtat dhe detyrimet ligjore; njohjen me gjykatat, policinë dhe shërbimet e avokatëve; programet e ndihmës komunitetit – p.sh. anëtarët e kësaj shoqate kanë marrë aksion për të ndihmuar anëtarët e moshuar të komunitetit në rregullimin e çatave të shtëpive të veta etj.

12. GJYKATA SUPREME E SHBA-së - Sandra Day O Connor, gjyqtare

Nga 7.200 aplikacione, sa arrijnë brenda vitit për shqyrtim, gjykata merr në trajtim vetëm 80-90 raste që zakonisht kanë të bëjnë me krime të rënda, shkeljen e ligjit federal dhe çështjet kushtetuese. Rreth 1 /3 e këtyre rasteve janë penale. Palët mund të përfaqësohen vetëm nga avokatët të cilët janë të regjistruar para gjykatës dhe për këtë.

Përveç kushteve të tjera, nga avokatët kërkohet që të kenë përfaqësuar rastet rregullisht për 3 vjet me radhë para gjykatave federale. Për regjistrim, avokatët duhet të mbështeten nga se paku dy avokatë anëtarë të Gjykatës Supreme.

PARIMET THEMELORE MBI ROLIN E AVOKATËVE

*Miratuar nga ana e Kongresit tre tete te KB mbi Parandalimin e Krimet
dhe trajtimin e Fajtoreve,Havana,Kube,27 gusht deri 7 shtator 1990*

-Duke pasë parasysh se në Kartën e Kombeve të bashkuara,njerëzit e botës dëshmojnë përcaktimin e tyre për të krijuar kushtet nën të cilat drejtësia mund të mbahet,dhe të shpallin si një ndër qëllimet e tyre arritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në promovimin dhe inkurajimit e respektimit për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore,pa dallim race,gjinie,gjuhë apo religjion.

-Duke pasë parasysh se deklarata univerzalepër të drejtat e njeriut përmban parimet e barazisë para ligjit,supozimin e pafajësis,të drejtën për dëgjim,të drejtë dhe publik nga ana e gjykatës kompetente,dhe të gjitha garancat e domosdoshme për mbrojtjen e qdo personi të akuzuar për ndonjë vepër penale.

-Duke pasë parasysh se konventa ndërkomtare mbi të drejtat civile dhe politike shpallin,si shtesë të drejtën për tu gjykuar pa ndonjë shtyrje të paarsyshme dhe të drejtën në dëgjim të drejtë dhe publik nga ana e gjykatës kompetente ,të pavarur dhe të paanshme të themeluar nga ligji.

-Duke pasë parasysh se konventa ndërkomtare mbi të drejtat ekonomike,sociale dhe kulturore rithërret obligimin e shteteve sipas kartës për të promovuar respektin univerzal dhe mbikqyrjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

-Duke pasë parasysh përmbledhjen e parimeve për mbrojtjen e të gjithë personave nga qdo formë e paraburgimit ose arrestimit ofron mundësin që personi i paraburgosur duhet të ketë të drejtë në asistencë dhe të komunikojë dhe të konsultohet me këshillin ligjor.

-Duke pasë parasysh rregullat minimale të standardeve për trajtimin e të burgosurve rekomandojnë,poaqërisht që asistenca ligjore dhe komunikimi i besueshëm me mbrojtësin duhet të sigurohet për të burgosurit e pagjykuar.

-Duke pasë parasysh se masat siguruese të cilat garantojnë mbrojtjen e të gjithë atyre që presin dënimin me vdekje ritheksojnë të drejtën e secilit që është i dyshimte apo i akuzuar për ndonjë krim për të cilin mund të shqiptohet dënimi kapital në asistencë ligjore adekuate në të gjitha fazat e procedurës,në pajtim me nenin 14 te konventës ndërkomtare mbi të drejtat civile dhe politike.

-Duke pasë parasysh se deklarata mbi parimet themelore të drejtësis për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit rekomandon të merren masa në shkall ndërkomtare dhe kombëtare,për të përmisuar mundësin e arrijtes së drejtësis dhe trajtimit të drejtë,restitucionit ,kompensimit dhe ndihmes per viktimat e krimit.

-Duke pasë parasysh se mbrojtja adekuate e të drejtave te drejtave të njeriut dhe lirive themelore ,ne te cilën kanë të drejte të gjithë personat të kenë mundësinë e shfrytëzimit efektiv të shërbimeve ligjore,të ofruara nga një profesion i pavarur ligjor.

-Duke pas parasysh se shoqatat profesionale të avokatëve kanë një rol vital për të lozur në përkrahjen e standardeve profesionale dhe etikës ,në mbrojtjen e anëtareve te tyre nga persekutimi dhe kufizimet e palejueshme e kundervajtjet,duke ofruar shërbime ligjore për të gjithë ata që kanë nevojë për to,si dhe duke bashkëpunuar me institucionet qeveritare dhe të tjera në shtyrjen para drejtësisë dhe interesit publik,parimet themelore mbi rolin e avokatëve,te parashtruara më poshtë,të formuluar për të ndihmuar Shtetet Anëtare me detyrën e tyre të promovimit dhe sigurimit të rolit adekuat të avokatëve,duhet të respektohen dhe të merren parasysh nga Qeveritë,brenda kornizave të legjislacionit dhe praktikës së tyre kombëtare dhe duhet të vihen në vëmendjen e avokatëve,poashtu edhe personave të tjerë,si gjyqtarëve,prokurorëve,anëtarëve të organeve ekzekutive e legjislative,si dhe opinionit publik në përgjithësi.Këto parime,duhet gjithashtu të aplikohen si të qëlluara edhe ndaj personave që ushtrojnë funksionin e avokatit,pa pasur statusin formal të avokatit.

E DREJTA NË AVOKAT DHE SHËRBIME LIGJORE

1.

Të gjithë të personat janë të autorizuar që të thërrasin për ndihmë ne avokatit të zgjedhur me dëshirën e tyre,për të mbrojtë dhe themeluar të drejtat e tyre dhe për të mbrojtë ato në të gjitha fazat e procedurës penale.

2.

Qeveritë duhet të sigurojnë se procedura efektive dhe mekanizma përgjegjëse për ofrim efektiv dhe të barabart tek avokatët janë mundësuar për të gjithë personat brenda teritorit të tyre dhe janë nën

juridiksionin e tyre,pa dallim të qfardo lloji,siq është diskriminimi i bazura në racë,ngjyrë,originë etnike,gjini,gjuhë,religjion,mendim politik ose tjetër,originë kombëtare apo sociale,pasuri,lindje,gjendje ekonomike apo tjetër.

3.

Qeveritë duhet të sigurojnë furnizimin me fonde të mjaftueshme dhe burime tjera për shërbimet ligjore për të varfurit,dhe si të domosdoshme,për personat në pozitë të palakmueshme.Shoqatat profesionale të avokatëve duhet të bashkëpunojnë në organizimin e shërbimeve mjeteve dhe burimeve tjera.

4.

Qeveritë dhe shoqatat profesionale të avokatëve duhet të inicojnë programe për të informuar publikun në lidhje me të drejtat dhe obligimet e tyre sipas ligjit,si dhe mbi rolin e avokatëve ne e mbrojtjen e të drejtave të tyre themelore.Vëmendje e posaqme duhet ti kushtohet ndihmës për të varfërit dhe personat tjerë në pozitë të palakmueshme,në menyrë që tu mundësohet atyre të mbrojnë të drejtat e tyre edhe nëse është e domosdoshme,të thërasin avokatin në ndihmë.

MASA SPECIALE TË SIGURISË NË QËSHTJET E DREJTËSIS PENALE

5.Qeveritë duhet të sigurojnë se të gjithë personat janë të informuar menjëherë nga ana e organit kompetent,për të drejtën e tyre për tu ndihmuar nga avokati i zgjedhur me dëshirën e tyre,me rastin e arrestimit apo paraburgimit,ose kur janë të akuzuar për ndonjë vepër penale.

6.

Të gjithë ata persona të cilët nuk kanë avokat,duhet,në qdo rast kur interesat e drejtësis këtë e kërkojnë të kenë të drejtë në avokat me përvojë dhe kompetencë të duhur me natyrën e veprës të caktuar me qëllim që të mundësojn ndihmë ligjore efektive papagesë për ta,nëse kanë mungesë të të hollave të nevojshme për të paguar këtë lloj shërbimi.

7.

Qeveritë edhe më tutje do të duhej të sigurojnë që personat e arrestuar apo të paraburgosur,me apo pa akuzë,duhet të kenë mundësin të kontaktit të menjëhershëm me avokatin,dhe në qdo rast jo më vonë se dyzet e tetë orë nga momenti i arrestimit apo burgosjes.

8.

Të gjithë të arrestuarit,të privuarit nga liria apo të burgosurit do të duhej të jenë të paisur me mundësit adekuate,kohë edhe komoditet për të komunikuar dhe për të qenë të vizituar nga avokati,pa vonesë,pa pengesa dhe mbikqyrje dhe në besueshmëri të plotë.Këto konsultime mund të shikohen por jo edhe të dëgjohen nga ana e zyrtarëve që zbatojnë ligjin.

KUALIFIKMIET DHE USHTRIMET

9.

Qeveritë,shoqatat profesionale të avokatëve dhe institucionet edukative duhet të sigurojnë që avokatët kanë edukimin dhe ushtrimet përkatëse dhe të bëhen të vetëdijshëm për idealet dhe obligimet morale të avokatit,si edhe mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të tij nga e drejta ndërkomtare dhe kombëtare e tij.

10.

Qeveritë,shoqatat profesionale të avokatëve dhe institucionet edukative duhet të sigurojnë që nuk ekziston diskriminimi ndaj një personi,sa i përket hyrjes apo vazhdimit të praktikës brenda profesionit ligjor,në bazë të racës,ngjyrës,gjinisë,originës etnike,religjionit,mendimit politik apo tjetër,originës kombëtare apo sociale,pasurisë,lindjes,statusit ekonomik apo tjetër,përveq që kërkesa duhet të jetë shtetas i shtetit në fjalë,nuk duhet të konsideruar si diskriminues.

11.

Në shtetet ku ekzistojnë grupet,komunitetet apo regjionet,nevojat e të cilëve për shërbime ligjore nuk janë plotësuar,poaqërisht kur grupet e tilla kanë kulturë,tradita dhe gjuhë të dryshme kanë qenë viktimat të diskriminimit në të kaluarën,qeveritë shoqatat profesionale e avokatëve dhe institucionet edukative ,duhet të ndërmmarrim masa të posaqshme për të ofruar mundësinë kandidatëve nga këto grupe që hyjnë në profesionin ligjor dhe duhet të sigurojnë që ata të pranojnë ushtrimet e duhura ,që janë në pajtim me nevojat e grupeve të tyre.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

12.

Avokatët duhet të mbajnë ghatë tërë kohës ,nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre ,si pjesë esenciale e administratimit të drejtësisë.

13.

Obligimet e avokatëve ndaj klientëve të tyre duhet të përfshijnë :

a)Këshillimin e klienteve për të drejtat dhe obligimet e tyre ligjore ,si dhe në lidhje me funksionimin e sistemit ligjor ,për aq sa kjo është e rëndësishme për të drejtat dhe obligimet e klientëve :

b)Ndihmën e dhënë klienteve në të gjitha mënyrat pëkatëse ,dhe ndërmarrjen e të gjithave veprimeve ligjore në mbrojtje të interesave të tyre .

c)Ndihmen e dhënë klienteve para gjykatave ,tribunaleve apo organeve administrative ,ne rastet kur është e përshtatshme .

14.

Avokatet,në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga e drejta kombetare dhe nderkombetare dhe duhet që në çdo kohë të veprojë lirisht dhe me ngulm,në pajtim me ligjin dhe standardet e njohura dhe etikën e profesionit ligjor .

15.

Avokatët duhet të respektojnë në çdo kohë ,në mënyre të besueshme interesat e klientëve të tyre .

GARANCAT PËR PUNËN E AVOKATËVE

16.

Qeveritë do të duhet të sigurojnë që avokatët (a)kanë mundësi ti kryejnë të gjitha funksionet e tyre pa frikë ,pa pengesa dhe pa ndërhyrje jo të nevojshme (b)të kenë mundësi të udhëtojnë dhe konsultohen me klientët e tyre lirisht brenda vendit të tyre dhe jashtë (c)të mos pësojnë apo të mos kërcënohen me persekutim ,sanksion ekonomik,apo tjetër për çfardo akti të tyre të kryer në pajtim me detyrat e njohura profesionale ,standardet apo moralin.

17.

Kur siguria e avokatëve është e kërcenuar me shkarkimin e funksionit të tyre ,ata do të duhej të siguroheshin në mënyrë adekuate nga autoritetet.

18.

Avokatët nuk duhet të identifikohen me klientët apo çështjet e klientëve të tyre ,si rezultat i shkarkimit nga funksioni i tyre.

19.

Asnjë gjykatë apo organë administrativë para të cilit është njohur e drejta në mbrojtës .nuk duhet të refuzojë të njohë të drejtën e avokatit për tu paraqitur para tij ose saj,perveç nëse si avokat është diskualifikuar në pajtim me ligjin dhe praktikën kombëtare ,si dhe në pajtim me këto parime .

20.

Avokatët duhet të gëzojnë imunitet civil dhe penal për deklaratat relevante të bëra në besim ,në formë të shkruar apo gojore ,apo në paraqitjen e tyre profesionale para gjykatës ,tribunalit apo organit tjetër ligjor apo administrativ.

21.

Është obligim i organeve kompetente që tu sigurojnë avokatëve ardhjen deri te i nformatat përkatëse ,dosjet dhe dokumentet që i posedojne apo kontrollojne në kohën e duhur ,në mënyrë që tu mundesojnë avokateve dhenien e ndihmes efektive ligjore klientëve të tyre .Ardhja e tillë deri te informatat,duhet të mundësohet sa më parë që është e mundur.

22.

Qeveritë duhet të njohin dhe respektojnë faktin se të gjitha komunikimet dhe konsultimet e bëra në mes të avokatëve dhe klientëve të tyre përbrenda marrëdhënies së tyre profesionale janë konfidenciale.

LIRIA E SHPREHJES DHE BASHKIMIT

23.

Avokatët dhe qytetarët e tjerë,kanë të drejtë në lirinë e shprehjes,besimit,bashkimit dhe tubimit.Në veqanti,Ata duhet të kenë të drejtën të marrin pjesë në diskutimet publike që kanë të bëjnë me ligjin,administrimin e drejtësisë,si dhe promovimin e mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të bashkohen apo të formojnë organizata lokale,kombëtare apo ndërkomtare dhe të marrin pjesë në takimet e tyre,pa vuajtur kufizimet profesionale për shkak të akteve të ligjshme apo antarësis në një organizatë të

ligjshme. Në ushtrimin e këtyre të drejtave ,avokatët duhet të veprojnë gjithnjë në pajtim me ligjin dhe standardet e njohura,si dhe etikën e profesionin e tyre.

SHOQATAT PROFESIONALE TË AVOKATËVE

24.

Avokatët duhet të kenë të drejtë të formojnë apo tu bashkohen shoqatave profesionale vetëqeverisëse për të përfaqësuar interesat e tyre për të promovuar edukimin dhe ushtrimet e tyre të vazhdueshme dhe për të mbrojtë integritetin e tyre profesional. Trupi ekzekutiv i shoqatave profesionale duhet të zgjedhet nga anëtarët e tyre dhe duhet të ushrojë funksionet e saj pa ndërhyrje nga jashtë.

25.

Shoqatat profesionale të avkatëve duhet të bashkëpunojnë me qeveritë për të siguruar se qdo njëri ka mundësi efektive dhe të barabart për të pranuar shërbimet ligjore dhe se avokatët do të kenë mundësi,pa ndërhyrje të paarsyshme nga jashtë,të këshillojnë dhe ndihmojnë klientët e tyre në pajtim me ligjin dhe standardet e njohura profesionale dhe etkën.

PROCEDURA DISCIPLINORE

26.

Kodi i sjelljes profesionale për avokatët duhet të themelohet nga ana e profesionit ligjor permes organeve përkatëse,ose nga ana e legjislacionit,në pajtim me të drejtën dhe praktikën kombëtare dhe standardet dhe normat e pranuar ndërkombëtare.

27.

Akuzat apo ankesat e bëra kundër avokatëve në aftësin e tyre profesionale,duhet të shqyrtohen shpejtë dhe drejtë nën procedura përkatëse.Avokatët duhet të kenë të drejtë në dëgjim të drejtë,përfshirë këtu edhe të drejtën për të qenë të ndihmuar nga avokati sipas zgjidhjes së tyre.

28.

Procedura disiplinore ndaj avokatëve duhet të sillet para një komiteti disiplinor të paanshëm,të themeluar nga profesioni ligjor,para një organi të pavarur statutory,apo para gjykatës dhe duhet të jetë lëndë e një shqyrtimi të pavarur gjyqësor.

29.

E tërë procedura disiplinore duhet të përcaktohet në pajtim me kodin e sjelljes profesionale dhe standardet dhe etiket e pranuar profesionale të profesionit ligjor dhe në dritën e këtyre parimeve.

AVOKATURA/Bilten i Odes se Avokateve te Kosovës

UDHEZIME

-per autoret-

Ftohen autoret qe dorëshkrimet ti dorëzojnë duke ju përmbajtur këtyre rregullave:

1. Prezantimi juaj do të duhej të jetë një koment i plotë e jo thjesht skicim i ligjit. Materiali i përgatitur nga ju mund të përdoret si mjet referues dhe për rrjedhojë do të duhej të jetë sa më gjithëpërfshirës,duke përshtetur hollësisht dhe saktë çështjen që trajton.
2. Ndryshime në ligj, zhvendosja e vlerësimeve midis ekspertëve për çështjet më të rëndësishme dhe përpjekja e jonë për të qenë të pajisur me komentet më të mira, na shtyn që të preferojmë një artikull të ri para se plotësimin apo rishikimin e punimit të kaluar. Megjithatë, shqyrtimet e paraqitura nga ju kurrsesi nuk do të duhej të ishin shtesa të punimeve të kaluara.
3. Shkruani për të edukuar e jo për të impresionuar. Përdorni gjuhë të thjeshtë dhe fjali të shkurtra. Shpjegoni temat të cilat vështirë mund të kuptohen nga joprofesionistët.
4. Formatet, formularët, dokumentet modele, listat kontrolluese, kërkohen shumë dhe përbëjnë një mjet të shkëlqyer edukimi. Prandaj ato mund të përfshihen si shtojca, por kurrsesi në trupin e tekstit tuaj. Vëmendja e pjesëmarrësve do të duhej të tërhiqej në çështjet e rëndësishme etike,prandaj keni parasysh standarde të larta etike profesionale.
5. Titulli i punimit duhet të jetë i shkurtër (maksimum 12 fjali ose 70 shkronja),që e përshkruan thelbin e temës tuaj. Keni parasysh që të tjerët do ta përdorin këtë titull për ta kërkuar artikullin tuaj për qëllimet e tyre kërkimore.
6. Titujt në tekst dhe në tabelën e përmbajtjes duhet të kenë numra dhe të vendosen në konturin:I,A,1,a(1). Organizoni artikullin në këtë format hierarkik, sepse kështu tema juaj do të jetë më e qartë.
7. Në titullin Parathënie përfshini një përmbledhje të shkurtër (50 ose edhe më pak fjali),për ta përshkruar punimin. Kjo përmbledhje do të përdoret ta shesë artikullin.
8. Përdorini rregullat standarde të shqyrtimit të burimeve. Përfshini citime të mjaftueshme për të vërtetuar qëndrimet thelbësore por evitoni citimet e gjata.
9. Përfshini bibliografinë nëse shkruani në një fushë të së drejtës ku burimet e materialit mund të gjenden me vështirësi ose nëse në punim keni përfshi citate nga artikuj ose materiale të tjera.
10. Ne lidhje me përdorimin e fusnotave:
 - fusnotat shkruhen sipas kësaj radhe : numri (lidhur për tekst), autori, titulli i veprës, vendi dhe viti i botimit, numri i faqes se cituar ose pikës. Fusnotat duhet te jene te numëruara për tere tekstin e jo për secilën faqe, ose te shënohen tërësisht ne fund te tekstit,
 - Nëse ne punim autori i njëjte citohet ne me shume fusnota (te cilat nuk janë njëra pas tjetrës) pas emrit dhe mbiemrit te autorit, herën e dyte dhe çdo here tjetër te përdoret shkurtesa''Vep.e cit.''. Nëse një punim i autorit te njëjtë citohet ne fusnota te cilat vijnë njëra pas tjetrës, pas citimit te pare te shënimeve te plota mbi autorin dhe punimin ti shtohet shkurtesa'' ibit'' ose ,'' po aty''

-E vlerësojmë angazhimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATURA

Buletin i Odes se Avokateve te Kosovës
VITI:IV – nr.6/2008

Lektor dhe korrektor
Nehat Qena

Përgatitja teknike

Yll Zekaj

Përkthimi
Nehat Qena

Tirazhi
600 copë

U shtyp në shtypshkronjën

“AGORA”
Mitrovicë

2008
PRISHTINË

Çfarë është AVL ?

Arsimimi i Vazhdueshëm Ligjor – AVL është program për avokatë që aplikohet në shumë vende (SHBA-të dhe disa vende Evropiane). Qëllimi i këtij programi është zgjerimi i njohurive profesionale, zhvillimi i shkathtësive praktike dhe diskutimi mbi zbatimin e rregullave të etikës. Këtë program, të parin e këtij lloji në Kosovë, OAK ka filluar në prill 2004 me organizimin e një seri kursesh intensive për legjislacionin e ri penal (KPPPK dhe KPPK), te cilët atëherë filluan aplikimin praktik. Me këtë OAK për herë të parë në historikun e vet 35 vjeçar po e merr përgjegjësinë për nivelin e kompetencës profesionale dhe të shkathtësive praktike të anëtarëve të vet, duke siguruar se çdo anëtarë i saj plotëson nivelin minimal të kompetencës.

Cilat janë programet AVL?

a) **Arsimimi Intensiv Ligjor (AIL)**- është i ndërtuar nga Programi i njohjes me legjislacionin e ri penal të Kosovës (KPPPK dhe KPPK). Përbëhet nga Seminaret intensive në lidhje me institucionet e reja të sistemit penalo-juridik të Kosovës. Është program emergjent i përfitimt të njohurive profesionale dhe të zhvillimit të shkathtësive praktike në çështjet specifike penale. AIL, deri me tani është realizuar në formë të seminareve dhe tryezave mujore.

b) **Arsimimi Intensiv Ligjor për Avokatët e Rinj (AILAR)** - është program që u dedikohet personave të cilët hyjnë për herë të parë në profesion dhe kanë më tepër nevojë për thellimin e njohurive profesionale dhe zhvillimin e praktikave gjyqësore. Programi ofron njohuri të veçanta për ushtrimin e profesionit të avokatit dhe përgatitje specifike për dhënien e shërbimeve juridike. Në bashkëpunim me OSCE-në, dy projekte njëvjeçare AILAR/2005 dhe AILAR/2006, janë zbatuar për dy gjenerata avokatësh.

c) **Arsimimi i Vazhdueshëm Ligjor (AVL)**- është dizajnuar ashtu që të jetë një zëvendësim për AVLO deri në krijimin e bazës ligjore për të. AVL- është një program i trajnimeve, takimeve të punës, seminareve dhe kurseve për avokatë që aplikohen në shumë vende. Qëllimi i këtij programi është zgjerimi i njohurive profesionale, zhvillimi i shkathtësive praktike dhe diskutimi i zbatimit të rregullave të etikës. Ky është një program i vazhdueshëm shumëvjeçar i arsimimit për avokatët dhe ngitet për çështjet e caktuara të cilët paraqesin preokupime aktuale të avokatëve.

d) **Arsimimi Ligjor për Avokatët e Çështjeve Komerciale (ALACK)**- është program që u dedikohet avokateve të cilët merren me çështjet ekonomike dhe të tregut, transaksioneve dhe bizneseve. Ka për qëllim ngritjen e resurseve profesionale të zyrave të avokateve për çështjet nga ekonomia e tregut me qëllim të plotësimit të nevojave të komunitetit për shërbimet e nxitura nga hapja ekonomike e Kosovës me jashtë. Deri me tani, programe të veçanta të këtij edukimi janë zbatuar në bashkëpunim me partneret, kurse në të ardhmen planifikohen programe të tjera të veçanta.

AVL- është vegël e mire për ndryshimin e praktikave, për përsosje profesionale dhe ngritje të shkathtësive praktike!

Pse na duhet AVL ?

Objektivi kryesor i një programi çfarë është AVL në vende të ndryshme është themelimi i një sistemi vlerash në përgjithësi si: avancimi i drejtësisë dhe paanësisë (etika profesionale), siguri i ndihmës për trajnime, siguri i përfaqësimit kompetent, forcimi i shkathtësive praktike, trajnimi i avokatëve të rinj, barazia para ligjit, arsimimi i përgjithshëm profesional në mënyrë që të sigurohet ndihma juridike kualitative.

Qëllimi thelbësor i programit për AVL është avancimi i vlerave të caktuara individuale siç janë kompetenca, diagnostifikimi i problemit, zhvillimi i planit veprues, hulumtimi ligjor më i avancuar dhe/ose negociimi etj. Në këtë mënyrë mendohet të përfitojë avokati si individ dhe përmes kësaj i gjithë sistemi ligjor i Kosovës në tërësi. Gjithashtu materialet që do t'iu ofrohen do të jenë me vlerë për punën tuaj si avokat.

Ku do të ketë ndikim AVL?

AVL pritet të ndikojë pozitivisht në komunitetin e avokatëve duke shtuar resurset profesionale të zyrave ligjore dhe duke ngritur me këtë nivelin e shërbimeve ligjore për komunitetin. AVL pritet që të ndikojë në sistemin e drejtësisë në Kosovë në përgjithësi, në radhë të parë duke përmirësuar praktikën gjyqësore si dhe në forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Cilët do të jenë ekspertët që do të angazhohen në programet e AVL-së ?

Thelbin e ekspertizës profesionale të këtyre programeve përbëjnë resurset vetanake të Odes, me çka kërkesat për mbështetjen financiare të këtij segmenti të Projektit zvogëlohen në minimum. Megjithatë, Oda është e përkushtuar që të sigurojë ekspertizën me të mire profesionale për programin.

Edhe Ju mund të konkurroni për ekspertë/prezantues në Programet AVL. Për këtë paraqituni në Administratën e Odës, e cila do t'ua sigurojë Rregullat standarde për prezantime.

Çka është duke u përgaditur?

Këshilli Ekzekutiv ka aprovuar Projektin e AILAR-gjenerata III me datën 26.05.2007, i cili si i këtillë tërësisht do të zbatohet nga vet Oda (dizajnimi, menaxhimi, mbështetja financiare). Ky Program do të përfshijë avokatët që janë të licencuar për

ushtrimin e profesionit prej shkurtit 2005 e nuk e kane vijuar me pare Programin AILAR. Grupit pritet qe ti bashkohen edhe avokatet te cilët do te licencohen ne vijim deri ne ditën e fillimit te zbatimit te programeve._____

Për më tepër informata në lidhje me Programet AVL kontaktoni: Ylli Zekaj, Koordinator Tel. 044-375-730, E mail: yllz@oak-ks.org dhe Musa Xh.Dragusha - Kryetari AVL Tel.044-249-528, E-mail: musa_av@yahoo.com apo ne Web-site: www.oak-ks.org



Oda e Avokatëve të Kosovës

Ju ofron

Arsimim të Vazhdueshëm Ligjor

***Një mekanizëm i ri për suksesin
tuaj si avokat!***

***Bëhuni më efektiv dhe gëzoni respekt edhe më
të madh tek kolegët dhe klientët e juaj!***

A . V . L .